



**Kuadri i Investimeve të Ballkanit Perëndimor
Instrumenti Lehtësues i Projekteve të Infrastrukturës
Asistenca Teknike 6 (IPF6)**

TA 2016032 RO IPA

**Projekti paraprak i Gazsjellësit Jonian-Adriatik
– Seksionet e Malit të Zi dhe Shqipërisë**

**Seksioni i Shqipërisë
Raport i Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social
PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE**

Financuar në bazë të një marrëveshje specifike për grantin nr. 2017/388-041 nga Programi multi-përfitues i BE IPA II për Shqipërinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Maqedoninë e Veriut, Kosovën *, Malin e Zi dhe Serbinë

* Në këtë dokument ky emërtim nuk paragjykon pozicionet mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të UNCHR dhe Opinionin e ICJ mbi Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës



Konsorciumi IPF6

Kuadri i Investimeve të Ballkanit Perëndimor (WBIF)

Instrumenti Lehtësues i Projekteve të Infrastrukturës

Asistenca Teknike 6 (IPF6)

TA 2016032 R0 IPA

Emri i nën-projektit

Projekti Paraparak i Gazsjellësit Jonian-Adriatik – Seksionet e Malit të Zi dhe Shqipërisë

WB15-REG-ENE-01

Seksioni i Shqipërisë

Raport i Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social – Përmbledhje jo-teknike

Versioni	Data e nxjerrjes
Draft v.05	11 Dhjetor 2020

Instrumenti Lehtësues i Projekteve të Infrastrukturës (IPF) është një instrument i asistencës teknike të Kuadrit të Investimeve të Ballkanit Perëndimor (WBIF), i cili është një iniciativë e përbashkët e Bashkimit Evropian, Institucioneve Financiare Ndërkombëtare, donatorëve dypalësh, dhe qeverive të vendeve të Ballkanit Perëndimor, që mbështet zhvillimin socio-ekonomik dhe anëtarësimin në BE të rajonit të Ballkanit Perëndimor, nëpërmjet dhënies së asistencës financiare dhe teknike për investime strategjike infrastrukturore. Ky operacion i asistencës teknike financohet nga fondet e BE-së.

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA	5
LISTA E SHKURTIMEVE.....	6
HYRJE	7
1.1 ARSYETIMI I PROJEKTIT.....	7
1.2 QËLLIMI I PËRMBLEDHJES JO-TEKNIKE	7
1.3 PËRSHKRIM I PËRMBLEDHUR I PROJEKTIT TË PROPOZUAR IAP – SEKSIONI I SHQIPËRISË	7
1.4 QËLLIMI I PROCESIT TË VNMS	8
1.5 KONSULTIMET ME GRUPET E INTERESIT GJATË PROCESIT TË VNMS-SË.....	8
2 PËRSHKRIMI I PROJEKTIT	11
2.1 AKTIVITETET E PROJEKTIT PËR SEKSIONIN SHQIPTAR TË IAP.....	11
2.2 VENDNDODHJA E ZONËS SË PROJEKTIT.....	15
3 ANALIZAT E ALTERNATIVAVE TË KONSIDERUARA	16
4 PËRSHKRIMI I KUSHTEVE BAZË TË MJEDISIT.....	16
4.1 KARAKTERISTIKAT E MJEDISIT FIZIK.....	16
4.1.1 <i>Klima dhe meteorologjia</i>	<i>16</i>
4.1.2 <i>Gjeologjia dhe sizmiteti i zonës së projektit</i>	<i>17</i>
4.1.3 <i>Gjeomorfologjia e zonës së IAP</i>	<i>19</i>
4.1.4 <i>Toka dhe toka bujqësore</i>	<i>20</i>
4.1.5 <i>Pejsazhi.....</i>	<i>20</i>
4.2 BIODIVERSITETI DHE HABITATET	21
4.2.1 <i>Përcaktimi i zonës së studimit</i>	<i>21</i>
4.2.2 <i>Biodiversiteti me rëndësi prioritare</i>	<i>22</i>
4.2.3 <i>Llojet e habitateve të identifikuar</i>	<i>29</i>
4.2.4 <i>Përshkrimi i llojeve të vegjetacionit të secilit habitat</i>	<i>31</i>
4.2.5 <i>Përshkrimi i llojeve të faunës së secilit habitat.....</i>	<i>34</i>
4.2.6 <i>Zonat e mbrojtura</i>	<i>36</i>
4.3 CILËSIA E MJEDISIT DHE NDIKIMET EKZISTUESE	37
4.4 MJEDISI SOCIO-EKONOMIK	40
5 5 ANALIZA E NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS	45
5.1 METODOLOGJIA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	45
5.2 ZONAT OSE RECEPTORËT E NDJESHËM NDAJ NDIKIMEVE TË PROJEKTIT	49
5.3 ANALIZA E NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE TË PROJEKTIT	66
6 NDIKIMET E MUNDSHME NDËRKUFITARE.....	107
7 NDIKIMET E MUNDSHME POZITIVE.....	108
8 MASAT ZBUTËSE BAZUAR NË NDIKIMET NEGATIVE TË IDENTIFIKUARA	109
8.1 MASAT ZBUTËSE.....	109
8.2 NDIKIMET MBETËSE.....	130
9 MONITORIMI MJEDISOR I ZBATIMIT TË PROJEKTIT.....	175
10 PLANI I MENAXHIMIT DHE MONITORIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL	177

LISTA E SHKURTIMEVE

ALB	Shqipëria
BE	Bashkimi Evropian
BEI	Banka Evropiane e Investimeve
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BiH	Bosnja dhe Herzegovina
BVS	Stacioni i Valvulës së Bllokimit
CTMS	Stacioni Matjes dhe Transferimit të Kujdestarisë (CTMS)
DKU	Direktiva Kuadër e Ujit
EdK	E drejta e Kalimit
ERE	Enti Rregullator i Energjisë
IAP	Gazsjellësi Jonian-Adriatik
IFN	Institut Financiar Ndërkombëtar
ILPI	Instrumenti Lehtësues i Projekteve të Infrastrukturës (IPF)
KEE	Komuniteti Ekonomik Evropian
M.N.D	Mbi nivelin e detit
Ma	Milion vjet përpara
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MNE	Mali i Zi
MPG	Master Plani i Gazit
MTE	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
OJF	Organizata Jo Fitimprurëse
OST	Operatori i Sistemit të Transmetimit
PAPI	Plani i Angazhimit të Palëve të Interesit
PMMM	Plani i Menaxhimit dhe Monitorimit të Mjedisit
PMSH	Plani i Menaxhimit të Sheshit
PRE	Plani i Reagimit ndaj Emergjencave
PRMS	Stacioni i Matjes dhe Reduktimit të Presionit
PVMS	Plani i Veprimit Mjedisor dhe Social
RSTP	Raport i Studimit Teknik Paraprak
SF	Studim Fizibiliteti
SMM	Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit
SP	Standartet e Performancës
TANAP	Trans-Anatolian Natural Gas Pipeline
TAP	Trans-Adriatic Pipeline
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VNM	Vlerësim i Ndikimit në Mjedis
VNMS	Vlerësim i Ndikimit Mjedisor dhe Social
VSM	Vlerësimi Strategjik Mjedisor
WBIF	Kuadri i Investimeve të Ballkanit Perendimor

HYRJE

Gazsjellësi Jonian-Adriatik (IAP) është pjesë e sistemit ndërkombëtar të transmetimit të gazit që kalon nëpër Shqipëri, Mal të Zi dhe Kroaci. IAP do të ndërlidhë sistemin ekzistues dhe të planifikuar të transmetimit të gazit të Republikës së Kroacisë me tubacionin Trans-Adriatik (TAP) në të dy drejtimet.

Projekti IAP është pjesë e Unazës së ardhshme të gazit të Evropës Juglindore dhe është projekti më i rëndësishëm rajonal në Evropën Juglindore i cili ka marrë mbështetjen e Komunitetit të Energjisë dhe Komisionit Evropian. Ai gjithashtu është zgjedhur si Projekt i Interesit të Ndërsjellë (PMI) nga Komuniteti i Energjisë.

Seksioni IAP që kalon nëpër Shqipëri është projektuar në atë mënyrë që të lejojë transmetimin optimal të gazit nga TAP në Mal të Zi, Bosnje dhe Hercegovinë dhe Kroaci dhe, të lehtësojë zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të transmetimit të gazit në Shqipëri. Në skenarin fillestar, IAP do të jetë shtylla kurrizore e pjesës veriore të sistemit shqiptar të transmetimit të gazit. Për më tepër, është parashikuar që IAP do të lehtësojë furnizimin me gaz të Kosovës përmes tubacionit Alkogap të planifikuar në të ardhmen.

Në Shqipëri, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është përfituesi kryesor përgjegjës për zbatimin e projektit.

1.1 Arsyetimi i projektit

Si rezultat i zbatimit të projektit IAP, Korridori Jugor i Gazit do të sjellë gazin e Detit Kaspik (Azerbajxhani) dhe diversifikojë burimet e furnizimit me gaz të Bashkimit Evropian.

Qëllimi i IAP është:

- të mbështesë Evropën në arritjen e objektivit të saj strategjik për sigurimin dhe diversifikimin e furnizuesve të gazit natyror dhe rritjen e aftësisë për të plotësuar nevojat në rritje për energji,
- të përmirësojë sigurinë dhe diversifikimin e furnizuesve të gazit të tregjeve evropiane,
- të lidhë rrjetet ekzistuese dhe të planifikuara për transportin e gazit natyror në Evropën Juglindore me Evropën Perendimore në mënyrën më eficiente dhe ekonomike,
- gazifikimi i Shqipërisë, Malit të Zi, pjesës jugore të Kroacisë dhe Bosnjë Hercegovinës,
- të mundësojë tranzitimin e gazit drejt Evropës Qëndrore dhe Lindore – dhe integrimin e tregut (pjesës jugore të Kroacisë dhe Bosnjës Hercegovinës),
- të sigurojë qasje në terminalin e ardhshëm të GLN në Kroaci,
- të përmirësojë konkurrencën në furnizimin dhe tranzitimin e gazit në rajon.

1.2 Qëllimi i Përmbledhjes jo-teknike

Përmbledhja jo-teknike (PJT) është një dokument i përmbledhur që ofron një përshkrim të procesit të VNMS-së, gjetjet e tij dhe projektin në një mënyrë që është tërheqëse për t'u lexuar dhe e lehtë për t'u kuptuar nga publiku i gjerë.

1.3 Përshkrim i përmbledhur i projektit të propozuar IAP – seksioni i Shqipërisë

IAP është një tubacion i propozuar për gazin natyror në të ashtuquajturin Korridor Jugor të Gazit i cili do të sjellë gaz nga rezervat e reja të Rajonit Kaspik në Evropën Jugore dhe Qendrore. IAP do të mbështesë Evropën të arrijë objektivin e saj strategjik të sigurimit të mëtejshëm të furnizuesve të gazit dhe plotësimin e nevojave në rritje për energji.

IAP është ideuar si një gazsjellës ndërkombëtar dy-kahësh i cili, përmes Malit të Zi dhe Shqipërisë, lidh sistemin kroat të transmetimit të gazit me Gazsjellësin Trans-Adriatik në pikën marrëse në Shqipëri. Gjatësia e përgjithshme e tubacionit të gazit nga qyteti kroat Split deri në qytetin

shqiptar Fier është 520 km dhe shtrihet kryesisht në tokë përgjatë bregdetit Adriatik dhe atij Jonian.

Gjatësia e tubacionit (seksioni shqiptar) do të jetë afërsisht 170.3 km dhe do të ketë 13 instalime sipërfaqësore. Tubacioni nis në afërsi të fshatit Seman. Pika lidhëse me Malin e Zi është në lumin Buna.

1.4 Qëllimi i procesit të VNMS

Qëllimi i raportit të Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS) është të analizojë gjendjen aktuale të mjedisit dhe çështjet sociale, të përcaktojë ndikimin e projektit të planifikuar dhe të propozojë masa zbutëse që do të zvogëlojnë ndikimet negative në nivele të pranueshme dhe programin e monitorimit.

Raporti i VNMS vlerëson pranueshmërinë e ndërhyrjes së planifikuar për mjedisin dhe çështjet sociale, bazuar në faktorët që kushtëzojnë përhapjen, intensitetin dhe kohëzgjatjen e ndikimit.


Objektivat specifikë të VNMS janë:

- të identifikojë kuadrin ligjor të zbatueshme për projektin,
- të përshkruajë tiparet kryesore të projektit dhe specifikimet teknike shoqëruese,
- të prezantojë alternativat e diskutuara për projektin,
- të përshkruajë kushtet bazë mjedisore dhe sociale të zonës së projektit si dhe kufizimet e mundshme për ndërtimin dhe funksionimin e tubacionit,
- të vlerësojë ndikimet e mundshme negative dhe pozitive si dhe rreziqet e projektit dhe aktiviteteteve të lidhura me projektin mbi mjedisin dhe çështjet sociale,
- të ndihmojë në hartimin dhe planifikimin e projektit duke identifikuar aspektet e vendndodhjes, ndërtimit dhe operacioneve, të cilat mund të shkaktojnë efekte të pafavorshme mjedisore dhe sociale, shëndetësore dhe ekonomike,
- të rekomandojë masa zbutëse gjatë ndërtimit, operimit dhe komisionimit me qëllim shmangien dhe zbutjen e ndikimeve të identifikuara negative.

1.5 Konsultimet me grupet e interesit gjatë procesit të VNMS-së

Sa i përket procedurës së VNMS, në përputhje me kuadrin ligjor kombëtar për mjedisin, për nisjen e saj, në Korrik 2019 është dorëzuar Raporti i përcaktimit të çështjeve të VNMS-së.

Vendimi në lidhje me Raportin e përcaktimit të çështjeve doli me datë 12 Dhjetor 2019 dhe tregohet në figurën e mëposhtme.


REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË MJEDISIT

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË**
Nr. 6988/6 Prot.
Datë 13.12.2019
fax 9834

Nr. 5635 Prot. Tiranë, më: 12.12.2019

Lënda: Mbi procedurën e Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis

Zj. Viola Haxhiademi
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM ✓
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

MINISTRISË SË TURIZMIT DHE MJEDISIT
Drejtorisë së Përgjithshme Rregullore dhe Përputhshmërisë në Turizëm dhe Mjedis

Në përgjigje të shkresës tuaj Nr. 6988/5 Prot, datë: 26.11.2019 dhe hyrëse në AKM Nr. 5635 Prot, datë: 03.12.2019, lidhur me procedurën që duhet të ndiqet për seksionin shqiptar të projektit Ionian-Adriatic Pipeline (projekti IAP), Ju bëjmë me dije si më poshtë:

Projekti i shtrirjes së tubacioneve me diametër të madh të naftës dhe gazit, duhet t'i nënshtrohet Procedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, bazuar në Ligjin Nr. 10440, datë 7.7.2011 "Për Verësimin e Ndikimit në Mjedis", të ndryshuar, Shtojca I, "Projektet që i nënshtrohen Procedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis", Pika 16. Tubacionet me një diametër prej më shumë se 800 mm dhe një gjatësi prej më shumë se 40 km: a) për transportimin e gazit, naftës.

Procedura që ndiqet bazohet në Kreun II të VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore".

Në hartimin e VNM-së së thelluar subjekti duhet të paraqesë dhe të plotësojë informacionin në si më poshtë:

- Kërkesat e Ministrisë së Mjedisit, të cilat duhet të merren parasysh dhe të trajtohen në raportin e thelluar të VNM-së.
- Subjekti duhet të hartojë strukturën dhe renditjen e informacionit në raportin e VNM –së së Thelluar, në përputhje me shtojcën II të VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore"
- Subjekti gjatë hartimit të VNM së thelluar duhet të zhvillojë Konsultimin me publikun në bazë të VKM-së nr 247, datë 30.4.2014. "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore" duke njoftuar AKM-në paraprakisht për këtë takim.

Në këtë takim duhet të ketë një pjesëmarrje të gjerë, me banorë të cdo fshati që preket nga zhvillimi këtij projekti, duke qënë se projekti ka një shtrirje të gjerë.

1

Rruga "Sami Frashëri", Nr. 4, Tiranë. www.akm.gov.al Tel/Fax 04 2 371 237

- d) Raporti Vlerësimi të Ndikimit në Mjedis duhet të jetë i detajuar, duke përcaktuar qartë shkarkimet në mjedisin rrethues (tokë, ujë, ajër) gjatë fazës së ndërtimit dhe funksionimit.
- e) Të detajohen masat për menaxhimin e mbetjeve të ambalazheve dhe mbetjeve inerte të gjeneruara gjatë punimeve.
- f) Përshkrimin e sipërfaqes bimore, florës dhe faunës së zonës ku do të zbatohet projekti, (i detajuar).
- g) Sistemi i mbrojtës kundër zjarrit dhe masat mbrojtëse ndaj aksidenteve të papritura gjatë fazës së instalimit dhe funksionimit.
- h) Raporti teknik të hartohet duke u bazuar në VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimi të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”.
- i) Plani i rehabilitimit dhe monitorimit të zonave të prekura gjatë ndërtimit dhe pas përfundimit të veprës.
- j) Raporti Vlerësimi të Ndikimit në Mjedis si dhe Relacioni Teknik të përmbajë planimetritë dhe kordinatat e projektit.
- k) Të përfshihen në hartimin e raportit të thelluar të VNM-së të gjitha lejet dhe liçencat që zotëron subjekti për këtë lloj aktiviteti.

Ju sjellim në vëmendje se ky projekt ka ndikim në mjedis në kontekstin ndërkuftar dhe listohet në aktivitetet e Shtojcës I, Pika 8. Tubacionet me diametër të madh të naftës dhe gazit, të Konventës së ESPOO-s.

Pika fokale e kësaj konvente ndodhet në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

Për sa më sipër, jeni të lutur merrni kontaktet e duhura pranë kësaj strukture, lidhur me vazhdimin e procedurave të VNM-së në kontekstin ndërkuftar.

Duke shprehur konsideratat tona për zhvillimin e këtij projekti, Ju falenderojmë për bashkëpunimin,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM I AKM

EDISON KONOMI

Si pjesë e procedurës së Përcaktimit të çështjeve, autoriteti përgjegjës Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, ka filluar procedurën e vlerësimit të ndikimit në kontekstin ndërkufitar (njoftimi i vendit fqinj bazuar në Konventën Espoo) me autoritetin malazez – Ministrinë për Zhvillimin e Qëndrueshëm dhe Turizmin. Procesi është pjesë e procesit të VNMS-së.

2 Përshkrimi i projektit

2.1 Aktivitetet e projektit për seksionin shqiptar të IAP

Aktivitetet/operacionet e projektit

Një tubacion gazi është një sistem i mbyllur i përbërë nga tuba çeliku (të shtrirë dhe groposur nën tokë në të gjithë gjatësinë), instalimet sipërfaqësore dhe pajisjet e nevojshme për funksionimin e sigurt dhe të besueshëm të tij.

Instalimet sipërfaqësore si më poshtë do të ndërtohen përgjatë gjurmës së seksionit shqiptar të IAP:

- CTMS Fier
- BVS Lushnjë
- BVS Rrogoshinë
- PTS/BVS/PRMS Kavajë
- BVS Pezë
- BVS/PRMS Tiranë
- BVS Fushë-Prezë
- BVS/PRMS Fushë-Krujë
- PTS/ BVS/PRMS Mamurras
- BVS Milot
- BVS/PRMS Lezhë
- BVS Ballëdren
- CTMS Bushat

Tubacioni do të ndërtohet si një sistem teknologjik gjithpërfshirës që mund të funksionojë në mënyrë të sigurt edhe pa energji elektrike dhe pa një rrjet telekomunikimi (d.m.th. në mënyrë të pavarur). Në fakt, në rast të dështimit (d.m.th. rrjedhje të gazit) çdo BVS mund të veprojë në mënyrë individuale nëpër seksionet e tubacionit duke aktivizuar valvulat bllokuese. Stacionet e valvulave bllokuese do të pajisen me pajisje bllokuese pneumatike që mbyllin në mënyrë të pavarur rrjedhën e gazit në rast emergjence (tejkalmi i rritjes së gradientit të presionit nga pika e caktuar). Valvulat bllokuese do të instalohen në secilin objekt të tubacionit nëntokësor, përfshirë pikat e fillimit dhe mbarimit të tubacionit (CTMS Fier dhe CTMS Bushat).

Për seksionin shqiptar të gazsjellësit Jonian-Adriatik do të instalohet sistemi i instrumenteve dhe kontrollit. Një kablo me fije optike (FOC) do të mundësojë transmetimin e të dhënave/sinjalit, përfshirë zërin në qendrën e kontrollit.

Tubacioni do të mbrohet nga gërryerja me një sistem të kombinuar. Sistemi i kombinuar përbëhet nga veshja e jashtme kombinuar me mbrojtjen katodike ndaj mbitesionit. Do të instalohet edhe sistemi i tokëzimit.

Kapaciteti dhe teknologjia

Seksioni shqiptar i IAP është projektuar si një sistem 82 bar, me një diametër nominal prej DN 800. Gjatësia e tubacionit (seksioni shqiptar) do të jetë afërsisht 170.3 km.

Tabela 1: Karakteristikat e përgjithshme të projektit

Seksioni i Shqipërisë

Gjatësia	Diametri i tubacionit	Presioni i parashikuar	Kohëzgjatja e projektit	Norma e përgjithshme e rrjedhjes
170.3 km	32"/DN800	82 bar	50 vjet	1,134,400.00 m ³ /h

Burimi: Projekti paraprak i gazsjellësit Jonian- Adriatik - Seksioni i Shqipërisë (WB15-REG-ENE-01) - Përshkrimi i projektit teknik, IPF6, Shtator 2019

Tubacioni është hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë, dhe në përputhje me standartet përkatëse kombëtare dhe ndërkombëtare.

Përpara ndërtimit të tubacionit, d.m.th. përpara hapjes së kanalit, bëhet shënjimi (me piketa) në terren i brezit të punimeve (korridori i punimeve). Gjerësia e brezit të punimeve varet nga diametri i tubacionit dhe lloji e pjerrësia e terrenit. Gjerësia e brezit të punimeve do të jetë 7+13 m = 20 m në toka bujqësore, kullota dhe shkurreta, dhe 6+12 = 18 m në zonat pyjore. Thellësia e kanalit varet nga kategoria e destinuar e përdorimit/gërmimit të tokës në të cilën vendoset tubacioni, por si rregull kjo thellësi duhet të jetë nën thellësinë e ngrirjes së tokës dhe, si e tillë, nuk ndikon në përdorimin e mëvonshëm të saj për qëllime bujqësore (mbulimi zakonisht 1.0 deri 1.2 m).

Shtirimi i tubacioneve është i mundur duke përdorur metodat e mëposhtme:

- metoda e shtrirjes së tubacioneve në kanalet e gërmuar (teknologjia me prerje të hapur),
- metoda të shtrimit të tubacionit pa kanal (shpim me shtytje, shpim horizontal i drejtuar etj.).

Shtirja e tubacioneve me metodën me prerje të hapur, e cila është metoda standart, do të përdoret kudo ku asnjë kufizim nuk kërkon aplikimin e teknikave pa kanal.

Shpimi horizontal i drejtuar zbatohet për kalimin nën rrugë (autostradat, rrugët rajonale dhe shtetërore) dhe hekurudhat, kur është e pamundur të zbatohet prerja e hapur. Për më tepër, shpimet horizontale të drejtuar preferohen për disa burime ujore, ku hapja e kanaleve mund të shkaktojë shqetësime të rënda në mjedis.

Për tubacionin nevojitet gërmimi i një kanali. Shtresa sipërfaqësore e tokës do të ruhet veçmas për t'u ripërdorur. Përgjatë gjurmës së tubacionit pastrohet dhe sheshohet një korridor prej 20 m i të drejtës së rrugës së kalimit (servitutit). Tubat prej çeliku me diametër 32-inch do të transportohen me kamionë për në brezin e punimeve. Tubat do të vendosen duke bashkuar fundet. Tubat mund të bashkohen me paisje të posaçme që t'i përshtaten ndryshimeve të terrenit ose drejtimit të gjurmës. Tubacioni saldohet në sipërfaqe. Të gjitha saldimet janë subjekt i testeve automatike për t'u siguruar që përmbushin standartet kombëtare dhe ndërkombëtare. Dhera të imët hidhen në kanal përreth tubacionit duke shërbyer si jastëkë mbrojtës.

Tabela e mëposhtme paraqet zonat e sigurisë për tubacionet e transmetimit të gazit.

Tabela 2: Zonat e sigurisë së tubacionit

Zona prioritare e sigurisë 5 m*	5 metra në secilën anë të boshtit të tubacionit	Eshtë e ndaluar të mbillen bimë me rrënjë më të gjata se 1 metër ose bimë që kultivohen duke gërmuar më shumë se 0,5 metra. Gjatë ekzistencës së tubacionit, është i ndaluar ndërtimi i çdo objekti tjetër të infrastrukturës. Çdo veprimtari që pengon ose rrezikon ekzistencën dhe funksionimin e linjës së gazit është e ndaluar. Nuk lejohet të vendosen kampingje të përhershëm (p.sh. kampingje automjeteve, kampe, kontejnerë), ruajtja e pjesës më të madhe të materialeve të vështira për t'u transportuar. Vendosja e parkingjeve në zonën prioritare të sigurisë lejohet vetëm me miratimin e pronarit të tubacionit.
Zona e mbrojtjes (buferike) 30 m	30 metra në secilën anë të boshtit të tubacionit	Ndalohet ndërtimi në të ardhmen i objekteve të banimit.

Zona më e gjerë e sigurisë/Zona buferike 200 m	200 metra në secilën anë të boshtit të tubacionit	Kjo zonë shërben për përcaktimin e kategorisë së vendodhjes. Është zonë në të cilën objektet e tjera mund të ndikojnë në sigurinë e tubacionit të gazit. Bazuar në nivelin e dendësisë së popullsisë, duhet të ndërmerren masa shtesë mbrojtëse.
--	---	--

* Gjerësia e zonës prioritare të sigurisë duhet të përcaktohet nga pronari në varësi të diametrit të tubacionit dhe në varësi të llojit të masave të funksionimit dhe mirëmbajtjes. Në raste të veçanta, veçanërisht për qëllime projektimi, qëllime ndërtimore – teknike ose operacionale, mund të përcaktohen zona prioritare të sigurisë më të gjera ose më të ngushta. Shënimi i një zone prioritare të sigurisë në sipërfaqen e rrjetit të transportit publik mund të zëvendësohet përmes dokumenteve zyrtare të miratimit (p.sh. leja ose marrëveshja kontraktuale për përdorimin e rrugës). Kjo marrëveshje kontraktuale duhet të rregullojë marrjen e aprovimit dhe shënjimin e zonës së zakonshme të sigurisë prioritare të tubacionit, në rastin e rishtimit të sipërfaqeve të rrjetit të transportit publik.

Më tej integriteti i tubacionit verifikohet duke kryer testimin hidrostatik.

Faza operacionale bazohet në jetëgjatësinë e projektuar të të gjithë sistemit të gazsjellësit. Jetëgjatësia e projektuar e të gjithë pajisjeve, objekteve dhe tubacionit supozohet 50 vjet, bazuar në praktikën e zakonshme dhe eksperiencën e projekteve të tubacioneve të gazit në rajon në të shkuarën.

Tubacioni do të monitorohet 24 orë në ditë për 365 ditë të vitit nga qendra e kontrollit mbikqyrës.

Lwndwt e para, pwrdorimi i ujit dhe energjisw

Për të shmangur dëmtimin e veshjes së tubacionit, materiali i dyshemesë së kanalit dhe mbushjes përreth tubit, do të konsistojë në inerte me madhësi të ndryshme të grimcave, me vëllim të vlerësuar prej afro 1.600 m³/km të gjurmës së tubacionit. Materiali i përshtatshëm nga gjurmimi i kanalit (p.sh. ranor) do të riciklohet për dyshemenë dhe mbushjen anësore. Materiali i gjurmimeve do të përdoret maksimalisht për rimbushjen e kanalit.

Gjatë aktiviteteve ndërtimore do të përdoren materiale të ndryshme të nevojshme për zbatimin e projektit. Në tabelën e mëposhtme është dhënë një vlerësim i konsumit të parashikuar të materialeve kryesore gjatë aktiviteteve ndërtimore.

Tabela 3: Vlerësimi i konsumit të materialeve

Materiali	Sasia
Çelik	52,000 t
Beton	1,000 t
Shirit polietileni	250 t
Rërë	280,000 t

Gjatë fazës së ndërtimit do të përdoren pajisje të rënda dhe makineri me motor me naftë. Nafta do të transportohet për në sheshin e ndërtimit përmes rrugëve të miratuara për transport karburanti. Vlerësimi për karburantin tregohet në Tabelën në vijim.

Tabela 4: Vlerësimi i konsumit të karburantit për aktivitetet e ndërtimit

Materiali	Përdorimi	Sasia (m ³)
Naftë	Pajisjet dhe automjetet	80,000

Afati kohor i ndërtimit dhe funksionimit

Ndërtimi i përgjithshëm i seksionit shqiptar të projektit përfshirë marrjen e Lejes Zhvillimore parashikohet të nisë në mes të vitit 2021 dhe do të zgjasë përafërsisht 4.5 vjet, ndjekur nga komisionimi afërsisht në fund të 2025. Programi përfundimtar specifik i ndërtimit do të varet nga çështje të ndryshme teknike dhe kontraktuale dhe do të marrë në konsideratë faktorët mjedisorë dhe socio-ekonomikë. Këto janë trajtuar më në detaje në seksionet e mëposhtme të këtij dokumenti. Nëse ndërtimi fillon në 2021, komisionimi i projektit do të kryhej afërsisht në fund të 2025.

Tasks			
Name	Begin date	End date	Duration
DEVELOPMENT PERMITTING	5/3/21	9/29/21	150
Development Authorizations Process	5/3/21	9/29/21	150
DETAILED DESIGN	7/2/21	11/23/22	510
Procurement (Scope, contracting)	7/2/21	8/30/21	60
Geodetical survey and report	8/31/21	12/28/21	120
Geotechnical survey and report	8/31/21	11/28/21	90
Detailed design incl. Bills of Quantities and specifications	8/31/21	11/23/22	450
CONSTRUCTION TENDERS PREPARATION	9/25/22	1/22/23	120
SoW, ITT, VL, Technical Documentation	9/25/22	1/22/23	120
CONSTRUCTION PERMITTING	10/25/22	4/22/23	180
Construction Authorizations process	10/25/22	4/22/23	180
MATERIALS PROCUREMENT (Tendering (6 mts) and Fabrication (9 mts))	10/25/22	1/17/24	450
Pipes, valves and other equipment: fabrication, expediting, inspection and shipping	10/25/22	1/17/24	450
LAND ACQUISITION	7/27/22	7/21/23	360
Easement (Right of Way)	8/26/22	7/21/23	330
Compensations for damages during construction	8/26/22	7/21/23	330
Purchase of plots for Gas Stations	7/27/22	6/21/23	330
MAIN CONTRACT NEGOTIATIONS AND CONTRACTING	2/22/23	7/21/23	150
Contracting phase	2/22/23	7/21/23	150
CONSTRUCTION PREPARATION WORKS	7/22/23	1/17/24	180
Deforestation: specifications, reports, permitting, works	7/22/23	12/18/23	150
Archaeological surveys and Unexploded ordnances detection	7/22/23	12/18/23	150
Access roads upgrade and preparation	7/22/23	1/17/24	180
CONSTRUCTION	7/22/23	7/10/25	720
Camps	7/22/23	2/16/24	210
Line Pipes Storage Yards	7/22/23	11/18/23	120
Pipeline Construction (ROW, grading, stringing, bending, welding, NDT, Coating, laying, back filling, restoration, tie-ins)	9/20/23	7/10/25	660
Pipeline Facilities Construction (Civil, Mechanical, Electrical and I&C Works, Tie-ins)	2/17/24	7/10/25	510
Pre-Commissioning	5/12/25	7/10/25	60
OPERATING PERMIT AND COMMISSIONING	6/11/25	9/8/25	90
Operating permit and commissioning	6/11/25	9/8/25	90

Mbetjet që do të krijohen, lloji dhe sasia

Mbetjet e krijuara gjatë punimeve të ndërtimit klasifikohen në mbetje jo të rrezikshme dhe të rrezikshme.

Në tabelën e mëposhtme janë dhënë sasi të mbetjeve si më sipër bazuar në përvojën e fituar nga projekte të ngjashme dhe statusin aktual të hartimit të projektit:

Lloji i mbetjeve	Sasia e përafërt
Mbetje ambalazh i plastike	17 t
Mbetje ambalazhi letre dhe kartoni	16 t
Mbetjet nga saldimit	4 t
Përzierje bituminoze që përmbajnë zifte qymyri	120 m ³
Beton	520 m ³
Rroba mbrojtëse të kontaminuara nga substanca të rrezikshme	520,000 m ³
Mbetje të përziera nga ndërtimi dhe të prishjeve, të tjera nga ato të përmendura në 17 09 01, 17 09 02 dhe 17 09 03	800 m ³
Materiale izolimi të tjera nga ato të përmendura në 17 06 01 dhe 17 06 03	30 m ³

Mbetjet e krijuara gjatë punimeve të ndërtimit do të grumbullohen të ndara sipas llojeve të tyre. Të gjitha mbetjet do të ruhen në zonën e magazinimit të përkohshëm përpara largimit dhe depozitimit përfundimtar. Vetëm ndërmarrjet e autorizuara duhet të përfshihen në aktivitetet e depozitimit përfundimtar.

Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet mbetjeve të rrezikshme që do të gjenerohen kryesisht nga mekanika dhe mirëmbajtja e automjeteve (mbetjet e naftës), ndonëse në sasi të vogla.

Gjatë hapjes së kanalit, do të gjenerohen sasi të mëdha të materialit të gërmuar (rreth 1,307,000 m³). Një pjesë e materialit do të përdoret për të ri-mbushur kanal. Pjesa tjetër e materialit do të ruhet veçmas para largimit dhe depozitimit përfundimtar.

Nga veprimtaria njerëzore e punëtorëve në sheshin e ndërtimit do të prodhohen sasi të vogla mbetjesh urbane. Përgjatë gjithë linjës IAP, do të ndërtohen 3 kampe të mëdhenj (rreth 60 - 100 persona) dhe 2 kampe më të vegjël (rreth 20 - 50 persona). Të gjitha mbetjet urbane dhe mbetjet

e tjera të ngjashme do të mblihen të ndara dhe do të trajtohen sipas procedurës lokale të menaxhimit të mbetjeve urbane.

2.2 Vendndodhja e zonës së projektit

Vendodhja e projektit

Ndonëse projekti objekt i këtij raporti përfaqëson vetëm seksionin shqiptar të IAP, më poshtë jepet një vështrim i përgjithshëm i projektit IAP dhe instalimeve të lidhura me të.

IAP është një tubacion i propozuar për gazin natyror në të ashtuquajturin Korridor Jugor të Gazit i cili do të sjellë gaz nga rezervat e reja të Rajonit Kaspik në Evropën Jugore dhe Qendrore. IAP do të mbështesë Evropën të arrijë objektivin e saj strategjik të sigurimit të mëtejshëm të furnizuesve të gazit dhe plotësimin e nevojave në rritje për energji.



Figura 1: Gazsjellësi Jonian-Adriatik (projekti) dhe lidhja me TAP (infrastrukturë e lidhur me të)

Burimi: https://www.energy-community.org/dam/jcr:979e0807-e6f3-4622-882d-c7ef0a912e52/INFWS052018_IAP.pdf

Pika fillestare e IAP është pika lidhëse me sistemin e TAP (instalimin përkatës) pranë stacionit të kompresorëve (CS3) të tubacionit TAP në zonën e Fierit.

Pika fundore e seksionit shqiptar të IAP është pika lidhëse me seksionin e Malit të Zi në lumin Buna.

Zona e projektit për të cilën kërkohet miratimi është hapsira që përfshin:

- zonat për vendosjen e tubacionit të gazit, kabllot me fibër optike, kabllot e mbrojtjes katodike, anoda për të cilat nuk përcaktohen parcelat kadastrale (blerja e pjeshme e tokës),
- zonat për instalimet sipërfaqësore për të cilat është e detyrueshme të përcaktohen parcelat kadastrale sipas vizatimeve përkatëse, për secilën vendndodhje (blerje e plotë e tokës).

Korridorin e tubacionit përcaktohet në atë mënyrë që të mbulojë një hapësirë prej 30 m të gjerë në secilën anë të aksit të tubacionit (30 m+30 m, 60 m në total).

3 Analizat e alternativave të konsideruara

Gjurma e IAP bazohet kryesisht në rezultatet e projekteve të mëparshme WBIF TA, WB5-REG-ENE-03 “SF dhe VNMS për tubacionin Jonian - Adriatik (IAP)” (përfunduar në vitin 2014) dhe WB11-ALB-ENE-01 “Master Planin e Gazit për Shqipërinë”, që përfshinte Projektet e Investimeve Prioritare dhe Vlerësimin Strategjik Mjedisor (përfunduar në 2017).

Korridorin e përzgjedhur i IAP gjatë fazës së Studimit të Fizibilitetit (SF) të zhvillimit të projektit u përfshi në dokumentet e planifikimit të territorit shqiptar (Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit 2015 - 2023 (2016)).

Korridorin e propozuar i tubacionit i identifikuar në studimin e fizibilitetit të IAP (WB5-REG-ENE-03 “FS dhe VNMS për tubacionin Jonian - Adriatik (IAP)”, përfunduar në vitin 2014) dhe modifikuar në Master Planin e Gazit dhe Projektin e Investimeve Prioritare 3 (PIP3) për Shqipërinë (WB11-ALB-ENE-01 “Master Plani i Gazit për Shqipërinë”, përfunduar në vitin 2017) u analizua dhe optimizua gjatë konfirmimit të gjurmës në Projektin paraprak.

Ky proces i optimizimit u shoqërua me analizën mjedisore dhe sociale, me qëllim verifikimi nëse vlerësimi i mëparshëm i makrokorridorit ishte kryer në mënyrë korrekte dhe ndërkohë nuk ishin shfaqur probleme apo kufizime të reja që do ta ndryshonin vlerësimin. Duke qenë se nuk u zbulua asnjë problematikë e tillë, e cila nuk mund të zbutet me anë të një ndryshimi të vogël të drejtimit të gjurmës, ndryshimet e mëdha të drejtimit të gjurmës të kryera në fazat e hershme janë pranuar në parim.

4 Përshkrimi i kushteve bazë të mjedisit

4.1 Karakteristikat e mjedisit fizik

4.1.1 Klima dhe meteorologjia

Pozita gjeografike e Shqipërisë përcakton tipin e klimës së saj mesdhetare të karakterizuar nga dimra të butë dhe të lagësht që pasohen nga vera të nxehta dhe të thata. Kushtet klimatike specifike ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme sipas rajoneve. Fushat bregdetare kanë një ndikim të fortë detar i cili dobësohet drejt lindjes dhe brendësisë së kontinentit, duke u bërë shkak për temperaturamë të ulta dhe sasi më të vogël reshesh.¹

¹ Burimi: Komunikimi i Tretë Kombëtar i Republikës së Shqipërisë nën KKKBNK, Tiranë, Qershor 2016




Figura 2: Tipet e klimës së Shqipërisë sipas Köppen

Source: Wikipedia (https://en.wikipedia.org/wiki/Climate_of_Albania)

Bazuar në ndarjen klimatike të territorit shqiptar, zona e projektit bën pjesë në Zonën e Klimës Mesdhetare Fushore klasifikuar si Csa sipas Köppen (Figura 2). Si referencë për kushtet klimatike në zonën e projektit do të përdoren të dhënat meteorologjike për Tiranën.

4.1.2 Gjeologjia dhe sizmiteti i zonës së projektit

4.1.2.1 Karakteristikat gjeologjike

Në mënyrë të përgjithshme, Shqipëria është pjesë e Dinarideve, një strukturë gjeologjike e degëzimit jugor të brezit të rrudhosur alpin. Gjurma e IAP shtrihet në pjesën perëndimore të Shqipërisë, kryesisht në zonën Jonike (pjesa jugore dhe e mesme e gjurmës IAP), ndërsa pjesa veriore e gazsjellësin kalon në zonat tektonike Kruja dhe Krasta - Cukali.

Karakteristika kryesore strukturore e zonës Jonike është prania e një serie brezash antiklinalë dhe sinklinalë, që shtrihen paralel dhe sub-paralel pothuajse përgjatë gjithë gjatësisë së zonës në një pozicion sub-meridional. Si brezat antiklinalë edhe ata sinklinalë ndërtohen nga struktura të shumta më të vogla që pasojnë njëra-tjetrën në drejtimin submeridional.

Në pjesën më të madhe gjurma e IAP kalon kryesisht nëpër terrene të sheshtë të cilët ndërtohen nga depozitime klasterike kuaternare dhe depozitime klasterike dhe karbonatike të Neogjenit. Megjithatë, korridori i gazjellësit, përafërsisht nga progresiva 128+000 deri në 142+000, në afërsi të zonës përreth qytetit të Lezhës, kalon nëpër terren relativisht malor. Formacionet gjeologjike që ndërtojnë këtë zonë janë kryesisht gëlqerorë dhe silicorë të Kretakut.

Gjurma e IAP përfshihet në 5 plansheta të hartës gjeologjike (sipas qarqeve), nga jugu në veri si në vijim: Fier, Tiranë, Durrës, Lezhë dhe Shkodër.

Vrojtimit në terren përgjatë gjurmës së IAP përfshinë vëzhgime të përgjithshme të terrenit si: ndërtimi gjeologjik, vizibiliteti i proceseve gjeologjike, largësia e trupave ujorë nga gjurma dhe niveli i ujërave në rrjedhat ujore dhe kanalet, analiza e shtretërve të lumenjve (identifikimi i akumulimeve ekzistuese dhe proceseve të erozionit), pjerrësia e terrenit dhe erozioni i dukshëm i shpateve.

4.1.2.2 Karakteristikat hidrogeologjike

Bazuar në karakteristikat e tyre hidrogeologjike akuiferët në Shqipëri mund të klasifikohen në:

- Akuiferë porozë

- Akuiferë me përhapje të gjerë dhe ujëmbajtje të lartë
- Akuiferë me përhapje të kufizuar ose të paqëndrueshme në shtrirje dhe me ujëmbajtje mesatare ose të ndryshme
- Akuiferë me çarje, përfshirë akuiferë karstikë dhe akuiferë me më pak poro-çarje
- Akuiferë me përhapje të gjerë dhe ujëmbajtje të lartë
- Akuiferë me përhapje të gjerë dhe ujëmbajtje të moderuar deri në të ulët
- Akuiferë me poro-çarje me ujëmbajtje të ndryshme
- Akuiferë të çarë dhe porozë me ujëmbajtje lokale ose shumë të varfër në ujëra nëntokësorë
- Akuiferë të çarë me ujëmbajtje lokale dhe rezerva të kufizuara deri në mesatare
- Akuiferë të çarë dhe porozë me ujëmbajtje lokale dhe rezerva të kufizuara
- Shkëmbinj shumë të varfër në ujëra nëntokësorë

Në fillim të saj (nga progresiva 0+000 deri afërsisht në progresivën 15+000) gjurma e gazsjellësit kalon nëpër depozitimet Kuaternare të cilat përbëhen nga argjila, rëra dhe herë-herë zhavorre. Në këto depozitime nuk gjenden akuiferë.

Akuiferi kryesor përgjatë gjurmës së gazsjellësit brenda basenit të Semanit (afërsisht nga progresivi i gjurmës së IAP 15+000 deri në progresivin 40+000) është në fushën e Lushnjës.

Në veri të lumit Shkumbin gjurma e IAP futet në fushën e Kavajës (nga progresiva 40+000 deri në progresivën 53+000). Shtresat ujëmbajtëse në fushën e Kavajës përfaqësohen kryesisht nga zhavorre dhe rëra të konsoliduara dobët dhe në të cilat mund të gjenden akuiferë me përhapje të kufizuar ose të paqëndrueshme në shtrirje dhe me ujëmbajtje të ndryshme.

Nga progresiva 56+600 deri në progresivën 62+000, përshkon zonën kodrinore ndërtuar nga formacione pa akuiferë të rëndësishëm. Gjurma e IAP nga progresiva 62+000 deri në afërsi të progresivës 120+000 përshkon një zonë që shtrihet në dy basene lumore, në jug baseni i lumenjve Ishëm-Erzen dhe në veri baseni i lumit Mat. Nga progresiva 62+000 deri në progresivën 85+000 gjurma e IAP përshkon zonë kodrinore ndërtuar nga formacione pa akuiferë domethënës, përveç rreth progresivës 67+300 ku ndërpret një korridor të ngushtë të akuiferit të Erzenit. Në veri, nga progresiva 85+000, gjurma e IAP përshkon akuiferin Gramëz-Thumanë. Në jug të lumit Mat (progresiva 100+000) gjurma e gazsjellësit ndërpret akuiferin zhavorror të Fushë Kuqes.

Gjurma e IAP nga progresiva 120+000 deri afërsisht në progresivën 170+298 përshkon një zonë që shtrihet në dy basene lumore, në jug basenin e lumit Mat dhe në veri basenin e Drinit. Nga fillimi i këtij seksioni në veri të lumit Mat deri në progresivën 135+000, IAP përshkon fushën e Lezhës.

4.1.2.3 Rreziqet gjeologjike

Ekzistojnë tre lloje rreziqesh gjeologjike të identifikuara përgjatë gjurmës së IAP: përmytjet, paqëndrueshmëria e shpateve dhe tërmetet.

Përmytjet ndodhin në Shqipëri kryesisht për shkak të kushteve topografike dhe klimatike. Në përgjithësi, burimet ujore në Shqipëri janë të bollshme, me një shpërndarje stinore jo të rregullt. Gjurma e IAP përshkon dy zona kryesore të prirura ndaj përmytjeve, të ndodhura në pjesën perëndimore të Shqipërisë. Zona në jug është në basenet e Semanit dhe Shkumbinit. Zonat e përmytjeve në jug (nga progresiva e IAP 0+000 deri në progresivën 55+000), gjenden në fushat e Lushnjës dhe Kavajës, ndërsa në veri zonat e përmytjeve janë më të mëdha dhe gjenden përreth lumenjve: Ishëm, Mat, Drin dhe Bunë (nga progresiva e IAP 90+000 deri në progresivën 170+300).

Përgjatë seksionit të gjurmës së IAP ndërmjet progresivës 0+000 dhe 52+000 ekzistojnë rreziqe të mundshme përmytjesh brenda kufijve të basenit të Semanit. Përmytjet vjetore ndodhin përgjatë lumenjve Seman dhe Shkumbin që përfaqësojnë lumenjtë kryesorë në këtë pjesë të gjurmës së IAP.

Përgjatë seksionit të gjurmës së IAP përafërsisht ndërmjet progresivës 67+000 deri në 68+000 ekzistojnë rreziqe të mundshme nga përmbytjet përgjatë lumit Erzen. Bazuar në të dhënat e disponueshme përmbytjet vjetore në këtë pjesë janë të kufizuara përgjatë shtratit kryesor të lumenjve.

Midis progresivave përafërsisht 90+000 dhe 130+700 të gjurmës së IAP ekzistojnë rreziqe të mundshme nga përmbytjet përgjatë lumenjve Ishëm, Lana, Tirana, Sharga, Gjola, Droja, Mat dhe Drin.

Zona nëpër të cilën kalon seksioni i gjurmës së IAP nga përafërsisht progresiva 52+000 në progresivën 81+500 përfaqëson zonën më të gjerë të prirur ndaj **rrëshqitjes së tokës**. Gjurma e përzgjedhur në Projektin paraprak është rezultat i analizës së hollësishme të topografisë dhe karakteristikave të tjera të terrenit që përshkon, gjatë së cilës nga inxhinierët e projektimit u aplikuan udhëzimet bazë dhe kriteret e rrugës për të shmangur shpatet e pjerrëta dhe shpatet e prirura ndaj paqëndrueshmërisë në çdo kohë.

Shqipëria është një nga vendet sizmike më aktive në Evropë. Shumica e **tërmeteve të fortë** që ndodhin në vend, ndodhin përgjatë brezave të përcaktuara mirë si ai bregdetar Joniano-Adriatik që përkon me kufirin midis pllakës evropiane dhe mikropllakës Adria. Gjurma e IAP përshkon shtresat aktive si në vijim, progresivat: 19+000, 20+000, 60+500, 77+700, 142+600, 163+500 dhe 168+250. Efektet e lëvizjes përfshijnë zhvendosjen e shtresave sipërfaqësore të prishjes, aktivizimin e rrëshqitjeve të tokës dhe fenomenet e lëngëzimit.

Pjesa më e gjerë e Ultësirës Pranadriatike të Shqipërisë ka potencial për fenomene të lëngëzimit. Lëngëzimi është humbja e fortësisë së tokës së shkrifët (pa kohezion) të ngopur për shkak të rritjes së presionit të ujit të poreve dhe uljes së efektit të stresit përkatës gjatë ngarkimit ciklik. Depozitimet e Holocenit janë më të ndjeshme ndaj lëngëzimit. Gjurma e gazsjellësit kalon mbi këto depozitime të përhapura gjerësisht në luginat Kuaternare kryesisht në këto segmente: midis përafërsisht progresivave 0+000 dhe 54+000, 84+000 dhe 130+000, dhe 139+000 dhe 170+298, në total rreth 131 km.

4.1.2.4 Karakteristikat hidrologjike

Në përgjithësi gjurma e IAP përshkon 5 basene kryesore të Shqipërisë: Seman, Shkumbin, Ishëm-Erzen, Mat dhe Drin.

4.1.3 Gjeomorfologjia e zonës së IAP

Zona e projektit është e vendosur në përgjithësi në rajon fushor. Në anën perëndimore të zonës gjendet terreni fushor i bregdetit të Adriatikut, ndërsa në anën lindore pjesa kodrinore dhe malore të Ultësirës Perëndimore. Në pjesën qendrore dhe veriperëndimore vendosen vargje kodrinore që shtrihen me drejtim nga veriu në jug.

Zonat gjeomorfologjike më të dallueshme nga pikëpamja e ndërhyrjes në linjën e planifikuar janë:

- Terren fushor (i rrafshët): seksionet: 0+000 - 52+000, 81+000 - 130+500, 142+500 - fundi i linjës së IAP në Shqipëri.

Relievi është kryesisht i sheshtë me dinamikë shumë të ulët. Nuk ka forma specifike ose domethënëse të mikrorelievit. Tokat janë kryesisht të përbëra nga rëra dhe argjila. Gjurma e IAP ndërpret disa kanale kullimi dhe disa lumenj domethënëse: Semanin në 8+300, Shkumbinin në 39+000, Erzenin në 67+700, Tirana ndërmjet 86+500 dhe 89+000, Gjolën në 100+500, Matin në 121+500 dhe lumenj Drin në 140+500 dhe në fund Bunën në pikën fundore të pjesës shqiptare të linjës IAP. Brigjet e lumenjve që ndërpriten nga gjurma e planifikuar janë kryesisht natyrore dhe të prera në terrene.

- Zona kodrinore: seksionet: 52+000 - 81+000, 130+500 - 142+500

Relievi krijon një zonë dinamike. Strukturat e lirshme dhe të paqëndrueshme mbizotërojnë në përbërjen e tokës. Lartësitë nuk kalojnë 500 m m.n.d. dhe për këtë arsye kjo zonë mund të

përkufizohet si kodrinore. Orientimi i përgjithshëm i kreshtave të kodrave është VP-JL, dhe midis fundit të shpateve ka gryka dhe lugina shumë të ngushta.

4.1.4 Toka dhe toka bujqësore

Peisazhi pedologjik shqiptar është shumë i larmishëm dhe kompleks. Shumica e tokave shqiptare klasifikohen si Regosole. Kambisolet, Litosolet dhe Luvisolet janë kategoritë e tjera më të rëndësishme. Një zonë e vogël e tipit Kastanozem është identifikuar edhe në luginat verilindore. Tokat tipike në zonën bregdetare perëndimore janë Fluvisols, Luvisols, Faeozems dhe Vertisols.

Bujqësia është një sektor i rëndësishëm ekonomik në Shqipëri, i cili siguron 16.79% në 2009 dhe 19.63% në 2013 të vlerës së prodhimit të brendshëm bruto. Nga të gjithë tokat bujqësore të Shqipërisë, 561,000 ha përbëjnë tokën e punueshme. Rreth 43% ose 304,000 ha të tokës bujqësore përfshihen në tokat bujqësore me cilësi përgjithësisht të mira prodhuese.²

Gjurma e IAP përshkon kryesisht tokat bujqësore të qarqeve Shkoder, Lezhë, Durrës, Tiranë dhe Fier. Pas vrojtimit në terren dhe analizës së tokës bujqësore përgjatë itinerarit dhe plotësuar me hartën dixhitale ortofoto të Shqipërisë, u arrit në përfundim se gjurma e planifikuar e gazsjellësit kalon kryesisht në njësi më të vogla bujqësore (ngastra) të tokës së punueshme, kullotave dhe tokës bujqësore me sipërfaqe të konsiderueshme vegjetacioni natyror

4.1.5 Pejsazhi

Zona e projektit përgjithësisht vendoset në rajonin e zonës bregdetare me terrene të sheshta. E gjithë zona është e dominuar nga bujqësia. Përveç karakterit bujqësor, tiparet kryesore të pejsazheve janë relievi i sheshtë, rrjedhat ujore dhe qendrat e banuara. Në anën perëndimore të zonës janë kënetat dhe bregdeti i Adriatikut, dhe në anën lindore është zona kodrinore e Ultësirës Perëndimore të Shqipërisë. Në pjesën qendrore dhe VP ndodhen vargjet kodrinore të shtrira në drejtimin veri-jug. Ky kompleks ka përcaktuar pejsazhin e karakterit bujqësor dhe dinamikën e ulët vizuale.

² Plani i Përgjithshëm Kombëtar; Dokumenti i parë kombëtar i planifikimit të territorit 2015-2030; 14.12.2016.




Figure 3: Landscape units in coastal areas of Albania
Source: ASIG Geoportal WMS

4.2 Biodiversiteti dhe habitatet

4.2.1 Përcaktimi i zonës së studimit

Bazuar në përvojën dhe praktikën e mëparshme, zona potenciale e ndikimit të tubacionit të gazsjellësit është përcaktuar 400 m prej aksit të tubacionit (200 m në çdo anë të tubacionit) si dhe 400m nga objektet. Zona e ndikimit direkt përsa i përket tokës dhe vegetacionit përcaktohet si sipërfaqja apo traseja e tubacionit prej 20 m gjerësi në tokat bujqësore, livadhe dhe shkurreta, ndërsa në terrenet pyjore kjo përcaktohet në 18 m.

Zona e përgjithshme e analizës për projektin bazohet në përvojën dhe dokumentacionin e projekteve të ngjashme, karakteristikat e zonës së projektit dhe ndikimet e mundshme. Janë përcaktuar këto zona buferike si në vijim:

- për karakteristikat e përgjithshme të habitatit (vegetacioni dhe llojet) bazuar në hartën e përdorimit të tokës, do të shqyrtohet një zonë prej 300 m në çdo anë të aksit të tubacionit, pra një korridor me gjerësi totale prej 600 m;
- për hartëzimin e habitateve një korridor i punimeve (20 m), përfshirë dhe analizimin e tyre;
- për ndikimet në zonat e mbrojtura, u konsiderua një korridor prej 600 m në të dy anët e aksit të tubacionit, pra një gjerësi totale prej 1200 m është marrë në konsideratë për analizën e këtij studimi. Ky korridor i gjerë është konsideruar për masa mbrojtëse për ruajtjen e biodiversitetit përfshirë dhe lëvizjen e llojeve migratore përgjatë zonës së mbrojtur dhe habitateve të ndikuara direkt apo indirekt nga aktivitetet e projektit (shpendët).

Përveç zonës së përgjithshme të analizës (buferike) janë konsideruar karakteristikat ekologjike të individëve dhe habitatet me rëndësi të veçantë në projekt. Zona ekologjike e përshtatshme për analizë (EAAA - the ecologically appropriate area of analysis) është vlerësuar për të gjitha llojet/habitatet e identifikuar si tipare prioritare të biodiversitetit (PBF - priority biodiversity feature) ose habitate kritikë (CH). Hartat dhe të dhënat kryesore për çdo PBF dhe CH janë treguar në kapitullin Ndikimi në tiparet prioritare të biodiversitetit dhe habitatet kritikë.

4.2.2 Biodiversiteti me rëndësi prioritare

Gjatë analizës fillestare për këtë studim u evidentua fakti që disa habitate dhe lloje përgjatë trasesë të IAP paraqiten si kandidatë të mundshëm për kategorinë e biodiversitetit me rëndësi ruajtje dhe habitateve kritikë.

Rezultatet e vlerësimit për zonat dhe llojet me rëndësi prioritare për biodiversitetin pasqyrohen në tabelën më poshtë (Tabela 5):

Tabela 5: Identifikimi i veçorive prioritare për biodiversitetin brenda zonës së projektit

Kriteret përgjithshme	Kritere për biodiversitetin me rëndësi prioritare	Identifikimi i tipareve/veçorive me rëndësi prioritare biologjike në zonën e projektit
1. Ekosistemet prioritare		
Zjarret në pyje, zona bujqësore dhe të ruajtjes dhe toka të tjera, si dhe dispozitat ligjore për ndalimet e zjarrit dhe përdorimit të zjarreve për të zvogëluar lëndën vegjetative të djegshme duke zvogëluar kështu rrezikun e zjarreve, janë të rregulluara me ligjin “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor” dhe ligjin “Për fondin kullosor”. Përdorimi i zjarrit për të përmirësuar biodiversitetin rregullohet me ligjin “Për fondin kullosor”.

Ndikimet negative të zjarreve janë më të shumta në pyjet halore dhe më pak në korije dhe shkurreta. Ndikimet kryesore negative të zjarreve janë erozioni pas zjarrit, shkatërrimi i mbulesës së rigjenerimit dhe shqetësimi i strukturës së tokës dhe regjimit të ujërave. Një ndikim tjetër negativ është ulja e produktivitetit pyjor.

Ndotja e tokës

Në Shqipëri ka zona kafe (vendodhje post-industriale), impiante industriale të braktisura, miniera të vjetra, vendepozitime mbetjesh të krijuara nga shfrytëzimi i mineraleve (dampa) të cilat shkaktojnë ndotje lokale të tokës.

seksioni i gazsjellësit (nga 10+000 në 20+000 m) shtrihet në zonën me toka të kripura.

Nga 0+000 në 10+000 m, 20+000 në 50+000 m dhe nga 80+000 në 110+000 m, gazsjellësi kalon nëpër zonën me toka të varfëra në ushqyes për shkak praktikave bujqësore të zbatuara. Seksioni fundor i rrugës së gazsjellësit (nga 120+000 në 169+774 m) është në zonën që karakterizohet nga ndikime natyrore në tokë siç është përmbytja.

Tokat në zonën më të gjerë të gazsjellësit përmbajnë përqendrime të rritura të metaleve të rënda (Ni, Pb, Co, Cr dhe Cu). Aktivitetet njerëzore janë shkaku kryesor i rritjes së përqendrimeve të metaleve të rënda në tokë, për shkak të minierave (bakrit) dhe përdorimit të agjentëve kimikë në prodhimin bujqësor.

4.4 Mjedisi socio-ekonomik

Në të kaluarën, Shqipëria ka pësuar reforma të shumta territoriale administrative. Reforma e fundit administrative e rëndësishme në Shqipëri u krye në vitin 2014 dhe u zbatua në vitin 2015. Karakteristika kryesore e ndarjes së re administrative është një rënie e konsiderueshme e numrit të bashkive në Shqipëri.

Ndarja e përgjithshme administrative, gjeografike dhe statistikore e Shqipërisë në nivelin rajonal (NUTS dhe kombëtar) në raport me gjurmën e gazsjellësit IAP është paraqitur në Figura 9.




Figura 9: Zona e projektit IAP në nivelin rajonal (NUTS dhe kombëtar)

Burimi: Instat, Instituti i Statistikave: Baza e të dhënave statistikore

Në nivel vendor, si pjesa më e madhe e projekteve të infrastrukturës veçanërisht ato publike, gjurma e gazsjellësit IAP kalon nëpër shumë njësi administrative (bashki). Bashkitë në të cilat shtrihet gjurma e gazsjellësit IAP janë paraqitur në Figura 10.



Figura 10: Vendndodhja e zonës së projektit IAP në nivel bashkie

Burimi: Instat, Instituti i Statistikave: Baza e të dhënave statistikore

Numri i përgjithshëm i banorëve në regjistrimin e fundit të popullsisë në vitin 2011 ishte rreth 2.8 milionë. Shumica e popullsisë jeton në Qarkun e Tiranës. Dendësia më e lartë e popullsisë është në pjesën qendrore bregdetare të Shqipërisë, ndërsa pjesët veriore dhe jugore kanë dendësi të ulët të popullsisë. Nga krahasimi i popullatës sipas dy regjistrimeve të fundit (2001 dhe 2011) vërehet se popullsia në Shqipëri u ul rreth 2, 5% dhe në nivel qarku popullsia u rrit vetëm në Qarkun e Tiranës dhe Durrësit.

Gjurma e IAP kalon në zonën më të populluar të Shqipërisë. Kjo lidhet kryesisht me zonën e qarqeve të Tiranës dhe Durrësit - bashkitë: Kamëz, Kavajë, Rrogozhinë, Tiranë, Vorë dhe Krujë. Pak më pak të populluara janë bashkitë në qarkun Fier (bashkitë Divjakë dhe Fier), të ndjekura nga ato të qarkut Lezhë (bashkitë Kurbin dhe Lezhë) dhe në fund bashkitë e qarkut Shkodër (Shkodër dhe Vau i Dejës).




Figura 11: Dendësia e popullsisë sipas qarqeve, Census 2011

Burimi: INSTANT, Instituti i Statistikave: Baza e të dhënave statistikore

Në Shqipëri pakicat e cënueshme janë romët dhe egjiptianët. Romët përbëjnë afërsisht 0,3% të popullsisë së përgjithshme shqiptare, ndërsa egjiptianët përbëjnë 0,12% në lidhje me përkatësinë etnike.

Romët jetojnë në të gjithë vendin, por disa nga komunitetet më të mëdha mund të gjenden rreth

kryeqytetit, Tiranës, qyteteve të Fierit, Beratit, Gjirokastrës dhe Korçës.

Nga të gjitha zonat e përmendura më lart, popullsia rome e prekur potencialisht nga projekti IAP (brenda korridorit 2 km nga gjurma e gazsjellësit) është e shpërndarë në qarkun Lezhë dhe Fier, ndërsa egjiptianët potencialisht të ndikuar banojnë në qarkun Lezhë.

Tabela 11: Numri i romëve dhe egjiptianëve potencialisht të prekur nga projekti IAP

Qarku	Qendra e banuar	Distanca nga linja IAP	Romët	Egjiptianët	Romët+Egjiptianët
DURRËS	Thumanë	1.5	48		48
FIER	Grabian	1.5	139		139
LEZHË	Lezhë	1.8	113	192	306
TIRANË	Gosë e Madhe	1	20		20
TIRANË	Kashar	1		4	4
BRENDA KORRIDORIT 1 km			20	4	24
BRENDA KORRIDORIT 2 km			320	196	517

Burimi: <http://pop-stat.mashke.org/albania-ethnic2011.htm> [qasur më 2 dhjetor 2019]

Sa lidhet me strukturën e PBB-së sipas aktiviteteve ekonomike, shërbimet vijojnë të përfaqësojnë pjesën kryesore në ekonomi për vitin 2017, me 48.0% të PBB-së, dhe një rritje me 6.06% në terma realë. Industria dhe ndërtimet përbëjnë 20.4% të PBB-së, e cila në terma realë u rrit përkatësisht: industria me -1.80% dhe ndërtimi me 7.04%. Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi që zenë 19.0% të PBBP-së, në terma realë u rritën me 0.84%.

Referuar Institutit Kombëtar të Statistikave, bujqësia është sektori më i rëndësishëm në Shqipëri për sa i përket vlerës së shtuar dhe punësimit. Sektori bujqësor përbën rreth 40% të punësimit dhe 20% të PBB-së. Për krahasim, në vendet e BE, sektori i bujqësisë përfaqëson rreth 2% të PBB-së dhe 6% të punësimit sipas statistikave nga Eurostat.

Grupet e cënueshme në zonën e projektit u referohen njerëzve, veçanërisht atyre nën kufirin e varfërisë, atyre pa tokë, të moshuarve, grave, fëmijëve dhe familjeve pa të drejta ligjore mbi tokën dhe që varen nga toka e kufizuar me prodhimtari të ulët, të cilët për shkak të gjinisë, përkatësisë etnike, moshës, paaftësisë fizike ose mendore, disavantazheve ekonomike ose statusit shoqëror, mund të ndikohen më shumë nga projekti.

Lidhja me projektin e grupeve të cënueshme, sipas karakteristikave të tyre është dhënë në tabelën e mëposhtme.

Tabela 12: Karakteristikat e grupeve të cënueshme dhe lidhja me projektin

Kategoria e cënueshmërisë	Vendodhja dhe përhapja	Karakteristikat	Lidhja me projektin
Gratë	Zona e projektit 50% e popullsisë	Aftësi e ulët për të marrë pjesë në sistemet e qeverisjes dhe vendimmarrjes në nivelin e familjes. Marrëdhëniet e pabarabarta gjinore që rrjedhin nga strukturat patriarkale (margjinalizimi i tyre çon në praktika diskriminuese në ngjarje ekstreme).	PO
		Jo të përfaqësuara mirë në nivelet më të larta të fushave të punësimit të tyre.	JO
		Gratë janë një grup heterogjen dhe nuk mund të supozohet se janë po aq të prekshme, kudo dhe në çdo kohë (burrat mund të jenë më të lëvizshëm dhe të kenë më shumë mundësi për të përdorur kohë më gjatë në një kërkim të vetëm. Burrat dhe gratë kanë të drejta të ndryshme/qasje në burime dhe aftësitë për të zvogëluar ndjeshmërinë e tyre, të ardhura më të ulëta se burrat).	PO

Kategoria e cënueshmërisë	Vendodhja dhe përhapja	Karakteristikat	Lidhja me projektin
		Gjinia është një çështje e cila ndërpret dhe mund të kualifikojë të gjitha dimensionet e prekshme (grupe).	PO
Familjet me të ardhura të ulëta	Zona e projektit 15% e popullsisë	Nivele të ulëta të gjenerimit të të ardhurave.	PO
		Nivele të ulëta të kursimeve dhe mundësi e kufizuar e hyrjes në kredi dhe kredi.	PO
		Shpesh familje me nivele të ulët arsimimi dhe aftësisë.	PO
		Familjet me aktivitete bujqësore.	PO
Familje pa të drejta ligjore për tokë	Zona e projektit (aktualisht nuk dihet - reforma në progres në nivel kombëtar)	Asnjë pronësi mbi shtëpitë ose tokat dhe metodat e tjera për sigurimin e jetesës.	PO
		Shpesh familjet me nivele të ulët arsimimi dhe aftësisë.	PO
		Aftësi shumë e ulët për të marrë pjesë në sistemet e qeverisjes dhe vendimmarrjes në nivel lokal dhe rajonal.	PO
Romët	Qendrat e banuara Grabjan (Fier) dhe Lezhë (Lezhë) 320 banorë brenda korridorit 2 km	Aftësi shumë e ulët për të marrë pjesë në sistemet e qeverisjes dhe vendimmarrjes në nivelin lokal dhe komunal.	PO
		Romët kanë më pak qasje në kujdesin shëndetësor dhe arsimim.	PO
		I nënshtrohet marginalizimit dhe diskriminimit.	PO
Fëmijët dhe Rinia	Zona e projektit 20% e popullsisë	Nivele të ulëta të aftësive dhe arsimimit të njohurive.	PO
		Fëmijët janë më të rrezikuar për shkak të papjekurisë dhe zhvillimit të tyre fizik, intelektual dhe emocional.	PO
		Familjet e reja vuajnë nga mungesa e pronësisë së tokës ose mënyrave të tjera për të siguruar jetesën.	PO
		Fëmijët urbanë në përgjithësi jeojnë më mirë sesa fëmijët ruralë, por nuk është rasti për ata që jetojnë në varfëri ekstreme urbane.	JO
Të moshurit/pensionuarit	Zona e projektit 11% e popullsisë	Gjendja e dobët shëndetësore përfshirë kequshqyerjen, sëmundjet infektive, paaftësinë etj.	PO
		Mundësia e kufizuar dhe/ose mundësia e lëvizjes.	PO
		Niveli i ulët arsimor dhe analfabetizmi relativisht i lartë.	PO
		Niveli i ulët i të ardhurave.	PO
Pronarë të tokave bujqësore, mbajtës të së drejtës dhe punëtorë në bujqësi në zonën e projektit	Zona e projektit	Në varësi të disponueshmërisë së tokës si burim i të ardhurave	PO

Sipas karakteristikave të terrenit dhe kontekstit historik të përdorimit të hapësirës, konstatohet se zonat me mundësi të shtuar të gjetjeve (rastësore) **arkeologjike** janë:

- përgjatë skajeve të fushave të gjera (rreth 500 m) ose përgjatë shpateve të kodrave;
- në vendbanimet ekzistuese në skajet e fushave dhe kodrave që mbivendosen me rrugën e planifikuar të IAP;
- afër pronës kulturore të regjistruar (rreth 500 m).

Brenda zonës së ndikimit direkt ose indirekt janë hasur këto elementë me vlera kulturore:

- Kisha e Shën Kozmait dhe Manastiri I Shën Mërisë, Kolkondas, 700 m në lindje nga progresiva 8+600. Këta monumente kulturore i kushtohet Virgjëreshës Mari dhe Kozmait të Aetolisë. Ky është element i mbrojtur i trashëgimisë kulturore. Edhe pse nuk është në zonën e ndikimit indirekt, duhet të theksohet për afërsinë relative me gazsjellësin e planifikuar.
- Memorial, rreth 100 m larg progresivës 11+800, e cili është një pllakë përkujtimore me origjinë më të re kushtuar "Loni Dhamo".
- Kisha, rreth 300 m në lindje nga progresiva 129+500, një godinë e sapo ndërtuar.
- Kisha e Shën Mhillit, rreth 100 m larg nga progresiva 133+900 dhe rreth 450 m në veri të BVS/PVMRS Lezhë. Ndërtesa është e rikonstruktuar rishtas.
- Kisha dhe ndërtesa e Seminarit Redemptoris Mater në Lezhë është rreth 300 m në perëndim të progresivës 136+000. Ndërtesa është e rikonstruktuar rishtas.

Përveç asaj që u përmend më sipër, nuk ka elemente me vlerë kulturore në zonën e ndikimit të drejtpërdrejtë dhe indirekt.

5 5 Analiza e ndikimeve të mundshme negative në mjedis

5.1 Metodologjia e vlerësimit të ndikimit

Në këtë raport identifikohen dhe përshkruhen karakteristikat për:

- ndikimet e mundshme negative mjedisore dhe sociale
- ndikimet kumulative
- ndikimet negative të identikuara
- ndikimet pozitive të identikuara
- ndikimet mbetëse

Raporti përfshin fazat përkatëse të ciklit të projektit: ndërtimin, funksionimin dhe nxjerrjen jashtë funksionimi.

Raporti jep një përshkrim të detajuar të **ndikimeve të mundshme negative** që rrjedhin nga zbatimi i projektit gjatë fazave të ndërtimit dhe funksionimit të tij. Përveç ndikimeve negative në mjedisin fizik, janë përshkruar: ndikimet në biodiversitet dhe habitate, ndikimi i ndryshimeve klimatike mbi projektin dhe ndikimi i këtij të fundit mbi ndryshimet klimatike, shkarkimet në mjedis dhe prodhimi i mbetjeve, ndikimet negative kumulative, ndikimet sociale dhe në shëndet si dhe, aksidentet e mundshme madhore dhe ngjarjet e paplanifikuara me pasojë në mjedis.

Në kontekstin e IAP, gjatë vlerësimit të ndikimeve të identikuara janë marrë në konsideratë **ndikimet kumulative** që rezultojnë nga disa ose i njëjti burim dhe prekim një receptor të caktuar mjedisor, social ose kulturor. Sipas nevojës, është përcaktuar efekti i tyre i kombinuar në receptor. Përveç kësaj janë marrë në konsideratë ndikimet e kumulative që mund të shfaqen nga kombinimi i efekteve të IAP me aktivitete në zhvillim ose që janë parashikuar për të ardhmen në zonën e projektit. Vlerësimi i ndikimeve kumulative u krye në terma të përgjithshëm me një mënyrë cilësore që bazohet në informacionin ekzistues për aktivitetet e së tashmes ose të së ardhmes dhe gjykimin e ekipit të VNMS.

Ndikimet negative të identikuara janë shpjeguar më tej në lidhje me zonën e ndikimit dhe kohëzgjatjen, llojin e ndikimit (direkt/indirekt), mundësinë e zbutjes dhe zonat e ndjeshme ndaj ndikimeve. Kjo analizë tregohet në Kapitullin 5.2.

Të gjitha ndikimet në komponentët mjedisorë e socialë, të përshkruar në Kapitullin 5.1 dhe

Kapitulli 5.2 u vlerësoan dhe u paraqiten në matricën në Kapitulli 5.2.3.

Matrica e rëndësisë së ndikimit (në një shkallë nga 4 në 16) është përgatitur duke shtuar vlerësimet individuale për tiparet e ndikimeve si më poshtë:

- **Madhësia (shkalla)** – një shkallë e ashpërsisë/përfitimit të ndikimit që përdoret për të vlerësuar në çfarë mase ndikimi ka efekt në ekosistem (për ndikimet ekologjike) ose palët e përfshira (për ndikimet socio-ekonomike).
- **Shtrirja në hapsirë (zona e ndikimit) dhe kohë (kohëzgjatja) e ndikimit** – shtrirja në hapsirë përcakton zonën e ndikimit; shtrirja në kohë përcakton kohëzgjatjen e ndikimit.
- **Ndjeshmëria mjedisore (ndjeshmëria e zones/receptorit ndaj ndikimit)** – shkalla e ndjeshmërisë bën të mundur vlerësimin nëse mjedisi fizik dhe social pritës kanë karakteristika (mungesa, përdorim intensiv të burimeve, cënueshmëri etj.) që e rrisin rëndësinë e ndikimit me një intensitet të caktuar. Kjo ndjeshmëri përfshin edhe konceptin e ndikimit të kthyeshëm.
- **Mundësia që të ndodhë** – bën të mundur të përcaktohet nëse një ndikim konsiderohet i sigurt (për shembull humbja e vegjetacionit gjatë operacioneve në tokë), i mundshëm ose përjashtim (për shembull në aksidente të caktuar). Ndonëse disa ndikime mund të kenë efekte të rëndësishme, mundësia shumë e vogël që të shfaqet (ndodhë) mund ta zvogëlojë rëndësinë e përgjithshme të ndikimit. Në mënyrë të ngjashme, një ndikim që ka shumë të ngjarë të shfaqet duhet të vlerësohet më i rëndësishëm se një që ka pak gjasa të ndodhë.

Për vlerësimin e shtrirjes në kohë të ndikimit, janë përdorur kategoritë si më poshtë:

- Gjatë punimeve të ndërtimit
- Afatshkurtër – më pak se 5 vjet
- Afatmesëm – ndërmjet 5 dhe 20 vjet
- Afatgjatë – ndërmjet 20 dhe 50 vjet (deri në nxjerrje jashtë funksionimi)
- I përhershëm – edhe pas nxjerrjes jashtë funksionimit

Për vlerësimin e shtrirjes hapsinore të ndikimit, janë përdorur kategoritë si më poshtë:

- Shumë i lokalizuar – korridori i punimeve të ndërtimit
- Zona e studimit – korridori prej 200 m në secilën anë
- Rajonal/Kombëtar
- Ndërkombëtar

Vlerësimi me pikë është bërë sipas tabelës së mëposhtme.

Madhësia/Shkalla		Vlerësimi		
I ulët	Ndikim i ulët	1		
Mesatar	Ndikim mesatar	2		
I lartë	Ndikim i rëndësishëm negativ ose pozitiv (përfitues)	3		
Shumë i lartë	Ndikim shumë i rëndësishëm negativ ose veçanërisht përfitues	4		
Shtrirja në kohë dhe hapsirë				
	<i>Afatshkurtër – më pak se 5 vjet</i>	<i>Afatmesëm – ndërmjet 5 dhe 20 vjet</i>	<i>Afatgjatë – ndërmjet 20 dhe 50 vjet (një gjeneratë)</i>	<i>I përhershëm</i>
<i>Shumë i lokalizuar</i>	1	2	2	3
<i>Zona e studimit</i>	1	2	3	4
<i>Rajonal/ Kombëtar</i>	2	2	3	4
<i>Ndërkombëtar</i>	2	3	4	4
Ndjeshmëria e mjedisit		Vlerësimi		
E ulët	Mjedisi / aktiviteti / popullsia e vlerësuar është e zakonshme, nuk ka veçanti ose probleme të rëndësishme	1		

Mesatare	Mjedisi / aktiviteti / nëngrupi i popullsisë i vlerësuar është pothuajse i zakonshëm me ndonjë tipar ose problem të veçantë	2
E lartë	Mjedisi / aktiviteti / popullsia e vlerësuar është e rallë dhe ka tipare dhe probleme të rëndësishme	3
Shumë e lartë	Mjedisi / aktiviteti / popullsia e vlerësuar është shumë e rallë dhe ka karakteristika ose probleme unike	4
Mundësia që të ndodhë		Vlerësimi
Shumë e ulët	Mundësia që ndikimi të ndodhë konsiderohet shumë e ulët	1
E ulët	Ndikimi konsiderohet i mundshëm	2
E lartë	Ndikimi ka shumë mundësi të ndodhë	3
E sigurtë	Ndikimi do të ndodhë me siguri	4

Shumatorja e vlerësimeve tregon efektin e përgjithshëm, sipas tabelës së mëposhtme:

		Efekti {shumatorja e shkallës, shtrirjes në hapësirë dhe kohë të ndikimit, ndjeshmërisë mjedisore dhe mundësisë që të ndodhë}									
		3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
Mundësia që të ndodhë	1	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13
	2	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14
	3	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15
	4	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16

Paraqet shumatorën e shkallës, shtrirjes në hapësirë dhe në kohë, ndjeshmërisë mjedisore në raport me mundësinë e shfaqjes së ndikimit. Numri i dhënë tregon rëndësinë e ndikimit sipas përshkrimeve në tabelën e mëposhtme.

Rëndësia	Përshkrimi	Vlerësimi
E ulët	Një ndikim i pranueshëm i cili mund të kërkojë masa jo thelbësore për shmangien ose zbutjen. Ky ndikim është i pamjaftueshëm në vetvete ose edhe i kombinuar me ndikime të tjerë më të njëjtën rëndësi për të vënë në dyshim projektin.	4-7
Mesatare	Një ndikim i rëndësishëm i cili kërkon masa për shmangien dhe/ose zbutjen. I vetëm ky ndikim është i pamjaftueshëm për të vënë në dyshim projektin por, i kombinuar me ndikime të tjerë me natyrë të njëjtë, mund të pengojë realizimin e tij.	8-10
E lartë	Një ndikim serioz i cili, nëse nuk merren masa (kur ndikimi është negativ) mund të verë në dyshim zbatimin e projektit. Ky ndikim konsiderohet nga kompania një ndryshim i madh afatgjatë i mjedisit (natyror ose socio-ekonomik) me pasojë të rëndësishme.	11-13
Shumë e lartë	Një ndikim shumë serioz i cili, nëse nuk merren masa (kur ndikimi është negativ) edhe i vetëm mund të verë në dyshim zbatimin e projektit. Ky ndikim, padyshim i përhershëm dhe i pakthyeshëm rezulton si nxitës i pasojave të mëdha për mjedisin, popullsinë dhe aktivitetin ekonomik.	14-16

Gjatë vlerësimit të ndikimit, në trajtë përshkrimi, janë marrë në konsideratë edhe karakteristikat e tjera të ndikimit:

- lloji - pozitiv, negativ
- mundësia e kthimit – nëse është ndikim **direkt** (kur ekziston një marrëdhënie direkte shkak-pasojë ndërmjet një komponenti të projektit dhe një elementi të mjedisit – ekosistemi ose komponentët socio-ekonomikë), **indirekt** (i cili rezulton nga një ndikim direkt ose komponent i projektit dhe vijon me një varg pasojash), ose mbetës (ndikim i cili mbetet edhe pas zbatimit të masave të shmangies dhe/ose zbutjes).

- **Ndikimet mbetëse** janë analizuar me të njëjtën matricë krahasuar me ndikimet e identifikuar në Kapitullin 8.

Një vlerësim cilësor i ndikimeve të pritshme është kryer edhe për fazën e nxjerrjes jashtë funksionimi.

Me qëllim që të shmangen ose zvogëlohen ndikimet e mundshme negative, janë parashikuar masa zbutëse (kapitulli 8.1) dhe janë vlerësuar ndikimet mbetëse (kapitulli 8.2.).

Vlerësimi i ndikimit është konceptuar që të garantojë se vendimet në lidhje me projektin janë marrë duke njohur plotësisht ndikimet që mund të shfaqen në mjedisin natyror dhe social.

Në disa raste, masat zbutëse do të jenë të përfshira në projektin teknik dhe në disa të tjera janë identifikuar gjatë procesit të VNMS. Për këtë arsye, procesi i VNMS ka identifikuar ku mund të shfaqen ndikimet e rëndësishme dhe më tej ka përcaktuar masa zbutëse për zvogëlimin e këtyre ndikimeve në nivele që gjykohen të pranueshëm. Këto masa janë integruar në PPM dhe PVMS si zotime të qarta.

Atje ku është identifikuar një ndikim i rëndësishëm negativ, është hulumtuar një hierarki tipike e opsioneve zbutëse, si më poshtë:

- shmang – hiq burimin e ndikimit,
- zvogëlo – zvogëlo burimin e ndikimit, zvogëlo ndikimin ndërmjet burimit dhe receptorit, zvogëlo ndikimin në receptor,
- ndreq – riparo dëmtimin,
- kompenso – zëvendëso në natyrë ose me një burim të ndryshëm me vlerë të njëjtë.

Kompensimi shihet tipikisht si mundësia e fundit por mund të kërkohet në kushtet e legjislacionit lokal (nganjëherë pavarësisht rëndësisë së ndikimit). Gjithsesi, kompensimi ose zhdukja nuk e bëjnë një ndikim automatikisht “të pranueshëm” ose shfajësojnë nevojën për të shqyrtuar forma të tjera të zbutjes siç janë treguar në hierarki. Standartet e performacës së BERZH theksojnë nevojën për të kërkuar alternativa për shmangien ose zvogëlimin e ndikimeve.

5.2 Zonat ose receptorët e ndjeshëm ndaj ndikimeve të projektit

Subjekti	Burimet e ndikimeve	Ndikimet	Zona e ndikimit (Shtrirja hapsinore - SHH)	Zonat ose receptorët e ndjeshëm ndaj ndikimeve të projektit
Mjedisi fizik				
> Faza ndërtimore				
Ujërat	Menaxhimi i papërshtatshëm i ujërave të ndotura dhe lëngjeve të rrezikshme	Ndotja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore	Rrjedha ujore dhe ujëra nëntokësore në varësi të vendit ku ndodh (shumë i lokalizuar)	Rrjedhat ujore dhe akuiferët pa shtresën sipërfaqësore mbrojtëse (me përshkueshmëri të ulët)
	Metoda e kalimeve me prerje të hapur	Grumbujt e sedimenteve	Gjurma e IAP ndërpret 352 kanale më të vegjël kullimi ku do të përdoret metoda me prerje të hapur. Kalimet me prerje të hapur të lumenjve/kanaleve të mëdhenj/përrenjve do të zbatohen në progresivat që vijojnë: 10+405, 17+790, 35+ 600, 46+536, 53+270, 56+ 042, 58+527, 60+051, 60+ 262, 60+395, 60+728, 61+ 099, 61+282, 61+454, 61+ 697, 65+230, 66+078, 67+ 993, 68+235, 69+535, 71+ 100, 73+700, 74+195, 74+ 535, 74+782, 77+902, 85+ 644, 89+208, 108+701, 133+ 162, 134+870, 135+920, 137+ 303, 138+232, 138+338, 138+ 609, 138+936, 153+583, 160+ 859, 161+424, 163+660 dhe 167+702 me gjithsej 43 kalime me prerje të hapur (zona e studimit).	Janë të ndjeshme ndaj këtij ndikimi 4 rrjedha gjithëvjetoare (në progresivat 17+790, 73+700, 74+195, 89+208, 133+152 dhe 134+870) të cilat do të kalohen me këtë metodë. Përroi i Grykës ka tre kalime.
	Metoda për kalimin e lumenjve pa kanal	Shpëlarja/ Derdhja e lëngjeve të shpimit	Rrjedha ujore dhe akuiferë në varësi të vendit ku ndodh (shumë i lokalizuar)	Rrjedha ujore dhe akuiferë në varësi të vendit ku ndodh
	Hidrotestimi (nxjerrja dhe shkarkimi i ujit)	Zvogëlimi i mundshëm i prurjes dhe nivelit të ujit, krijimi i grumbujve të vegjël me sedimente që mund të ndodhë gjatë shkarkimit	Rrjedhat ujore më të mëdha si Semani, Shkumbini, Erzeni, Tirana, Droja, Mati, Drini dhe Buna do të jenë burim uji për testimin e presionit dhe receptorët për ujin e përdorur për hydrotest (zona e studimit).	Lumenjtë Seman, Shkumbin, Erzen, Tirana, Mat, Drin, Bunë dhe Drojë.

Subjekti	Burimet e ndikimeve	Ndikimet	Zona e ndikimit (Shtrirja hapësirë - SHH)	Zonat ose receptorët e ndjeshëm ndaj ndikimeve të projektit
	Hapja e kanalit (tharja e mundshme e ujërave) dhe shtrimi i tubave	Tërheqje (pakësim) e lokalizuar e ujërave nëntokësore (ndikim i ulët) dhe dëmtim pusi	Në zonat me nivel të lartë të ujërave nëntokësore dhe puse/kaptazhe që gjenden në menjëherë pranë gjurmës së IAP (në afërsi të progresivave 52+480 dhe 117+440) (shumë i lokalizuar)	Pus/kaptazh burimi
Gjeorrezizet	Përmbytjet	Dëmtim i makinerive të ndërtimit dhe ndotje e ujërave	Gjurma e IAP kalon nëpër dy zona të mëdha të prirura ndaj përmbytjeve, në pjesën perendimore të Shqipërisë. Referuar hartës së të Planit të Përgjithshëm Kombëtar, objektet sipërfaqësore si në vijim gjenden në zona të cilat mund të përmbysten: CTMS Fier, BVS Rrogozhinë, PTS/BVS/PRMS Mamurras, BVS Milot, BVS Balldren dhe CTMS Bushat. (zona e studimit).	Ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore
	Qëndrueshmëria e shpateve	Siguria, dëmtimi i makinerive të ndërtimit	Progresiva 52+000 deri në progresivën 66+000 dhe nga progresiva 69+000 deri në progresivën 81+500	Shpate potencialisht të paqëndrueshëm
Gjeomorfologjia	Gërmimi për kanalit e tubacionit	Ndryshime të vogla në format gjeomorfologjike	Shumë i lokalizuar – seksionet e kanalit dhe brezit të punimeve në zona kodrinore dhe shpate të pjerrët	Zonat kodrinore, veçanërisht shpatet shumë të pjerrët me humbje të shtresës sipërfaqësore
		Erozion i mundshëm i tokës	Shumë i lokalizuar – seksionet e kanalit dhe brezit të punimeve në zona kodrinore dhe shpate të pjerrët	Zonat kodrinore, veçanërisht shpatet shumë të pjerrët me humbje të shtresës sipërfaqësore ndërmjet progresivave 69+000-73+400
	Ndërtimi dhe përmirësimi i rrugëve të aksesit	Ndryshime në karakteristikat gjeomorfologjike lokale.	I lokalizuar – në zonat e rrugëve të aksesit dhe cungishteve e argjinaturave rrethuese (shumë i lokalizuar).	Zonat kodrinore ndërmjet progresivave: 58+500 - 60+500, 61+700 - 64+100, 69+000 - 70+800, 72+800 - 73+400, 130+400 – 130 +800, 131+100-132+800, 136 + 600 - 140+100, 141+800-142+60
		Erozion i mundshëm i tokës	I lokalizuar – në zonat e rrugëve të aksesit dhe cungishteve e argjinaturave rrethuese (shumë i lokalizuar).	Zonat kodrinore, veçanërisht shpatet shumë të pjerrët me humbje të shtresës sipërfaqësore

Subjekti	Burimet e ndikimeve	Ndikimet	Zona e ndikimit (Shtrirja hapësirë - SHH)	Zonat ose receptorët e ndjeshëm ndaj ndikimeve të projektit
				ndërmjet progresivave: 69+000-70+800 72+800-73+400
Toka	Gërmimi i tokës dhe heqje e shtresës sipërfaqësore të saj (shtresa vegjetale)	Zvogëlim i prodhimtarisë së tokës dhe përqendrim i karakteristikave dhe tipareve të saj	Brezi i punimeve prej 20 m përgjatë gjurmës së IAP (sipërfaqe rreth 340 ha), sipërfaqja e ndërtimit të instalimeve sipërfaqësore (4.8 ha), dhe sipërfaqja e instalimit të kampeve të punës (afërsisht 3.97 ha) (shumë i lokalizuar)	Toka brenda brezit të punimeve prej 20 m përgjatë gjurmës së IAP, shesheve të ndërtimit të instalimeve sipërfaqësore dhe zonat e kampeve të punës
		Erozion i mundshëm i tokës	Në një zonë të ndjeshme ndaj erozionit në terrene të pjerrët brenda brezit të punimeve prej 20 m përgjatë gjurmës së IAP (shumë i lokalizuar).	Toka në terrenet e pjerrët brenda brezit të punimeve prej 20 m përgjatë gjurmës së IAP
	Trajtimi jo i duhur i ujërave të ndotura dhe mbetjeve të lëngëta të rrezikshme	Ndotje e tokës	Toka në varësi të vendit ku ndodh (shumë i lokalizuar)	Toka në zonat e aksidenteve
Toka bujqësore	Heqja e shtresës sipërfaqësore (vegjetale) të tokës dhe mbulesës vegetative (me kultura bujqësore)	Humbje e përkohshme e tokës bujqësore	Brezi i punimeve prej 20 m përgjatë gjurmës së IAP (afërsisht 278.4 ha tokë bujqësore) dhe sipërfaqja e ndërtimit të instalimeve sipërfaqësore që zihet nga toka bujqësore (afërsisht 4.8 ha). Sipërfaqja e instalimit të kampeve të punës (afërsisht 3.97 ha) dhe rrugëve të aksesit (afërsisht 14.1522 ha). (shumë i lokalizuar)	Shtresa vegjetale (humusi) me vegetacion (kultura bujqësore) në brezin e punimeve (20 m), zonave të instalimeve sipërfaqësore, zonave të kampeve të punës dhe rrugëve të aksesit.
Pejsazhi	Krijimi i brezit të punimeve për tubacionin	Heqje e vegetacionit të lartë	Shumë pranë elementëve të planifikuar të IAP, në varësi të kushteve të terrenit (zona e studimit)	Zonat e pejsazhit kodrinor me mbulesë sipërfaqësore natyrore ndërmjet progresivave 52+000–81+000 dhe 130+500–140+200
	Ndërtimi dhe përmirësimi i rrugëve të aksesit	Heqje e vegetacionit të lartë	I lokalizuar – brenda zonës së punimeve të rrugëve të aksesit (shumë i lokalizuar).	Zonat e pejsazhit kodrinor me mbulesë sipërfaqësore natyrore ndërmjet progresivave 52+000–81+000 dhe 130+500–140+200
	Ndërtimi i instalimeve sipërfaqësore, kampeve të punës dhe kantjereve të tubave	Heqje e vegetacionit të lartë	Brenda perimetrit të instalimeve sipërfaqësore, kampeve të punës dhe kantjereve të tubave (shumë i lokalizuar).	Vendodhjet e instalimeve sipërfaqësore, kampeve të punës dhe kantjereve të tubave. Zonat e pejsazhit kodrinor me mbulesë sipërfaqësore natyrore.

Subjekti	Burimet e ndikimeve	Ndikimet	Zona e ndikimit (Shtrirja hapësirë - SHH)	Zonat ose receptorët e ndjeshëm ndaj ndikimeve të projektit
	Prania dhe operimi i makinerive të ndërtimit dhe depozitimi i materialeve të ndërtimit	Ndikim pamor	Shumë pranë elementëve të planifikuar të IAP, në varësi të kushteve të terrenit (zona e studimit)	Zonat e pejsazhit kodrinor me mbulesë sipërfaqësore natyrore.
> Faza e funksionimit				
Toka	Zhvendosja e shtresës sipërfaqësore të tokës gjatë punimeve të ndërtimit dhe rehabilitimi pas përfundimit të punimeve.	Zvogëlim lokal i prodhimit të tokës	Brezi i punimeve (20 m) (shumë i lokalizuar)	Shtresa sipërfaqësore e tokës Brenda brezit të punimeve (20m) që mund të jetë përdorur për prodhim bujqësor
Toka bujqësore	Instalimet sipërfaqësore	Humbje e tokës bujqësore	Humbje e tokës bujqësore në sipërfaqen e instalimeve sipërfaqësore (4.8 ha tokë bujqësore) (shumë i lokalizuar)	Toka bujqësore brenda zonave të instalimeve sipërfaqësore
	Zbatimi i kufizimeve në zonën e mbrojtjes së tubacionit (5+5 m)	Kufizime të prodhimit për kulturat bujqësore me rrënjë që rriten më thellë se 1 m ose të cilat kërkojnë trajtim të tokës bujqësore më thellë se 0.5 m	Zona e kufizimeve 5 + 5 m nga boshti i tubacionit (zona e mbrojtjes së tubacionit) – afërsisht 139.3 ha tokë bujqësore (shumë i lokalizuar)	Kulturat bujqësore me rrënjë që rriten më thellë se 1 m ose të cilat kërkojnë trajtim të tokës bujqësore më thellë se 0.5 m në zonën e mbrojtjes së tubacionit (5+5 m) përgjatë gjurmës së IAP dhe në zonat e fidanishteve (afërsisht 3 ha).
		Kufizime të prodhimit bujqësor në zonat e ullishteve dhe pemëve frutore të ngjashme.	Zona e kufizimeve 5 + 5 m nga boshti i tubacionit (zona e mbrojtjes së tubacionit) – afërsisht 2.1 ha tokë bujqësore (shumë i lokalizuar)	Drurët e ullirit dhe pemë frutore të ngjashme që gjenden në zonën e mbrojtjes së tubacionit (5+5), përafërsisht 2,1 ha.
Pejsazhi	Instalimet sipërfaqësore	Ndikime pamore dhe ndryshim i karakterit të pejsazhit	Shumë i lokalizuar	Zonat e pejsazhit kodrinor. Zonat menjëherë pranë instalimeve sipërfaqësore (në distancë 1-2 km).
		Ndotja nga ndriçimi	Një distancë ndërmjet 0-10.000 m (zona e studimit)	Zona më të gjera të populluara përreth (në distancë 1-10 km) për shkak të ndotjes nga ndriçimi.

Subjekti	Burimet e ndikimeve	Ndikimet	Zona e ndikimit (Shtrirja hapësirë - SHH)	Zonat ose receptorët e ndjeshëm ndaj ndikimeve të projektit
	Zona prioritare e sigurisë së tubacionit (5 + 5 m)	Ndryshim i karakterit të pejsazhit dhe pengesë ndaj vazhdimësisë natyrore të terreneve jo-bujësore	Ndikimet pamore: zona e shikueshmërisë së elementëve të IAP në një distancë prej 500 m për terren fushor dhe 2,000 m në reliev kodrinor (zona e studimit)	Zonat e pejsazhit kodrinor.
Biodiversiteti dhe habitatet				
› Faza ndërtimore				
Biodiversiteti	Lëvizja e makinerive të ndërtimit, punimet e gërmimit, prania e shtuar njerëzore	Dëmtimi ose heqja e mbulesës vegetative dhe tokës (shumë e lokalizuar)	Ndikimet në llojet e habitateve do të jenë lokale brenda brezit të punimeve (rajonale për shkak të gjatësisë së tubacionit)	Habitatet Flora Fauna – individët e rinj (me mundësi të kufizuara lëvizjeje)
		Shqetësim i faunës nga zhurma e punimeve të ndërtimit që prodhojnë zhurmë dhe dridhje	Ndikimet e zhurmës në faunë do të shfaqen në një zonë disi më të gjerë se brezi i punimeve (shumë i lokalizuar)	Fauna
	Erozion i tokës (në shpatet e pjerrët) (shumë i lokalizuar)	Erozion i tokës në shpatet e pjerrët	Shumë i lokalizuar	Habitatet Flora
	Ndërtimi i instancave sipërfaqësore dhe rrugëve të përhershme të aksesit	Dëmtimi ose heqja e mbulesës vegetative	Shumë i lokalizuar	Habitatet Flora Fauna
		Shqetësim i faunës nga zhurma e punimeve të ndërtimit që prodhojnë zhurmë dhe dridhje	Zona e studimit	Fauna
	Rikonstruksioni i disa rrugëve ekzistuese	Dëmtimi ose heqja e mbulesës vegetative	Shumë i lokalizuar	Habitatet Flora Fauna
		Shqetësim i faunës nga zhurma e punimeve të	Zona e studimit	Fauna

Subjekti	Burimet e ndikimeve	Ndikimet	Zona e ndikimit (Shtrirja hapësirë - SHH)	Zonat ose receptorët e ndjeshëm ndaj ndikimeve të projektit
		ndërtimit që prodhojnë zhurmë dhe dridhje		
	Ndërtimi i kampeve për personel (punëtorë) dhe kantjereve të tubave	Dëmtimi ose heqja e mbulesës vegjetative	Shumë i lokalizuar	Habitatet Flora Fauna
		Shqetësim i faunës nga zhurma e punimeve të ndërtimit që prodhojnë zhurmë dhe dridhje	Zona e studimit	Fauna
	Kalimet e lumenjve me prerje të hapur	Dëmtim i habitateve bentike dhe të brigjeve (shumë i lokalizuar)	Gjurma e IAP ndërpret 352 kanale më të vegjël kullues ku do të zbatohet metoda me prerje të hapur Kalimet me prerje të hapur të lumenjve/kanaleve të mëdhenj/përrenjve do të zbatohen në progresivat që vijojnë: 10+405, 17+790, 35+ 600, 46+536, 53+270, 56+ 042, 58+527, 60+051, 60+ 262, 60+395, 60+728, 61+ 099, 61+282, 61+454, 61+ 697, 65+230, 66+078, 67+ 993, 68+235, 69+535, 71+ 100, 73+700, 74+195, 74+ 535, 74+782, 77+902, 85+ 644, 89+208, 108+701, 133+ 162, 134+870, 135+920, 137+ 303, 138+232, 138+338, 138+ 609, 138+936, 153+583, 160+ 859, 161+424, 163+660 dhe 167+702 me gjithsej 43 kalime me prerje të hapur (zona e studimit).	Habitatet Flora Fauna
		Ndryshime të cilësive fiziko-kimike të ujërave për shkak të përhapjes së sedimenteve	Zona e studimit	Fauna
	Hidrotestimi	Futja e llojeve ujore invazive	Zona e studimit	Flora Fauna
	Hidrotestimi	Shqetësim i faunës nga zhurma e punimeve të ndërtimit që prodhojnë zhurmë dhe dridhje	Zona e studimit	Fauna

Subjekti	Burimet e ndikimeve	Ndikimet	Zona e ndikimit (Shtrirja hapsinore - SHH)	Zonat ose receptorët e ndjeshëm ndaj ndikimeve të projektit
Pyjet	Krijimi i brezit të punimeve	Prerja dhe pastrimi i parcelave të vogla pyjore brenda brezit të punimeve (18 m) në të gjithë gjatësinë e gjurmës së tubacionit me qëllim aksesin e automjeteve dhe makinerive, rrit mundësinë e zjarreve në pyje	Brenda brezit të punimeve në zonën e shpyllëzuar përgjatë gjurmës (korridor 18 metra) (shumë i lokalizuar)	Pyjet gjethegjere dhe halorë me përqendrim të lartë të individëve me kurorë të dendur.
	Ndërtimi i rrugëve të aksesit	Shpyllëzimi i pjesshëm në gjerësinë (6 m) dhe gjatësinë e rrugëve të aksesit që do të ndërtohen në zonë të pyllëzuar, rrit mundësinë e zjarreve në pyje	Brenda zonës së mbrojtjes (30 m nga të dy anët e bushtit të tubacionit) (shumë i lokalizuar)	Pyjet gjethegjere dhe halorë me përqendrim të lartë të individëve me kurorë të dendur.
	Ndërtimi i kantjereve të tubave	Shpyllëzimi i pjesshëm, mundësi e shtuar e zjarreve në pyje	Shumë pranë zonës së gjerë të sigurisë (njëra në distancë prej afërsisht 220 m dhe tjetra prej 445 m nga boshti i tubacionit) (zona e studimit)	-
Zonat e mbrojtura	Lëvizja e makinerive të ndërtimit, punimet e gërmimit	Dëmtimi ose heqja e mbulesës vegetative	Shumë i lokalizuar	Zonat ose habitatet e ndjeshëm, veçanërisht zonat lagunore
	Kalimet me prerje të hapur	Dëmtimi i rrjedhave të vogla dhe kanaleve sjell ndryshim në cilësitë fiziko-kimike të ujërave përkatës	Shumë i lokalizuar	Habitatet e ndjeshëm, lloje të faunës ujore
	Ndërtimi i instalimeve sipërfaqësore dhe rrugëve të përhershme të aksesit në zonën Shëngjin-Ishëm, kandidatë për pjesë të rrjetit Emerald	Ndryshim i habitatit	Shumë i lokalizuar	Habitatet dhe fauna

Subjekti	Burimet e ndikimeve	Ndikimet	Zona e ndikimit (Shtrirja hapsinore - SHH)	Zonat ose receptorët e ndjeshëm ndaj ndikimeve të projektit
	Ndërtimi i kantjereve të tubave dhe kampeve në zonën Shëngjin-Ishëm, kandidatë për pjesë të rrjetit Emerald	Ndryshim i habitatit në zonën Shëngjin-Ishëm, kandidatë për pjesë të rrjetit Emerald	Shumë i lokalizuar	Habitatet dhe fauna
	Lëvizja e makinerive të ndërtimit, punimet e gërmimit	Shqetësim i faunës (ku nuk përfshihen shpendët) nga zhurma, dridhjet, rritja e pranisë njerëzore	Shumë i lokalizuar	Fauna (pa shpendët)
	Lëvizja e makinerive të ndërtimit, punimet e gërmimit	Shqetësim i faunës nga zhurma, dridhjet, rritja e pranisë njerëzore	Ndikim tek shpendët Brenda progresivës 160+300-fundi i tubacionit, i kufizuar në një korridor prej 100 m në të dy anët e gjurmës së IAP (zona e studimit)	Shpendët
	Hidrotestimi	Futja e llojeve ujore invazive	Zona e studimit	Flora Fauna
	Hidrotestimi	Zhurme dhe dridhje	I lokalizuar në kalimet me prerje të hapur (zona e studimit)	Fauna
> Faza e funksionimit				
Biodiversiteti	Instalimet e përhershme sipërfaqësore dhe rrugët e përhershme të aksesit	Shndërrimi përgjithnjë i sipërfaqes (shumë i lokalizuar)	Shumë i lokalizuar	Habitatet Fauna
	Mirëmbajtja e korridorit të sigurisë në zonat pyjore	Parandalimi i krijimit të mbulesës së vegjetacionit pyjor (shumë e lokalizuar)	Shumë i lokalizuar	Habitatet Fauna

Subjekti	Burimet e ndikimeve	Ndikimet	Zona e ndikimit (Shtrirja hapësirë - SHH)	Zonat ose receptorët e ndjeshëm ndaj ndikimeve të projektit
Pyjet	Mirëmbajtja e rregullt, ndërhyrjet	Heqja përgjithnjë e vegjetacionit drusor brenda zonës prioritare të sigurisë dhe të së drejtës për kalim për qëllime të mirëmbajtjes dhe riparimit (5m+5m) përgjatë gjurmës së gazsjellësit, rrit mundësinë e zjarreve në pyje.	Zona prioritare e sigurisë (shumë i lokalizuar)	Nuk ka zona të ndjeshme pyjore Brenda zonës prioritare të sigurisë (5 + 5 m) përgjatë gjurmës së IAP.
Zonat e mbrojtura	Instalimet e përhershme sipërfaqësore dhe rrugët e përhershme të aksesit	Shndërrimi i sipërfaqes në instalimet sipërfaqësore dhe rrugët e përhershme të aksesit	Duke qenë se tubacioni do të groposet, nuk do të ketë ndryshime të rëndësishme në karakteristikat e zonës së mbrojtur. Vetëm dy instalimet sipërfaqësore në zonën Shëngjin-Ishëm, kandidatë për pjesë të rrjetit Emerald, do të paraqiten si elementë të rinj, por për shkak të përmasave të vogla dhe pozicionit, ndikimi në terma të pejsazhit do të jetë i kufizuar në hapësirë dhe me intensitet të ulët (shumë i lokalizuar)	Karakteristikat e pejsazhit në afërsi të dy instalimeve sipërfaqësore në zonën Shëngjin-Ishëm, kandidatë për pjesë të rrjetit Emerald.
Shkarkimet në mjedis				
> Faza ndërtimore				
Cilësia e ajrit	Trajtimi i materialeve	Çlirimet e pluhurit	Ndikime të kufizuara në afërsi të qendrave të banuara më të afërta nga punimet e ndërtimit. (shumë i lokalizuar)	Qendrat e banuara më të afërta (përgjatë gjurmës së tubacionit dhe rrugëve të përkohshme të aksesit shtruar me çakëll)
	Përdorimi i sipërfaqeve të punës	Çlirimet e pluhurit		
	Rrugët e përkohshme të aksesit shtruar me çakëll për në zonën e ndërtimit	Çlirimet e pluhurit		
	Automjetet dhe makineritë	Produktet e djegies së karburantit fosil		
Zhurma	Punimet e ndërtimit: automjetet dhe makineritë e rënda të ndërtimit, kompresorët dhe pompat	Çlirimet e zhurmës në mjedis nga punimet e ndërtimit	Zona e studimit	Popullsia në qendrat e banuara më të afërta (përgjatë gjurmës së tubacionit)

Subjekti	Burimet e ndikimeve	Ndikimet	Zona e ndikimit (Shtrirja hapësirë - SHH)	Zonat ose receptorët e ndjeshëm ndaj ndikimeve të projektit
Menaxhimi i mbetjeve	Kampet, zonat e punimeve përgjatë tubacionit	Ndotja e tokës dhe ujërave nga mbetjet	Toka në zonat pranë kampeve dhe shesheve të punimeve (shumë i lokalizuar).	Rrjedhat ujore dhe akuiferët pa shtresën sipërfaqësore mbrojtëse (me përshkueshmëri të ulët), toka e përdorur për bujqësi
> Faza e funksionimit				
Cilësia e ajrit	BVS/PRMS Fushë - Kruja, PTS/BVS/PRMS Mamurras, PTS/BVS/PRMS Kavajë, BVS/PRMS Tiranë and PRMS Lezhë	Shkarkime të CO dhe NOx	Ndikim i parëndësishëm nga operacionet e projektit në cilësinë e ajrit në zonat pranë instalimeve. (shumë i lokalizuar)	Zonat më pranë instalimeve.
Zhurma	BVS/PRMS Fushë - Kruja, PTS/BVS/PRMS Mamurras, PTS/BVS/PRMS Kavajë, BVS/PRMS Tiranë and PRMS Lezhë	Çlirimet e zhurmës në mjedis nga funksionimi i tubacionit	Shumë i lokalizuar	Popullsia në qendrat e banuara më të afërta (me PRMS-të): Kryeluz, Tiranë, Ura Gjolës, Fushë-Mamurras, Manati.
Menaxhimi i mbetjeve	Sasi të vogla mbetjesh pritet të krijohen në Stacionet e Matjes dhe Reduktimit të Presionit si pasojë e operacioneve të mirëmbajtjes dhe prania e punonjësve: BVS/ PRMS Fushë Krujë, PTS/BVS/PRMS Mamurras, PTS/BVS/PRMS Kavajë, BVS/PRMS Tiranë dhe PRMS Lezhë.	Ndotja e tokës dhe ujërave nga mbetjet	Toka në zonat shumë pranë instalimeve sipërfaqësore (shumë i lokalizuar).	Rrjedhat ujore dhe akuiferët pa shtresën sipërfaqësore mbrojtëse (me përshkueshmëri të ulët), toka e përdorur për bujqësi.
Ndikimet sociale dhe në shëndet				
> Faza para-ndërtimore				

Subjekti	Burimet e ndikimeve	Ndikimet	Zona e ndikimit (Shtrirja hapësirë - SHH)	Zonat ose receptorët e ndjeshëm ndaj ndikimeve të projektit
Shqetësime të komunitetit	Ndërtimi i tubacionit të planifikuar – perceptimi negativ i IAP dhe ndikimeve të tij	Veprimet e lidhura me gazsjellësin mund të perceptohen si shqetësim, një ndërhyrje në rrjedhën normale të jetës dhe si diçka që mund të sjellë vetëm probleme/rreziqe tek komuniteti lokal përveç shqetësimeve të ndryshme në lidhje me çështjet e mjedisit, sociale dhe të shëndetit	Zona e studimit	Popullsia në qendrat e banuara përreth tubacionit, pronarët/mbajtësit e të drejtave të tokës dhe pronave që ndërpritet nga tubacioni ose përgjatë tij.
Trashëgimia kulturore	Ndërtimi i tubacionit të planifikuar	Ndikim në vendet e identifikuar të trashëgimisë kulturore	Shumë i lokalizuar	Zonat e trashëgimisë kulturore të identifikuar Brenda zonës së ndikimit të tubacionit
> Faza ndërtimore				
Shqetësim i përkohshëm i jetës së përditshme	Punimet e ndërtimit për tubacionin dhe rrugët e aksesit	Do të ndodhin ndryshime të përhershme ose të përkohshme në përdorimin e tokës.	Brenda brezit të punimeve përgjatë gjurmës (korridori prej 20 metrash), brenda zonave të punës për rrugët e aksesit, brenda perimetrit të instalimeve sipërfaqësore, kampeve të punës dhe kantjereve të tubave (shumë i lokalizuar)	Pronarët/mbajtësit e të drejtave të tokës dhe pronave brenda korridorit të punës, në vendodhjet e instalimeve sipërfaqësore dhe kampeve si dhe, pronarët e tokës, pronarët dhe mbajtësit e të drejtave të infrastrukturës që ndërpritet nga tubacioni.
	Çlirimet e pluhurit nga trajtimi i materialeve, çlirimet e pluhurit nga sipërfaqet e punës nën veprimin e erës dhe qarkullimit të automjeteve dhe nga produktet e djegies së karburanteve fosile në	Ndryshime të vogla në cilësinë e ajrit në qendrat e banuara në afërsi të zonave të ndërtimit (përfshirë kampet).	Zona e studimit	Popullsia në qendrat e banuara më të afërta (përgjatë gjurmës së IAP)

Subjekti	Burimet e ndikimeve	Ndikimet	Zona e ndikimit (Shtrirja hapësirë - SHH)	Zonat ose receptorët e ndjeshëm ndaj ndikimeve të projektit
	motorët e automjeteve dhe makinerive.			
	Çlirime të zhurmës nga automjetet dhe makineritë e rrethit të ndërtimit; dhe gjatë hidrotestimit për shkak të punës së kompresorëve dhe pompave	Ndikim nga zhurma në qendrat e banuara në afërsi të zonave të ndërtimit (përfshirë kampet).	Zona e studimit	Popullsia në qendrat e banuara më të afërta (përgjatë gjurmës së IAP)
	Punimet e ndërtimit të tubacionit në zonat e ndërprerjes me sistemet e kullimit dhe ujitjes.	Ndërprerja e sistemeve të kullimit dhe ujitjes.	Zona e studimit	Popullsia në qendrat e banuara më të afërta (përgjatë gjurmës së IAP) Pronarët/mbajtësit e të drejtave të infrastrukturës që ndërpritet nga tubacioni.
	Punimet e ndërtimit të tubacionit në zonat e ndërprerjes me elementë të ujësjellësve dhe linjat e energjisë dhe telekomunikacionit.	Dëmtime të elementëve mekanikë të ujësjellësve ose dëmtime të kablove dhe linjave të energjisë elektrike dhe telekomunikacionit	Zona e studimit	Popullsia në qendrat e banuara më të afërta (përgjatë gjurmës së IAP)
	Punimet e ndërtimit të tubacionit në zonat e ndërprerjes me korridoret e infrastrukturës së trafikut	Ndryshime në rregulloren e trafikut, ngecje/vonesa në trafik ose kthim mbrapsht dhe një rrezik i lartë për aksidente trafiku	Zona e studimit	Popullsia në qendrat e banuara më të afërta (përgjatë gjurmës së IAP)
Ndryshimet sociale dhe shtrirja gjinore (përfshirë fluksin e punës/punëtorët migrantë)	Fluksi i fuqisë punëtore (migrimi në zonën e ndërtimit) për punimet e ndërtimit.	Rreziku i konfliktit social. Rrezik i shtuar i sjelljes jo të ligjshme dhe krimit. Rritja e barrës dhe konkurrencës për sigurimin e shërbimeve publike. Dhuna gjinore. Rritja e rrezikut të sëmundjeve ngjitëse dhe	Zona e studimit	Popullsia në qendrat e banuara më të afërta (përgjatë gjurmës së IAP)

Subjekti	Burimet e ndikimeve	Ndikimet	Zona e ndikimit (Shtrirja hapësirë - SHH)	Zonat ose receptorët e ndjeshëm ndaj ndikimeve të projektit
		barrës së shërbimeve shëndetësore lokale. Rritja e presionit ndaj akomodimit dhe qirave.		
Ekonomia dhe punësimi në nivel lokal	Kufizime sociale ose efekte të mundshme diskriminuese në mundësitë e punësimit	Efekte të mundshme të diskriminimit	Zona e studimit	Romët
	Kufizime sociale ose efekte të mundshme diskriminuese në mundësitë e punësimit	Efekte të mundshme të diskriminimit	Zona e studimit	Punëtorët e pakualifikuar
	Kufizime sociale ose efekte të mundshme diferencuese në mundësitë e zhvillimit të biznesit	Mundësi më e vogël për zhvillimin e biznesit	Zona e studimit	Kompani lokale të pakualifikuara
	Kufizime sociale ose efekte të mundshme diferencuese në mundësitë e zhvillimit të biznesit	Mundësi më e vogël për zhvillimin e biznesit	Zona e studimit	Kompani/prodhues/ofrues shërbimesh lokalë/fuqi punëtore lokale
Përdorimi/a ksesi i tokës dhe burimeve natyrore dhe ndikimi në kushtet e jetesës që lidhet me blerjen e tokës dhe pastrimin e saj	Krijimi i brezit të punimeve për tubacionin	Humbje e përkohshme e tokës/pronave në zonat e ndërtimit	Brenda brezit të punimeve përgjatë gjurmës (korridorit prej 20 metrash) (shumë i lokalizuar).	Pronarët/mbajtësit e të drejtave të tokës dhe pronave brenda korridorit të punës, në vendodhjet e instalimeve sipërfaqësore dhe kampeve si dhe, pronarët e tokës, pronarët dhe mbajtësit e të drejtave të infrastrukturës që ndërpritet nga tubacioni.
	Ndërtimi dhe përmirësimi i rrugëve të aksesit	Humbje e përkohshme e tokës/pronave dhe dëmtim i mundshëm i infrastrukturës që ndërpritet nga tubacioni/përgjatë tubacionit	Brenda zonës së ndërtimit të rrugëve të aksesit (shumë i lokalizuar).	
	Ndërtimi i instalimeve sipërfaqësore, kampeve të punës dhe kantjereve të tubave	Humbje e përkohshme e tokës/pronave në zonat e ndërtimit	Brenda perimetrit të instalimeve sipërfaqësore, kampeve të punës dhe kantjereve të tubave (shumë i lokalizuar)	

Subjekti	Burimet e ndikimeve	Ndikimet	Zona e ndikimit (Shtrirja hapësirë - SHH)	Zonat ose receptorët e ndjeshëm ndaj ndikimeve të projektit
	Krijimi i brezit të punimeve për ndërtimin e tubacionit dhe ndërtimin dhe përmirësimin e rrugëve të aksesit. Ndërtimi i instalimeve sipërfaqësore, kampeve të punës dhe kantjereve të tubave	Humbje e përkohshme e tokës/pronave në zonat e ndërtimit	Shumë i lokalizuar	Punëtorët e punësuar nga pronarët/mbajtësit e të drejtave të tokës/pronave të prekura.
Të mirat publike, shërbimet, infrastrukturura përfshirë trafikun	Ndërtimi i tubacionit	Dëmtim i mundshëm i sistemeve të tjerë të infrastrukturës	Zona e studimit	Elementët më të afërt infrastrukturorë që ndërpriten nga tubacioni ose shtrihen përgjatë gjurmës.
	Transporti dhe shpërndarja e materialeve me kamionë përgjatë rrjetit rrugor ekzistues	Vonesa ose ngecje në rrugët e aksesit	Zona e studimit	Qendrat e banuara përgjatë gjurmës së tubacionit, zonat urbane dhe industriale të Tiranës, Durrësit, Lezhës dhe Shkodrës
Shëndeti dhe Siguria e komunitetit	Aksidente Fluksi i fuqisë punëtore	Sëmundje të mundshme, presion ndaj shëndetit të komunitetit dhe burimeve shëndetësore lokale	Zona e studimit	Punëtorët dhe popullsia në qendrat e banuara më të afërta përgjatë gjurmës së tubacionit
Shëndeti dhe Siguria në vendin e punës	Aktivitetet e ndërtimit, mekanika dhe paisjet	Plagosje të mundshme dhe rrezik shëndetësor nga materialet e rrezikshme	Shumë i lokalizuar	Punëtorët në zonën e ndërtimit
Grupet e cënueshme	Aktivitetet e ndërtimit, mekanika dhe paisjet	Perceptim negativ i IAP. Mundësi e pakët për pjesëmarrje në sistemin e vendimmarrjes. Pabarazia gjinore. Rreziku i konflikteve sociale. Dhuna gjinore.	Shumë i lokalizuar	Grupet e cënueshme (gratë, familjet me të ardhura të pakta, romët, fëmijët dhe të rinjtë, të moshuarit/pensionistët, pronarët, mbajtësit e të drejtave dhe punëtorët e tokave bujqësore) në zonën e projektit
	<p>Nëse gjatë punimeve të ndërtimit brenda korridorit të punës shfaqen lloje bimësh invazive, ato duhet të hiqen dhe depozitohen në mënyrën e duhur. Pas aktiviteteve të rehabilitimit, prania e bimëve invazive duhet të monitorohet rregullisht dhe në rast të ri-shfaqjes duhen zbatuar masa shtesë.</p> <p>Vendosja e kampeve të punës dhe kantjereve të tubave sa më larg të jetë e mundur nga zonat e pabanuara, rrjedhat ujore, dhe zonave me mbulim të lartë vegjetacioni natyror.</p> <p>Pas përfundimit të punimeve të ndërtimit, zonat në të cilat kanë qenë vendosur kantjeret e tubave dhe instalimet e përkohshme duhet të rehabilitohen që të kthehen në kushtet e mëparshme të përdorimit të tokës.</p> <p>Vendosja e kampeve të punës dhe kantjereve të tubave sa më larg të jetë e mundur nga zonat e pabanuara, rrjedhat ujore, dhe zonave me mbulim të lartë vegjetacioni natyror.</p> <p>Përgatitja dhe zbatimi i Planit të Menaxhimit të Biodiversitetit.</p> <p>Përgatitja dhe zbatimi i Planit të Rehabilitimit dhe Rigjenerimit /Plani i Menaxhimit të Pejzazhit.</p> <p>Vegjetacioni i brigjeve në afërsi të lumenjve dhe habitatet e rrjedhave të përhershme (nëse janë të pranishme) pas përfundimit të punimeve të ndërtimit duhet të rikthehen në gjendjen fillestare (përfshirë zonën prioritare të sigurisë 5+5 m)</p> <p>Përpara fillimit të punimeve makineritë e rënda dhe automjetet që do të përdoren gjatë punimeve të ndërtimit për kalimet me prerje të hapur të lumenjve/përrenjve/kanaleve duhet të lahen me shumë kujdes (veçanërisht gomat) me qëllim që të zvogëlohet mundësia e shpërndarjes së farave të llojeve invazive të bimëve. Larja duhet të përsëritet sa herë që makineritë dhe automjetet transferohen në një vendodhje të re.</p> <p>Të gjitha automjetet e punës (përfshirë ato në habitatet ujore) dhe tubat për hidrotestim duhet të lahen me kujdes me ujë të nxehtë përpara se të lëvizin për në një vendodhje të re me qëllim që të parandalohet hyrja e llojeve invazive.</p> <p>Të gjitha automjetet e punës (përfshirë ato në habitatet ujore) dhe tubat për hidrotestim duhet të lahen me kujdes me ujë të nxehtë përpara se të lëvizin për në një vendodhje të re me qëllim që të parandalohet hyrja e llojeve invazive.</p> <p>Përgatitja dhe zbatimi i Planit të Menaxhimit të Biodiversitetit.</p> <p>Të gjitha automjetet e punës (përfshirë ato në habitatet ujore) dhe tubat për hidrotestim duhet të lahen me kujdes me ujë të nxehtë përpara se të lëvizin për në një vendodhje të re me qëllim që të parandalohet hyrja e llojeve invazive.</p> <p>Hidrotestimi në të gjitha vendodhjet duhet të kryhet nën mbikqyrjen e biologëve të cilët duhet të konfirmojnë zbatimin e të gjitha masave për llojet tokësore dhe ujore invazive.</p>
Pyjet	<p>Përgatitja dhe zbatimi i Planit të Menaxhimit të Biodiversitetit.</p> <p>Përgatitja dhe zbatimi i Planit të Rehabilitimit dhe Rigjenerimit /Plani i Menaxhimit të Pejzazhit.</p> <p>Përgatitja dhe zbatimi i Strategjisë së Kompensimit të Biodiversitetit dhe Planit të Menaxhimit të Kompensimit të Biodiversitetit.</p> <p>Breza me vegjetacion mbrojtës duhet të krijohen përgjatë skajeve të rinj të formuar të pyjeve. Këta breza do të krijohen duke mbjellë lloje autoktonë (drurë dhe shkurre) përgjatë skajeve të formuar rishtas të pyjeve halorë dhe gjethegjërë me përqendrim të lartë të individëve me kurorë të dendur.</p> <p>Këta pyje gjenden ndërmjet progresivave: 59+918 - 59+783, 62+481 - 62+863, 72+973 - 73+205, 89+175 - 89+247, 132+927 - 133+048, 170+092 - 170+235.</p> <p>Pas prerjes duhet të kryhet sistemimi i pyjeve (drurët e prerë duhet të mbliqen dhe largohen, degët të hiqen ose stivosen, dhe trungjet të shkulen).</p> <p>Përgatitja dhe zbatimi i Planit të Menaxhimit të Biodiversitetit.</p> <p>Përgatitja dhe zbatimi i Planit të Rehabilitimit dhe Rigjenerimit /Plani i Menaxhimit të Pejzazhit.</p> <p>Breza me vegjetacion mbrojtës duhet të krijohen përgjatë skajeve të rinj të formuar të pyjeve. Këta breza do të krijohen duke mbjellë lloje autoktonë (drurë dhe shkurre) përgjatë skajeve të formuar rishtas të pyjeve halorë dhe gjethegjërë me përqendrim të lartë të drurëve me kurorë të dendur.</p>

Subjekti	Masat zbutëse
	<p>Këta pyje gjenden në afërsi të progresivave: 58+590 - 60+395, 61+672 - 64+098, 72+218 - 72+383, 72+884 - 73+248, 131+078 - 132+800, 138+463 - 140+052. Pas prerjes duhet të kryhet sistemimi i pyjeve (drurët e prerë duhet të mbliidhen dhe largohen, degët të hiqen ose stivosen, dhe trungjet të shkulen).</p>
Zonat e mbrojtura	<p>Përgatitja dhe zbatimi i Planit të Menaxhimit të Biodiversitetit. Përgatitja dhe zbatimi i Planit të Rehabilitimit dhe Rigjenerimit /Plani i Menaxhimit të Pejzazhit.</p> <p>Në të gjitha zonat ku vegjetacioni do të hiqet ose dëmtohet, menjëherë pas përfundimit të punimeve të ndërtimit duhet të mbillen barëra të ndryshëm dhe perime me qëllim që të parandalohet erozioni si dhe futja dhe përhapja e llojeve invazive.</p> <p>Në zonat pyjore, pas përfundimit të punimeve të ndërtimit, në korridorin e punimeve (përjashtuar zonën prioritare të sigurisë 5+5m) duhet të mbillen drurë dhe lloje shkurresh të përshtatshme me qëllim që të zbuten efektet e fragmentimit dhe të parandalohet vendosja e llojeve të bimëve invazive.</p> <p>Përpara fillimit të punimeve makineritë e rënda dhe automjetet që do të përdoren gjatë punimeve të ndërtimit duhet të lahen me shumë kujdes (veçanërisht gomat) me qëllim që të zvogëlohet mundësia e shpërndarjes së farave të llojeve invazive të bimëve. Larja duhet të përsëritet sa herë që makineritë dhe automjetet transferohen në një vendodhje të re.</p> <p>Me qëllim që të shmanget ndikimi negativ në vegjetacionin e brigjeve të lumit Buna, shpimi nëntokësor në këtë rrjedhë ujore duhet të fillojë jashtë brezit të vegjetacionit të pyjeve (145 m larg brigjeve të lumit Buna).</p> <p>Vegjetacioni i brigjeve në afërsi të lumenjve dhe habitatet e rrjedhave të përhershme (nëse janë të pranishme) pas përfundimit të punimeve të ndërtimit duhet të rikthehen në gjendjen fillestare (përjashtuar zonën prioritare të sigurisë 5+5 m).</p> <p>Nëse gjatë punimeve të ndërtimit brenda korridorit të punës shfaqen lloje bimësh invazive, ato duhet të hiqen dhe depozitohen në mënyrën e duhur. Pas aktiviteteve të rehabilitimit, prania e bimëve invazive duhet të monitorohet rregullisht dhe në rast të ri-shfaqjes duhen zbatuar masa shtesë.</p> <p>Gjatë punimeve të ndërtimit brenda kufijve të zonave të mbrojtura në pjesën veriore të gjurmës së IAP (nga progresiva 160+300 deri në fund të rrugës) biologët dhe ekspertët e tjerë të ruajtjes së natyrës duhet të jenë të pranishëm për të mbikqyrur në mënyrë konstante që të sigurohet se nuk do të dëmtohet sipërfaqe shtesë.</p> <p>Restaurimi i vegjetacionit brenda Zonës së Rëndësishme për Bimët të Liqenit të Shkodrës dhe Lumit Buna (nga progresiva 166+820 deri në fund të rrugës) duhet të mbikqyren nga botanisti.</p> <p>Në të gjitha zonat ku vegjetacioni do të hiqet ose dëmtohet, menjëherë pas përfundimit të punimeve të ndërtimit duhet të mbillen barëra të ndryshëm dhe perime me qëllim që të parandalohet erozioni si dhe futja dhe përhapja e specieve invazive.</p> <p>Përpara fillimit të punimeve makineritë e rënda dhe automjetet që do të përdoren gjatë punimeve të ndërtimit duhet të lahen me shumë kujdes (veçanërisht gomat) me qëllim që të zvogëlohet mundësia e shpërndarjes së farave të llojeve invazive të bimëve. Larja duhet të përsëritet sa herë që makineritë dhe automjetet transferohen në një vendodhje të re.</p> <p>Nëse gjatë punimeve të ndërtimit brenda korridorit të punës shfaqen lloje bimësh invazive, ato duhet të hiqen dhe depozitohen në mënyrën e duhur. Pas aktiviteteve të rehabilitimit, prania e bimëve invazive duhet të monitorohet rregullisht dhe në rast të ri-shfaqjes duhen zbatuar masa shtesë.</p> <p>Rrugët e aksesit ndërmjet progresivës 160+000 dhe fundit të gjurmës duhet të vendosen në anën verilindore të korridorit të IAP me qëllim që të shmanget sa më shumë të jetë e mundur Zona e Rëndësishme për Shpendët (IBA).</p>

Subjekti	Masat zbutëse
	<p>Në të gjitha zonat ku vegjetacioni do të hiqet ose dëmtohet, menjëherë pas përfundimit të punimeve të ndërtimit duhet të mbillen barëra të ndryshëm dhe perime me qëllim që të parandalohet erozioni si dhe futja dhe përhapja e llojeve invazive.</p> <p>Përpara fillimit të punimeve makineritë e rënda dhe automjetet që do të përdoren gjatë punimeve të ndërtimit duhet të lahen me shumë kujdes (veçanërisht gomat) me qëllim që të zvogëlohet mundësia e shpërndarjes së farave të llojeve invazive të bimëve. Larja duhet të përsëritet sa herë që makineritë dhe automjetet transferohen në një vendodhje të re.</p> <p>Nëse gjatë punimeve të ndërtimit brenda korridorit të punës shfaqen lloje bimësh invazive, ato duhet të hiqen dhe depozitohen në mënyrën e duhur. Pas aktiviteteve të rehabilitimit, prania e bimëve invazive duhet të monitorohet rregullisht dhe në rast të ri-shfaqjes duhen zbatuar masa shtesë.</p> <p>Vendosja e kampeve të punës dhe kantjereve të tubave sa më larg të jetë e mundur nga zonat e pabanuara, rrjedhat ujore, dhe zonave me mbulim të lartë vegjetacioni natyror.</p> <p>Pas përfundimit të punimeve të ndërtimit, zonat në të cilat kanë qenë vendosur kantjeret e tubave dhe instalimet e përkohshme duhet të rehabilitohen që të kthehen në kushtet e mëparshme të përdorimit të tokës.</p> <p>Të gjitha punimet e ndërtimit ndërmjet progresivës 160+000 dhe fundit të gjurmës duhet të kryhen jashtë sezonit të shumimit (nga marsi deri në fund të gushtit) të shumicës së shpendëve të lagunave që janë evidentuar në zonën e gjerë të projektit.</p> <p>Të gjitha punimet e ndërtimit ndërmjet progresivës 160+000 dhe fundit të gjurmës duhet të organizohen në varësi të kohës së ditës – duhet të fillojnë dy orë pas lindjes së diellit dhe të përfundojnë një orë përpara perëndimit.</p> <p>Të gjitha punimet e ndërtimit ndërmjet progresivës 160+300 dhe fundit të gjurmës duhet të kryhen nën mbikqyrjen konstante të ornitologut me qëllim që të sigurohet zbatimi i duhur i masave që lidhen me shmangien e ndikimeve tek shpendët (duke shmangur kohën më të ndjeshme të vitit dhe ditës).</p> <p>Përgatitja dhe zbatimi i Planit të Menaxhimit të Biodiversitetit.</p> <p>Të gjitha automjetet e punës (përfshirë ato në habitatet ujore) dhe tubat për hidrotestim duhet të lahen me kujdes me ujë të nxehtë përpara se të lëvizin për në një vendodhje të re me qëllim që të parandalohet hyrja e llojeve invazive.</p> <p>Hidrotestimi në të gjitha vendodhjet duhet të kryhet nën mbikqyrjen e biologëve të cilët duhet të konfirmojnë zbatimin e të gjitha masave për llojet tokësore dhe ujore invazive.</p>
<p>› Faza e funksionimit</p>	
<p>Biodiversiteti</p>	<p>Llojet invazive brenda zonës së sigurisë, në afërsi të objekteve sipërfaqësore dhe rrugëve të përhershme të aksesit do të hiqen dhe asgjесohen në mënyrën e duhur.</p>
<p>Zonat e mbrojtura</p>	<p>Llojet invazive brenda zonës së sigurisë, në afërsi të objekteve sipërfaqësore dhe rrugëve të përhershme të aksesit do të hiqen dhe asgjесohen në mënyrën e duhur.</p>
<p>Shkarkimet në mjedis</p>	
<p>› Faza ndërtimore</p>	
<p>Cilësia e ajrit</p>	<p>Për reduktimin e pluhurit në sheshet e punës dhe përgjatë rrugëve të aksesit të përdorura nga projekti, sipas nevojës do të zbatohen këto masa:</p> <ul style="list-style-type: none"> - spërkatja e rregullt me ujë për të ruajtur lagështinë në rrugë dhe kohezionin e grimcave të pluhurit; - ulja e shpejtësisë së automjeteve (20 km/h) brenda dhe pranë zonave të ndjeshme (qendra të banuara). <p>Vendosja në kontratë e klauzolave për praktikatat më të mira të SHSM përfshirë masat për uljen e pluhurit:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) largimi i pluhurit 2) lagja/spërkatja me ujë

Subjekti	Masat zbutëse
	<p>3) transporti/trajtimi i duhur i ngarkesave 4) mirëmbajtja e makinerive 5) fikja e motorëve 6) ulja e shpejtësisë së automjeteve. Flota e automjeteve ose makinerive që shkarkojnë gaze të djegies do të mbahen në intervale dhe sipas metodave të specifikuar nga prodhuesi. Paralajmërimi i bashkive për aktivitete me çlirim kritik të pluhurit. Trailerat dhe kontenerët metalikë të përdorur për mbajtjen e materialeve të cilat mund të derdhen (rërë, material copëzor, inerte, materiale të caktuara) duhet të mbulohen për të gjithë itinerarin nga një zonë punimesh në një tjetër. Kur magazinimi, transporti dhe trajtimi i pjesës më të madhe të materialeve bëhet në mjedis të hapur dhe të ekspozuar ndaj erës, masat e nevojshme që duhet të zbatohen për uljen e pluhurit, duhet të përfshijnë një ose disa nga teknikat e mëposhtme: - lagia e sipërfaqes, - mbulimi i sipërfaqes - mbjellja me vegjetacion e sipërfaqes.</p> <p>Gjatë ditëve të thata, lagia me ujë e zonave të operacioneve që nuk janë të shtruara.</p> <p>Shtypje me ujë e pluhurit (sipas nevojës në varësi të llojit të tokave) gjatë sezonit të thatë në brezin e punimeve dhe rrugët e pashtuara që gjenden <200 m karg qendrave të banuara.</p> <p>Flota e automjeteve ose makinerive që shkarkojnë gaze të djegies do të mbahen në intervale dhe sipas metodave të specifikuar nga prodhuesi.</p>
Zhurma	<p>Kur është e përshtatshme, punimet e ndërtimit në afërsi të objekteve të banimit (<100 m) duhet të kryhen gjatë ditës (nga 07:00 deri në 19:00). Punimet e ndërtimit në afërsi të objekteve të banimit duhet të përmbushin kufizimet ligjore. Makineritë dhe automjetet të fiken kur nuk janë në regjim pune. Vendosja e paisjeve stacionare (p.sh. kompresorët) sa më larg të jetë e mundur nga receptorët më të afërt (zonat e banimit). Në rastet kur nuk është e mundur të sigurohet distancë e mjaftueshme nga rezidencat për vendosjen e paisjeve stacionare (p.sh. kompresorët) të përdoren barrierat ndaj zhurmës gjatë aktiviteteve ndërtimore.</p>
Menaxhimi i mbetjeve	<p>Përgatitja dhe zbatimi i një Plani për Menaxhimin e Mbetjeve në përputhje me standartet ndërkombëtare dhe legjislacionin shqiptar për menaxhimin e mbetjeve, për organizimin e zonave të ruajtjes së përkohshme (përfshirë kushtet e veçanta për ruajtjen e mbetjeve të rrezikshme) dhe dinamikat e asgjësimit. Krijimi dhe mbajtja e rregjistrit të mbetjeve. Në këtë rregjistër do të rregjistrohen të gjitha operacionet që lidhen me mbetjet: prodhimi, grumbullimi, ruajtja e përkohshme, transporti, trajtimi. Në këtë rregjistër dokumentohen këto aspekte: - lloji i mbetjeve, - sasia e mbetjeve, - emri dhe adresa e instalimit për menaxhimin e mbetjeve, në të cilin dërgohen. - emri dhe adresa e transportuesit të mbetjeve; - trajtimi i planifikuar i mbetjeve. Ruajtja e rregjistrit për së paku 3 vjet pas pranimit të përkohshëm të punimeve. Tre kategori mbetjesh duhet të identifikohen në zonat e punimeve dhe në dokumentet gjurmues: mbetje të rrezikshme, mbetje jo-të rrezikshme dhe mbetje inerte.</p>

Subjekti	Masat zbutëse
	<p>Për mbledhjen dhe riciklimin e mbetjeve të riciklueshme do të kontraktohet një kompani e licencuar. Mbetjet e riciklueshme do të largohen nga vendi i ruajtjes së përkohshme rregullisht, jo më rrallë se çdo 2 muaj.</p> <p>Mbetjet do të mblidhen nga çdo zonë punimesh në të njëjtën sasi që janë prodhuar dhe do të çohen në vendin e përkohshëm të ruajtjes i cili duhet të plotësojë këto kritere:</p> <ul style="list-style-type: none"> - gjendet së paku 100 m larg çdo zone natyrore të ndjeshme dhe mbi 500 m larg çdo zone të ndjeshme socio-ekonomike, - gjendet në një sipërfaqe të sheshtë të papërshkueshme për të parandaluar infiltrimin, - ka shtresë në dyshe për mbetjet jo inerte, - kontenierë në përmasa të përshtatshme, të padepërtueshëm dhe nivel rezistence në varësi të rrezikut dhe fazës së mbetjes (e ngurtë, e lëngët, e gaztë), - vendi i ruajtjes së mbetjeve të lëngëshme i pajisur me një rrethim të dytë me volum të paktën sa volumi i mbetjeve në kontenierë. <p>Pjesa e mbetur e materialit të gjermimeve duhet të ruhet e ndarë përpara se të hiqet. Depozitimi përfundimtar duhet të koordinohet ngushtësisht me autoritetet përgjegjës. Nuk lejohet depozitimi i pjesës së mbetur të materialit të gjermimeve në toka bujqësore ose pyje, kullota ose habitate të tjerë të çënueshëm (shpella, hinka natyrore etj.). Dherat e kontaminuara nga derdhjet/rrjedhjet duhet të mblidhen veçmas dhe të dërgohen në kompani të autorizuar.</p>
<p>› Faza e funksionimit</p>	
<p>Cilësia e ajrit</p>	<p>Mirëmbajtja e pajisjeve dhe monitorimi i boilerave të instaluar në BVS/PRMS Fushë - Kruja, PTS/BVS/PRMS Mamurras, PTS/BVS/PRMS Kavajë, BVS/PRMS Tiranë dhe PRMS Lezhë.</p> <p>Matje vetëm një herë, pas futjes në funksionim të objekteve sipërfaqësore (PRMS).</p>
<p>Zhurma</p>	<p>Kryerja rregullisht e mirëmbajtjes së paisjeve që reduktojnë zhurmën.</p> <p>Instalimi në PRMS i shuajtësve të zhurmës për reduktimin e niveleve të zhurmës së çliruar nga valvulat e reduktimit.</p>
<p>Menaxhimi i mbetjeve</p>	<p>Zbatimi i Planit të Menaxhimit të Mbetjeve.</p> <p>Mbetjet e prodhuara gjatë operacioneve të mirëmbajtjes duhet të mblidhen të ndara në kontenierë specialë dhe dërgohen në kompani të autorizuar.</p>
<p>Ndikime sociale dhe në shëndet</p>	
<p>› Faza para-ndërtimore</p>	
<p>Shqetësimet e komunitetit</p>	<p>Ndryshimi sipas nevojës dhe zbatimi i Planit të Angazhimit të Palëve të Interesit.</p> <p>Ndryshimi sipas nevojës dhe zbatimi i Mekanizmit të Ankesave që palët e interesit të mund të raportojnë shqetësimet e veçanta.</p> <p>Mbajtja e konsultimeve publike në të cilat të gjitha palëve të interesuara duhet t'u paraqiten qartë dhe thjeshtë masat zbutëse për minimizimin e të gjitha ndikimeve (mjedisore, sociale dhe ekonomike) si dhe përfitimet e përgjithshme nga projekti.</p> <p>Konsultimet duhet të mbahen gjatë gjithë ciklit të projektit të ardhshëm.</p> <p>Përgatitja dhe komunikimi i Planit të Restaurimit të kushteve të jetesës në të cilin kompensimi duhet të bazohet në parimet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Blerja i tokës dhe e drejta e servitutit dhe aksesit për IAP do të bëhet në përputhje me ligjin shqiptar dhe kërkesat ndërkombëtare (BERZH KP 5, 2019.). • IAP do të kërkojë të minimizojë zhvendosjet ekonomike. • Ndikimet në pronësinë mbi tokën, përdorimin e tokës dhe kushtet e jetesës duhet të kompensohen. • Toka e nevojshme për përdorim të përhershëm për instalimet sipërfaqësore do të blihet nga pronarët aktualë.

Subjekti	Masat zbutëse
	<ul style="list-style-type: none"> • Toka e nevojshme për përdorim të përkohshëm, përfshirë korridorin e punimeve (brezin e punimeve) dhe toka e nevojshme përkohësisht për ndërtimin e instalimeve përkatëse të tilla si kampet e punës ose kantieret e magazinimit të tubave, nuk do të përvetësohet nga IAP, por do të merret me qira (leasing) për së paku dy vjet (pak a shumë në varësi të kohës së nevojshme) nga pronarët aktualë tek të cilët do të kthehet pas përfundimit të ndërtimit dhe rikthimit në gjendjen fillestare. • Për tokat subjekt i kufizimeve gjatë fazës së funksionimit, këto kufizime do t’iu kompensohen pronarëve të prekur. • Kompensimi për tokën dhe kulturat bujqësore bazuar në vlerën e plotë të zëvendësimit paguhet përpara fillimit të ndërtimit. Vlera e plotë e zëvendësimit do të përfshijë edhe kostot e transaksioneve. • Toka pa pronar (jetime), p.sh. tokë e ndarë ose e copëtuar në atë mënyrë që një pjesë e pa përvetësuar e truallit bëhet e pa aksesueshme, jo ekonomike dhe/ose e paqëndrueshme, do të kompensohet. • Procesi i aksesimit të tokës, përfshirë identifikimin e parcelave dhe pronarëve/përdoruesve të prekur, blerja e tokës dhe e drejta e servitutit, si dhe marrja me qira do të administrohet nga IAP dhe agjentë të specializuar tokash. • Ekipet e IAP për tokat do të kërkojnë të hyjnë në marrëveshje të negociueshme me pronarët dhe përdoruesit e tokës kurdo që të jetë e mundur. Kur nuk mund të arrihet marrëveshje, ekipet e tokave duhet t’i drejtohen shpronësimit, në përputhje me ligjin shqiptar për shpronësimet, nën kontrollin e autoriteteve kompetente dhe gjykatave. Ndërmjet të tjerash, kjo mund të aplikohet në situata kur pronarët ose përdoruesit e tokës janë të panjohur (pronarë të munguar) si dhe në situata kur negociatat për mirëbesim nuk arrijnë një marrëveshje reciprokisht të pranuar. • Personat e prekur do të kenë akses në mekanizmin e ankesave, përfshirë nivelin e parë të shqyrtimit të brendshëm të ankesave nga IAP, dhe mundësinë e personave të dëmtuar t’i drejtohen nivelit të dytë të rishikimit të ankesës në mënyrë të pavarur. • Personat e prekur do të kenë akses në masat për mbështetjen e kushteve të jetesës që përmes restaurimit të sigurohen standartet e jetesës së të prekurve në nivelin e para-projektit. • Grupet e cënueshme do të identifikohen dhe asistohen në mënyrë të veçantë sipas nevojës. <p>Hapat kryesorë ligjorë të procesit që duhet të ndiqen dhe zbatohen përpara se të fillojë ndërtimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Identifikimi i tokës që do të preket – përditësimi me të dhëna nga regjistri i tokave (kadastra) për korridorin prej 400 m (200+200). • Verifikimi i titujve të pronësisë për tokat bujqësore. • Përgatitja e inventarit të pronave. • Vendosja e të drejtës së uzufuktit. • Vendosja e të drejtës së servitutit. • Varianti i blerjes (“Marrëveshja me kapar”). • Shpronësim për interes publik me përfitim të një inestitori privat. • Vlerësimi dhe llogaritja e kompensimit. • Procesi i legalizimit. • Pretendimet dhe ankesat. • Nënshkrimi i marrëveshjes për akses në toka.
Trashëgimia kulturore	<p>Burimet e trashëgimisë kulturore duhet të konsiderohen dhe përfshihen në fazat e mëtejshme të hartimit të projektit dhe duhet të bëhen të gjitha përpjekjet e arësyeshme për shmangien e siteve/objekteve të trashëgimisë kulturore gjatë përgatitjes së projektit. Në përgatitjen e dokumenteve të projektit duhet të zbatohet hierarkia zbutëse. Përgatitja dhe zbatimi i Planit të Menaxhimit dhe Monitorimit të Trashëgimisë Kulturore (PMMTK).</p>

Subjekti	Masat zbutëse
	<p>Kryerja e një vrojtimi të detajuar në të gjitha vendet e trashëgimisë kulturore të identifikuar në VNMS dhe përgatitja para-ndërtimit e një/disa studimi (eve) për identifikimin dhe vlerësimin e mëtejshëm të të gjithë vendeve, që të sigurohet se do të zbatohet një përgjigje dhe zbutje e përshtatshme. Aktivitete që do të kryhen në kuadër të studimit/studimeve para-ndërtimore duhet të dakordësohen me institucionet kombëtare përkatëse. Gjetjet e këtyre studimeve duhet të përfshihen në PMMTK. Përgjegjësitë e këshilltarit të punësuar për trashëgiminë kulturore duhet të përfshijnë por jo të kufizohen në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kujdesin që ndërtimi kryhet në përputhje me PMMTK. • Sigurinë që për punimet arkeologjike janë marrë të gjitha lejet nga organet e duhur qeveritare. • Përgatitjen e raporteve të përshtatshme të dokumentuara dhe/ose raporteve sipas të cilave projekti lejohet të procedojë (në lidhje me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore). • Verifikimin e rëndësisë së trashëgimisë kulturore të çdo gjetjeje rastësore të mundshme dhe rekomandimin e veprimeve të duhura. <p>Kontraktori i ngarkuar me punimet e ndërtimit duhet të punësojë një kontraktor arkeolog të licencuar sipas legjislacionit shqiptar përkatës për të punuar në Shqipëri, i cili do të jetë përgjegjës (por jo vetëm) për:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kryerjen e gërmimit arkeologjik. • Rregjistrimin, studimin dhe raportimin për materialet e zbuluara gjatë fazës para-ndërtimore dhe ndërtimore dhe duke siguruar raporte të njejtë sipas një frekuence (shpeshtësie) të paracaktuar. • Raportimin e gjetjeve rastësore kur ato ndodhin. • Ofrimin e udhëzimeve për personelin tjetër të IAP në terren në njohjen dhe mënyrën e sjelljes për çështje të trashëgimisë kulturore. • Rregjistron aktivitetet e monitorimit.
<p>› Faza ndërtimore</p>	
<p>Shqetësim i përkohshëm i jetës së përditshme</p>	<p>Zbatimi dhe nëse është i nevojshëm, ndryshimi i Planit të Angazhimit të Palëve të Interesit.</p> <p>Zhvillimi i konsultimeve me popullsinë e prekur. Përdorimi i metodave më të përshtatshme të konsultimit – mbledhje me publikun, mbledhje me grupet e targetuar, fletëpalosje për projektin, tabela në rrugë, faqe interneti për projektin.</p> <p>Gjatë konsultimeve të gjitha palëve të interesuara duhet t’u paraqiten qartë dhe thjeshtë masat zbutëse për minimizimin e të gjitha ndikimeve (mjedisore, sociale dhe ekonomike) si dhe përfitimet e përgjithshme nga projekti. Informacioni për mundësinë e paraqitjes së një ankese dhe mënyrën e paraqitjes, duhet të komunikohet qartë dhe me transparencë.</p> <p>Zbatimi dhe nëse është i nevojshëm, ndryshimi i Mekanizmit të Ankesave që jepet në Planin e Angazhimit të Palëve të Interesit.</p> <p>Në orë të kufizuara, ofrimi i aksesit të përkohshëm në banesa për banorët lokalë duke vendosur pllaka çeliku mbi kanale; në rastet kur kufizimet në akses nuk mund të shmangen, duhet të gjenden zgjidhje alternative në bashkëpunim me autoritetet lokale dhe drejtuesit e komunitetit.</p> <p>Sigurimi i aksesit në prona private (toka bujqësore, kullota ose aktivitete të tjera bujqësore etj.) ose përcaktimi i alternativave të përshtatshme të aksesit në konsultim me pronarët ose përdoruesit.</p> <p>Gjatë planifikimit final të rrugëve të aksesit që do të përdoren për ndërtim, është e nevojshme të zbatohen masat e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Itineraret që do të përshkojë flota e automjeteve dhe makinerive të projektit duhet të hartëzohen për çdo rrugë drejt sheshit të ndërtimit dhe ndërmjet shesheve të ndryshëm të ndërtimit. • Rrugët ekzistuese, atje ku është e nevojshme, do të përmirësohen në drejtim të sigurisë rrugore (zgjerim i rrugës, rritje e kapacitetit mbajtës) që të mundësojë trafik të sigurtë të automjeteve të përmasave të mëdha që synon të mobilizojë kontraktori. • Rrugë të reja aksesi do të hapen vetëm në vende ku për shkak të terrenit natyror (shpate të pjerrët etj.) nuk është i mundur aksesi i gjurmës së tubacionit nëpërmjet rrugëve ekzistuese. Do të përdoret informacioni mbi territorin për të shmangur qendrat e banuara.

Subjekti	Masat zbutëse
	<ul style="list-style-type: none"> • Kryerja e një analize “Swept path” e cila është në gjendje të tregojë se itinerarët e planifikuar mund të akomodojnë lëvizjen e automjetit më të gjatë dhe të gjerë që synon të mobilizojë Kontraktori, pa dëmtuar pronat dhe objektet, veçanërisht në zona ku hapsira për manovrimin e automjeteve është e kufizuar, të tilla si kalimet nëpër fshatra ose të ngjashme me to. • Informimi i autoriteteve që administrojnë zonat që do të përshkrijnë automjetet e projektit në lidhje me itinerarin dhe karakteristikat e flotës së automjeteve të ndërtimit (shpeshësia e kalimit, madhësia dhe pesha e kamionëve, materialet që transportojnë). • Nëse përdoren rrugë ekzistuese, është e nevojshme të përcaktohet dhe regjistrohet gjendja “origjinale” e rrugëve të përdorura dhe objekteve të afërt në mënyrë që të mund të justifikohen ankesat e mëvonshme të pronarit dhe të mund të identifikohen e riparohen dëmtimet e mundshme që rezultojnë nga përdorimi. • Procedura e përcaktimit të gjendjes “origjinale” të përfshijë minimalisht: një vizitë në vend në prani të përfaqësuesit të autoritetit mirëmbajtës të rrugës, inspektimin e rrugëve dhe objekteve të afërt të cilët mund të dëmtohen nga ndërtimi (nëse ka të tillë), dhe dokumentimi i kujdesshëm i kushteve “origjinale” përmes fotografimit dhe regjistrimeve video. Këto regjistrime do të përdoren si standarti përkundrejt të cilit do të vlerësohet cilësia e punimeve të rehabilitimit kur të përfundojnë operacionet e ndërtimit. • Nëse në disa raste alternativa e vetme janë rrugët ekzistuese përmes qendrave të banuara, nevojitet të hartëzohen objektet e ndjeshme me trafik të shtuar dhe prani njerëzore (shkolla, kopshte fëmijësh, spitale, objekte të besimit, objekte kulturore, sociale dhe të kohës së lirë, sportive etj.) me qëllim që të shmangen dhe garantohet siguria publike. • Me përjashtim të kushteve të veçanta, automjetet e rënda (d.m.th. automjete me peshë më shumë se 3.5 ton) nuk do të përdorin rrugët publike gjatë natës, ndërmjet 22:00 dhe 06:00. Asnjë nga automjetet e projektit nuk do të lejohet të qarkullojë nëpër fshatra nga 20:00 deri në 08:00. Në përputhje me orarin e turneve shkollore, automjetet e rënda të projektit (d.m.th. automjete me peshë më shumë se 3.5 ton) do të ndalohen të qarkullojnë nëpër fshatra kur nxënësit shkojnë dhe kthehen nga shkolla. • Shpejtësia maksimale e të gjithë makinerive duhet të përmbushë kufizimet e shpejtësisë në Shqipëri ose kufizimet e mëposhtme, cilado qoftë më e ulëta: 20 km/h brenda zonave të punës, fshatrave dhe qendrave të banuara, që nga 100 m para shtëpisë së parë; 40 km/h në qytete; 80 km/h në rrugë të pashtuara jashtë fshatrave dhe qyteteve. • Në koordinim me autoritetet kompetente shqiptare, Kontraktori do të sigurojë dhe instalojë përgjatë rrugëve publike që përdor projekti, tabelat sinjalizuese për flotën e automjeteve, kur shenjat publike nuk janë të përshtatshme. • Kontraktori të pajisë çdo shofer të tij me një hartë në shkallë të përshtatshme të rrugëve të autorizuara për përdorim, ku tregohen qartë shpejtësitë maksimale të autorizuara dhe të sigurohet për mirëkuptimin e tyre. • Zbatimi, kontrolli dhe dokumentimi në vend i dispozitave për ndalimin e drejtimit të automjetit në gjendje të dehur. Duhet të prezantohen mekanizmat për kontrollin e shoferëve dhe dokumentimin e kontrolleve.
	<p>Informacioni për mundësinë e paraqitjes së një ankese dhe mënyrën e paraqitjes, duhet të komunikohet qartë dhe me transparencë. <i>Masat listohen tek Cilësia e ajrit.</i></p>
	<p>Informacioni për mundësinë e paraqitjes së një ankese dhe mënyrën e paraqitjes, duhet të komunikohet qartë dhe me transparencë. <i>Masat listohen tek Zhurma.</i></p>
	<p>Informacioni për mundësinë e paraqitjes së një ankese dhe mënyrën e paraqitjes, duhet të komunikohet qartë dhe me transparencë. <i>Masat listohen tek Të mirat publike, shërbimet, infrastruktura dhe transporti përfshirë trafikun</i></p>
	<p>Informacioni për mundësinë e paraqitjes së një ankese dhe mënyrën e paraqitjes, duhet të komunikohet qartë dhe me transparencë. <i>Masat listohen tek Të mirat publike, shërbimet, infrastruktura dhe transporti përfshirë trafikun</i></p>
	<p>Përgatitja dhe zbatimi i Planit të Menaxhimit të Trafikut përfshirë vlerësimin e detajuar të rrezikut – duke marrë në konsideratë afërsinë e trafikut të drejtpërdrejtë, shërbimeve që lidhen me të, paqëndrueshmërinë e themeleve etj.</p>

Subjekti	Masat zbutëse
	<p>Itineraret që do të përshkojë flota e automjeteve dhe makinerive të projektit duhet të hartëzohen për çdo rrugë drejt sheshit të ndërtimit dhe ndërmjet shesheve të ndryshëm të ndërtimit.</p> <p>Rrugët ekzistuese, atje ku është e nevojshme, do të përmirësohen në drejtim të sigurisë rrugore (zgjerim i rrugës, rritje e kapacitetit mbajtës) që të mundësojë trafik të sigurt të automjeteve të përmasave të mëdha që synon të mobilizojë kontraktori.</p> <p>Informimi i autoriteteve që administrojnë zonat që do të përshkojnë automjetet e projektit në lidhje me itinerarin dhe karakteristikat e flotës së automjeteve të ndërtimit (shpeshësia e kalimit, madhësia dhe pesha e kamionëve, materialet që transportojnë).</p> <p>Shpejtësia maksimale e të gjithë makinerive duhet të përmbushë kufizimet e shpejtësisë në Shqipëri ose kufizimet e mëposhtme, cilado qoftë më e ulëta: 20 km/h brenda zonave të punës, fshatrave dhe qendrave të banuara, që nga 100 m para shtëpisë së parë; 40 km/h në qytete; 80 km/h në rrugë të pashtuara jashtë fshatrave dhe qyteteve.</p> <p>Në koordinim me autoritetet kompetente shqiptare, Kontraktori do të sigurojë dhe instalojë përgjatë rrugëve publike që përdor projekti, tabelat sinjalizuese për flotën e automjeteve, kur shenjat publike nuk janë të përshtatshme.</p> <p>Kontraktori të pajisë çdo shofer të tij me një hartë në shkallë të përshtatshme të rrugëve të autorizuara për përdorim, ku tregohen qartë shpejtësitë maksimale të autorizuara dhe të sigurohet për mirëkuptimin e tyre.</p> <p>Zbatimi, kontrolli dhe dokumentimi në vend i dispozitave për ndalimin e drejtimit të automjetit në gjendje të dehur. Duhet të prezantohen mekanizmat për kontrollin e shoferëve dhe dokumentimin e kontrolleve.</p> <p>Në orë të kufizuara, ofrimi i aksesit të përkohshëm në banesa për banorët lokalë duke vendosur pllaka çeliku mbi kanale; në rastet kur kufizimet në akses nuk mund të shmangen, duhet të gjenden zgjidhje alternative në bashkëpunim me autoritetet lokale dhe drejtuesit e komunitetit.</p> <p>Sigurimi i aksesit në prona private (toka bujqësore, kullota ose aktivitete të tjera bujqësore etj.) ose përcaktimi i alternativave të përshtatshme të aksesit në konsultim me pronarët ose përdoruesit.</p> <p>Informacioni për mundësinë e paraqitjes së një ankese dhe mënyrën e paraqitjes, duhet të komunikohet qartë dhe me transparencë.</p>
<p>Shumëllojshmëria sociale dhe shtrirja gjinore (përfshirë fluksin e punës/punëtorët migrantë)</p>	<p>Përgatitja dhe zbatimi i Planit të Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë së komunitetit.</p> <p>Zbatimi dhe nëse është e nevojshëm, ndryshimi i Planit të Angazhimit të Palëve të Interesit.</p> <p>Mbajtja e konsultimeve me popullatën e ndikuar, veçanërisht grupet e cënueshme të identifikuar, ku të paraqitet qartë dhe thjeshtë i gjithë informacioni mbi ndikimet e mundshme dhe masat zbutëse. Zbulimi i informacioneve që lidhen me projektin në mënyrë që palët e interesit dhe komunitetet lokale të kuptojnë këto rreziqe dhe ndikimet e mundshme, si dhe masat e propozuara për parandalimin, zbutjen dhe reagimin ndaj emergjencave.</p> <p>Zhvillimi i fushatave të ndërgjegjësimit për higjienën publike dhe mënyrën se si mund të përhapen sëmundjet.</p> <p>Ofrimi i materialeve edukative dhe rritja e ndërgjegjësimit për të shmangur ose minimizuar transmetimin e sëmundjeve ngjitëse të cilat mund të jenë të lidhura me fluksin e punëtorëve të përkohshëm/përhershëm të projektit (për komunitetin dhe punëtorët).</p> <p>Ndihmë në përmirësimin e infrastrukturës së kujdesit ndaj shëndetit.</p> <p>Zhvillimi i fushatave të ndërgjegjësimit mbi barazinë gjinore dhe të drejtat e grave.</p> <p>Zbatimi dhe nëse është e nevojshëm, ndryshimi i Mekanizmit të Ankesave që jepet në Planin e Angazhimit të Palëve të Interesit. Informacioni për mundësinë e paraqitjes së një ankese dhe mënyrën e paraqitjes, duhet të komunikohet qartë dhe me transparencë.</p>
<p>Ekonomia dhe punësimi në nivel lokal</p>	<p>Maksimizimi i punësimit lokal dhe blerjes së mallrave nga furnitorët lokalë.</p> <p>Të gjitha mundësitë e punësimit dhe mënyrat e aplikimit duhet të komunikohen qartë dhe informacioni duhet të jepet jo vetëm gjatë prezantimeve dhe konsultimeve por edhe përmes fletëpalosjeve të projektit, faqes së internetit të projektit. Ky informacion duhet të jetë i disponueshëm në zyrat qendrore të çdo bashkie, në territorin e së cilës kalon gjurma e IAP.</p> <p>Dakordësimi i Strategjisë së Punësimit me Kontraktorin kryesor. Strategjia e punësimit duhet:</p>

Subjekti	Masat zbutëse
	<p>- të përfshijë kërkesat për punësimin e punëtorëve të pakualifikuar nga vendi dhe bashkitë që ndërpriten nga gazsjellësi;</p> <p>-të përshkruajë dhe kërkojë një proces të rregullt dhe transparent për të gjitha hapjet;</p> <p>-të përcaktojë vendet e synuara për rekrutimin e punëtorëve të pakualifikuar për secilën nga zonat e punimeve;</p> <p>-të inkurajojë zënien nga rezidentët e të gjitha punëve të pakualifikuara të shërbimit në kampet e punës;</p> <p>- të inkurajojë punësimin e individëve nga grupet e cënueshme kur kjo është e mundur, duke zbatuar politika jo diskriminuese.</p> <p>Përgatitja dhe zbatimi i Planit të Menaxhimit të Fuqisë punëtore për adresimin e rreziqeve ndaj të drejtave të punëtorëve, standarteve të punës, shëndetit dhe sigurisë, duke përmbledhur pritshmëritë dhe procedurat për ruajtjen e kushteve cilësore të punës, aktiviteteve dhe sjelljes.</p> <p>Zbatimi i një programi me faza të rritjes së kapaciteteve, i cili do t'u mundësojë kompanive lokale të arrijnë kualifikimet dhe çertifikimin e mundshëm me standartet përkatës mjaftueshëm përpara procesit të tenderimit.</p> <p>Informacioni mbi programin e rritjes së kapaciteteve duhet të komunikohet qartë gjatë konsultimeve publike.</p> <p>Optimizimi i mundësive të punësimit përmes mundësive të copëtimit të tenderit në komponentë më të vegjël për të rritur mundësinë e dhënies së punëve individuale kompanive lokale.</p> <p>Si pjesë e procesit të tenderit, kërkesa ndaj kontraktorit për zhvillimin e një strategjie blerjesh e cila përcakton se si mund të optimizohet blerja e mallrave dhe shërbimeve lokale.</p> <p>Dakordësimi me autoritetet vendore për të lajmëruar të gjitha hapjet në mënyrë që të jenë të aksesueshme për komunitetet lokale. Ofrimi i informacionit të qartë për numrin dhe aftësitë e kërkuara për mundësitë e punësimit.</p>
<p>Përdorimi/aksesi i tokës dhe burimeve natyrore dhe ndikimi në kushtet e jetesës që lidhet me përvetësimin e tokës dhe pastrimin e saj</p>	<p>Zhvillimi i konsultimeve dhe sigurimi i informacionit për të drejtat e kompensimit që do të përdorë projekti, si dhe mundësinë e paraqitjes së një ankese.</p> <p>Takimet me grupet e synuar duhet të mbahen me pronarët e tokave bujqësore, mbajtësit e të drejtave mbi tokën, dhe bujqërve në zonën e projektit, të cilët ndikohen më shumë nga projekti. Gjatë këtyre takimeve duhet të jepen të gjithë informacionet për projektin dhe të prezantohen ndikimet dhe përfitimet e mundshme si dhe, informacioni si mund të paraqitet një ankesë. Duhet të ofrohet ndihmë ligjore.</p> <p>Zbatimi i Planit të Restaurimit të Kushteve të jetesës.</p> <p>Krijimi i procedurës për përcaktimin e kushteve “origjinale” të elementëve të infrastrukturës që ndërpriten nga tubacioni ose shtrihen përgjatë gjurmës së tij, e cila përfshin dokumentimin e kushteve “origjinale” përmes fotografimit dhe rregjistrimeve video.</p> <p>Pronarët ose mbajtësit e të drejtave të tokave dhe pronave kanë të drejtë për:</p> <ul style="list-style-type: none"> - rehabilitimin e të gjitha pronave në kushtet e para-projektit dhe/ose kostove të përgjithshme për restaurimin e të gjitha pronave të dëmtuara në kushtet e para-projektit; - asistencë derisa kushtet e restauruara të jetesës të prodhojnë të ardhura të barabarta ose mbi ato të skenarit pa projekt; - kompesimin për tokat; - kompesimin për strukturat ose zhvillimet në tokë; - kompesimin për kulturat bujqësore; - kompesimin për humbjen e prodhimit bujqësor. <p>Për pronarët e tokave: Kompensimi do të jetë në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe KP 5 të BERZH.</p> <p>Vetëm për përdoruesit e tokës bujqësore: Kompensimi për çdo të mbjellë njëvjeçare në vlerësimin vjetor të kulturës nga projekti për çdo vit; për kulturat shumëvjeçare në tarifën e projektit për kulturat shumëvjeçare.</p> <p>Kompensimi në koston e zëvendësimit për pronarët e zhvillimeve për çdo zhvillim dhe përmirësim të tokës (struktura të ujitjes dhe/ose kullimit, hangare, puse etj.)</p>

Subjekti	Masat zbutëse
	<p>Toka jetime: subjekt i rishikimit rast pas rasti, toka e copëtuar nga aktivitetet e ndërtimit ose shndërruar në jo ekonomike për prodhim si rezultat i ndërtimit mund të deklarohet “tokë pa pronar” dhe bëhet e ligjshme për kompensim njësoj si më lart (qoftë përkohësisht ose gjithmonë tokë pa pronar).</p> <p>Zhvillimi i konsultimeve dhe sigurimi i informacionit për të drejtat e kompensimit që do të përdorë projekti, si dhe mundësinë e paraqitjes së një ankese.</p> <p>Takimet me grupet e synuar duhet të mbahen me pronarët e tokave bujqësore, mbajtësit e të drejtave mbi tokën, dhe bujqërve në zonën e projektit të cilët ndikohen më shumë nga projekti. Gjatë këtyre takimeve duhet të jepen të gjithë informacionet për projektin dhe të prezantohen ndikimet dhe përfitimet e mundshme si dhe, informacioni si mund të paraqitet një ankesë. Duhet të ofrohet ndihmë ligjore.</p> <p>Punëtorët e prekur kanë të drejtën e kompensimit për humbjen e përkohshme të të ardhurave.</p>
<p>Të mirat publike, shërbimet, infrastruktura përfshirë trafikun</p>	<p>Krijimi i procedurës për përcaktimin e kushteve “origjinale” të elementëve të infrastrukturës që ndërpriten nga tubacioni ose shtrihen përgjatë gjurmës së tij, e cila përfshin dokumentimin e kushteve “origjinale” përmes fotografimit dhe rregjistrimeve video. Këto rregjistrime do të përdoren si standartet përkundrejt të cilave do të vlerësohet cilësia e punimeve restauruese pasi të ketë përfunduar ndërtimi.</p> <p>Në se përdoren rrugë ekzistuese, është e nevojshme të përcaktohet dhe regjistrohet gjendja “origjinale” e rrugëve të përdorura dhe objekteve të afërt në mënyrë që të mund të justifikohen ankesat e mëvonshme të pronarit dhe të mund të identifikohen e riparohen dëmtimet e mundshme që rezultojnë nga përdorimi.</p> <p>Kryerja e një analize “Swept path” e cila është në gjendje të tregojë se itinerarët e planifikuar mund të akomodojnë lëvizjen e automjetit më të gjatë dhe të gjerë që synon të mobilizojë Kontraktori, pa dëmtuar pronat dhe objektet, veçanërisht në zona ku hapsira për manovrimin e automjeteve është e kufizuar, të tilla si kalimet nëpër fshatra ose të ngjashme me to.</p> <p>Konsultimi me pronarët/mbajtësit e të drejtave të tokës dhe infrastrukturës në afërsi të gjurmës së tubacionit përpara ndërtimit për të identifikuar nevojën për ndërprerjen nga tubacioni ose kalimin përreth infrastrukturës.</p> <p>Kryerja e ndërtimit në përputhje me procedurat e ndërtimit dhe planifikimin dhe, praktikat e mira të menaxhimit të sheshit të ndërtimit.</p> <p>Çdo objekt infrastrukturor i ndërprerë nga tubacioni ose shqetësuar gjatë ndërtimit, duhet të ruhet sa më shumë të jetë e mundur.</p> <p>Përgatitja dhe zbatimi i Planit të Infrastrukturës dhe Shërbimeve Publike.</p> <p>Përgatitja dhe zbatimi i Planit të Menaxhimit të Trafikut.</p> <p>Plani duhet të konsiderojë shmangien e të gjithë pikave të mundshme të konfliktit ndërmjet tubacionit të planifikuar dhe trafikut ekzistues dhe të përfshijë vlerësimin e detajuar të rrezikut – përfshirë mundësitë e vonesave dhe dyndjes në rrugët e aksesit.</p> <p>Autoritetet që administrojnë zonat që do të përshkojnë automjetet e projektit do të informohen në lidhje me itinerarin dhe karakteristikat e flotës së automjeteve të ndërtimit (shpeshtësia e kalimit, madhësia dhe pesha e kamionëve, materialet që transportojnë).</p> <p>Me përjashtim të kushteve të veçanta, automjetet e rënda (d.m.th. automjete me peshë më shumë se 3.5 ton) nuk do të përdorin rrugët publike gjatë natës, ndërmjet 22:00 dhe 06:00. Asnjë nga automjetet e projektit nuk do të lejohet të qarkullojë nëpër fshatra nga 20:00 deri në 08:00. Në përputhje me orarin e turneve shkollore, automjetet e rënda të projektit (d.m.th. automjete me peshë më shumë se 3.5 ton) do të ndalohen të qarkullojnë nëpër fshatra kur nxënësit shkojnë dhe kthehen nga shkolla.</p> <p>Kontraktori të pajisë çdo shofer të tij me një hartë në shkallë të përshtatshme të rrugëve të autorizuara për përdorim, ku tregohen qartë shpejtësitë maksimale të autorizuara dhe të sigurohet për mirëkuptimin e tyre.</p>
<p>Shëndeti dhe Siguria e komunitetit</p>	<p>Përgatitja dhe zbatimi i Planit të Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë së komunitetit duke adresuar të gjitha çështjet e sigurisë dhe rrezikut (përfshirë aksidentet) të identifikuar në vlerësim dhe të gjitha standartet e zbatueshme të sigurisë - plani gjithashtu përfshin vlerësimin e kapaciteteve/nevojave për paisje dhe personel spitalor.</p> <p>Përgatitja dhe zbatimi i Planit të Menaxhimit të Trafikut.</p> <p>Përgatitja dhe zbatimi i Planit të Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në vendin e punës.</p> <p>Përgatitja dhe zbatimi i Procedurës së Menaxhimit të Materialeve të Rrezikshme.</p>

Subjekti	Masat zbutëse
	<p>Përgatitja dhe zbatimi i Planit të Parandalimit dhe Veprimit ndaj Ndotjes.</p> <p>Mbajtja e konsultimeve me popullatën e ndikuar, veçanërisht grupet e cënueshme të identifikuar, ku të paraqitet qartë dhe thjeshtë i gjithë informacioni mbi ndikimet e mundshme dhe masat zbutëse. Zbulimi i informacioneve që lidhen me projektin në mënyrë që palët e interesit dhe komunitetet lokale të kuptojnë këto rreziqe dhe ndikimet e mundshme, si dhe masat e propozuara për parandalimin, zbutjen dhe reagimin ndaj emergjencave.</p> <p>Zhvillimi i fushatave të ndërgjegjësimit për higjienën publike dhe mënyrën se si mund të përhapen sëmundjet.</p> <p>Ofrimi i materialeve edukative dhe rritja e ndërgjegjësimit për të shmangur ose minimizuar transmetimin e sëmundjeve ngjitëse të cilat mund të jenë të lidhura me fluksin e punëtorëve të përkohshëm/përhershëm të projektit (për komunitetin dhe punëtorët).</p> <p>Ndihmë në përmirësimin e infrastrukturës së kujdesit ndaj shëndetit.</p> <p>Zbatimi dhe nëse është i nevojshëm, ndryshimi i Mekanizmit të Ankesave që jepet në Planin e Angazhimit të Palëve të Interesit. Informacioni për mundësinë e paraqitjes së një ankese dhe mënyrën e paraqitjes, duhet të komunikohet qartë dhe me transparencë.</p>
<p>Shëndeti dhe Siguria në vendin e punës</p>	<p>Përgatitja dhe zbatimi i Planit të Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në vendin e punës.</p> <p>Përgatitja dhe zbatimi i Procedurës së Menaxhimit të Materialeve të Rrezikshme.</p> <p>Përgatitja dhe zbatimi i Planit të Parandalimit dhe Veprimit ndaj Ndotjes.</p> <p>Punëtorët në sheshin e ndërtimit duhet të ndjekin dhe përbushin parimet e parashkruara dhe rregulloret për sigurinë në vendin e punës.</p> <p>Duhet të ofrohet një program bazik trajnimi profesional dhe, sipas nevojës, kurse të veçantë, për të siguruar që punëtorët të orientohen në rreziqet specifike të detyrave individuale të punës.</p> <p>Përmes specifikimeve të duhura në kontratë dhe monitorimit, punëdhënësi duhet të sigurohet që ofruesit e shërbimit, ashtu si edhe kontraktorët dhe nënkontraktorët e punës, janë të trajnuar në mënyrën e duhur përpara fillimit të punës.</p> <p>Bashkëpunimi dhe koordinimi me infrastrukturën lokale shëndetësore dhe të sigurisë.</p>

Subjekti	Masat zbutëse
Grupet e cënueshme	<p>Zbatimi dhe nëse është i nevojshëm, ndryshimi i Planit të Angazhimit të Palëve të Interesit.</p> <p>Kryerja e konsultimeve me njerëzit e prekur, veçanërisht përfaqësuesit e grupeve të cënueshme. Përdorimi i metodave më të mira të konsultimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gratë – takime të organizuara veçanërisht për gratë ku do të jepet i gjithë informacioni për projektin si dhe informacioni si paraqitet një ankesë. - Familjarë me të ardhura të ulta - takime të organizuara veçanërisht me përfaqësuesit e tyre ku do të jepet i gjithë informacioni për projektin, paraqiten ndikimet e mundshme dhe përfitimet si dhe informacioni si paraqitet një ankesë. - Familjarë pa të drejta ligjore mbi tokën - takime të organizuara veçanërisht me përfaqësuesit e tyre ku do të jepet i gjithë informacioni për projektin, paraqiten ndikimet e mundshme dhe përfitimet si dhe, informacioni si paraqitet një ankesë; ofrimi i ndihmës ligjore. - Romët - takime të organizuara veçanërisht me përfaqësuesit e tyre ku do të jepet i gjithë informacioni për projektin, paraqiten ndikimet e mundshme dhe përfitimet si dhe, informacioni si paraqitet një ankesë. - Fëmijët dhe të rinjtë – gjatë prezantimit publik jepet i gjithë informacioni mbi projektin që lidhet me fëmijët dhe të rinjtë, përfshirë ndikimet e mundshme dhe përfitimet si dhe, informacioni si të paraqitet një ankesë. - Të moshuarit/pensionistët – fletëpalosje të shpërndara direkt në banesat e gjithsecilit me informacion të qartë dhe të thjeshtë për t’u lexuar mbi projektin dhe ndikimet e mundshme dhe përfitimet si dhe, informacionin si të paraqitet një ankesë. Kur shpërndahen fletëpalosjet, duhet të kontrollohet aftësia e secilit prej këtyre personave për të lexuar. Nëse familja përbëhet nga persona analfabetë, informacioni i fletëpalosjes duhet të prezantohet me gojë; ofrimi i ndihmës ligjore. - Pronarët, mbajtësit e të drejtave të tokës bujqësore dhe bujqit në zonën e projektit - takime të organizuara veçanërisht me përfaqësuesit e tyre ku do të jepet i gjithë informacioni për projektin (përfshirë informacionin mbi kompensimin), paraqiten ndikimet e mundshme dhe përfitimet si dhe, informacioni si paraqitet një ankesë; ofrimi i ndihmës ligjore. <p>Zbatimi dhe nëse është i nevojshëm, ndryshimi i Mekanizmit të Ankesave që jepet në Planin e Angazhimit të Palëve të Interesit. Informacioni për mundësinë e paraqitjes së një ankese dhe mënyrën e paraqitjes, duhet të komunikohet qartë dhe me transparencë.</p> <p>Zbatimi i Planit të Restaurimit të Kushteve të jetesës.</p> <p>Maksimizimi i punësimit lokal dhe blerjes së mallrave nga furnitorët lokalë.</p> <p>Dakordësimi i Strategjisë së Punësimit me Kontraktorin kryesor. Strategjia e punësimit duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përfshijë kërkesat për punësimin e punëtorëve të pakualifikuar nga vendi dhe bashkitë që ndërpriten nga gazsjellësi; - të përshkruajë dhe kërkojë një proces të rregullt dhe transparent për të gjitha hapjet; - të përcaktojë vendet e synuara për rekrutimin e punëtorëve të pakualifikuar për secilën nga zonat e punimeve; - të inkurajojë zënien nga rezidentët e të gjitha punëve të pakualifikuara të shërbimit në kampet e punës; - të inkurajojë punësimin e individëve nga grupet e cënueshme kur kjo është e mundur. <p>Të zbatojë politikën e tolerancës zero ndaj punës së fëmijëve si dhe politikë jo diskriminuese.</p>
Trashëgimia kulturore	Zbatimi i Planit të përgatitur të Menaxhimit dhe Monitorimit të Trashëgimisë Kulturore (PMMTK).

Subjekti	Masat zbutëse
	<p>Një vrojtim /monitorim arkeologjik i pandërprerë duhet të kryhet përgjatë gjurmës së IAP gjatë punimeve të gërmimit. Kontraktori vendos kush do të jetë përgjegjës për monitorimin e gërmimeve në të gjitha zonat me qëllim që të përcaktohet kush duhet të trajnohet dhe dokumentojë këtë masë.</p> <p>Procedura e gjetjeve rastësore duhet të përgatitet, zbatohet dhe komunikohet me të gjithë personelin e ndërtimit në zonat e ndërtimit. Procedura përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> - organizimi i arkeologovë në gatishmëri përpara se të kontraktohen për trajtimin e një gjetjeje arkeologjike nëse ndodh gjetje rastësore; - monitorimi i aktiviteteve ndërtimore nga një profesionist; - ndërprerja e punës në afërsi të çdo zbulimi të ri arkeologjik dhe konsultimi me autoritetet përkatëse; - përcaktimi i periudhës së njoftimit të institucioneve përkatëse të autorizuar (lokale dhe shtetërore); - raportimi i kërkesave për gjetjet rastësore. <p>Çdo gjetje rastësore nuk do të preket derisa një specialist i kualifikuar dhe çertifikuar të bëjë vlerësimin. Zona e zbulimit të gjetjes rastësore do të shenjohe në mënyrën e duhur (d.m.th. me një rrethim plastic me ngjyrë të kuqe me shikueshmëri të lartë, në distancë minimale prej 50 m).</p> <p>Në se kërkohet shpëtimi i një gjetje rastësore arkeologjike, shpëtimi do të kryhet në përputhje me standartet shqiptare dhe ndërkombëtare dhe me mbikqyrje dhe përfshirje të institucioneve shtetërore përkatëse.</p> <p>Puna do të rifillojë vetëm pas lejes zyrtare të dhënë nga instituti përkatës i autorizuar (Instituti i Monumenteve të Kulturës).</p> <p>Në rastin e zbulimit të dëshmive të veprimtarisë njerëzore gjatë lëvizjes së dherave:</p> <ul style="list-style-type: none"> - varreza humane, - municione dhe predha të pashpërthyer, - gropa të varrosjes së kafshëve të sëmura, <p>duhet të raportohet tek autoritetet civile.</p> <p>Në afërsi të memorialit (në distancë 100 m nga progresiva 11+800) dhe Kishës së Shën Mëhillit (në distancë 100 m nga progresiva 133+900): është e nevojshme të zbatohet teknika të minimizimit të dridhjeve dhe teknika ndërtimi me ndikim të ulët. Në rastet kur një pjesë ose i gjithë objekti i trashëgimisë kulturore dëmtohet për shkak të dridhjeve të tepërta, duhet të thërriten menjëherë specialistët e ruajtjes së ndërtesave për riparimin e strukturës.</p> <p>Duke qenë se disa lloje ndotjesh mund të dëmtojnë arkitekturën e gurit, nevojitet të kryhet një vlerësim i strukturës për memorialin (në distancë 100 m nga progresiva 11+800) dhe Kishën e Shën Mëhillit (në distancë 100 m nga progresiva 133+900). Vlerësimi do të tregojë rrezikun e ndikimeve nga ndotja për këto dy zona dhe propozojë masa mbrojtëse ndaj ndikimeve të mundshme.</p> <p>Në rast se aksesit në një zonë të rëndësishme të trashëgimisë kulturore është i kufizuar ose bllokuar, duhet të sigurohen rrugë alternative aksesit, duke përdorur të dhënat nga palët e interesit dhe duke njoftuar publikun për bllokimin dhe mënyrat alternative të aksesit.</p>
<p>› Faza e funksionimit</p>	
<p>Përdorimi/aksesi i tokës dhe burimeve natyrore dhe ndikimi në kushtet e jetesës që lidhet me përvetësimin e tokës dhe pastrimin e saj</p>	<p>Me komunitetet përgjatë gjurmës së IAP do të zhvillohen fushata informative për t'u siguruar që në zonën e sigurisë 30+30 m nuk janë planifikuar të ndërtohen apo ndërtuar godina dhe për zonën prioritare të sigurisë zbatohen kufizimet.</p> <p>Me qëllim që të sigurohet se pronarët e ullishtave, si dhe pronarët e mundshëm të pemishteve, e dinë saktësisht që në zonën 5+5 m (zona prioritare e sigurisë së gazsjellësit) nuk lejohet mbjellja e drurëve, pas shtrimit të tubacionit dhe mbushjes së kanalit, tubacioni do të shenjohe në këtë shtrirje duke vendosur shufra shënjuese çdo 50 m.</p> <p>Pronarët ose mbajtësit e të drejtave të tokave dhe pronave kanë të drejtë për:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kompensimin për kufizimet e detyrueshme në zonën prioritare të sigurisë; - kompensimin për kufizimet e detyrueshme në zonën e sigurisë;

Subjekti	Masat zbutëse
	<p>- kompensimin në vlerën e zëvendësimit për strukturat ose zhvillimet në tokë. Në rastin e përvetësimit të tokës për instalimet kompensimi i tokës do të bëhet si më poshtë: Për pronarët e tokës: Kompensimi për tokën në tarifën e përvetësimit të tokës nga projekti. Për përdoruesit e tokës bujqësore: Kompensimi për çdo kulturë të përhershme bujqësore në vlerësimin vjetor të kulturës nga projekti për çdo vit; për kulturat shumëvjeçare në tarifën e projektit për kulturat shumëvjeçare. Kompensimi në koston e zëvendësimit për pronarët e zhvillimeve për çdo zhvillim dhe përmirësim të tokës (struktura të ujitjes dhe/ose kullimit, hangare, puse etj.) Në rastin e kompensimit për të drejtën e përdorimit publik në lidhje me kufizimet afatgjata operationale në zonat e kufizimeve (5+5 dhe 30+30) në tarifën e kufizimeve të tokës nga projekti (llogaritur si përqindje e tarifës së përvetësimit të tokës nga projekti). Parimet e sugjeruara të kompensimit: Në mjedis urban: 90% e vlerës së tokës Toka bujqësore: 50% e vlerës së tokës Kullota: 25% e vlerës së tokës Pyje: 100% e vlerës së tokës.</p>
Shëndeti dhe Siguria e komunitetit	<p>Zbatimi i Planit të Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë së komunitetit. <i>Masat listohen tek situatat aksidentale.</i></p>
Shëndeti dhe Siguria në vendin e punës	<p>Zbatimi i Planit të Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në vendin e punës. Zbatimi i Procedurës së Menaxhimit të Materialeve të Rrezikshme. Zbatimi i Planit të Parandalimit dhe Veprimit ndaj Ndotjes. Punëtorët e operationeve të mirëmbajtjes duhet të ndjekin dhe përbushin parimet e parashkruara dhe rregulloret për sigurinë në vendin e punës. Duhet të ofrohet një program bazik trajnimi profesional dhe, sipas nevojës, kurse të veçantë, për të siguruar që punëtorët të orientohen në rreziqet specifike të detyrave individuale të punës. Përmes specifikimeve të duhura në kontratë dhe monitorimit, punëdhënësi duhet të sigurohet që ofruesit e shërbimit, ashtu si edhe kontraktorët dhe nënkontraktorët e punës, janë të trajnuar në mënyrën e duhur përpara fillimit të punës.</p>
Trashëgimia kulturore	<p>Zbatimi i Planit të përgatitjes të Menaxhimit dhe Monitorimit të Trashëgimisë Kulturore (PMMTK). Mbjellja dhe mirëmbajtja e brezit të gjelbërt përreth instalimeve.</p>
Aksidentet madhore me pasoja në mjedis dhe ngjarjet e paplanifikuara	
› Faza ndërtimore	
Situatat aksidentale	<p>Përgatitja dhe zbatimi i Planit të Reagimit ndaj Emergjencave në konsultim me autoritetet përkatëse, shërbimit të emergjencave/mbrojtjes civile dhe administratat e bashkive përgjatë gjurmës së gazsjellësit. Sigurimi i paisjeve të duhura për shuarjen e zjarrit.</p> <p>Përgatitja dhe zbatimi i Planit të Reagimit ndaj Emergjencave në konsultim me autoritetet përkatëse, shërbimit të emergjencave/mbrojtjes civile dhe administratat e bashkive përgjatë gjurmës së gazsjellësit.</p> <p>Përgatitja dhe zbatimi i Planit të Parandalimit dhe Veprimit ndaj Ndotjes.</p>

Subjekti	Masat zbutëse
	<p>Sigurimi i materialeve të përshtatshme thithëse për mbledhjen e derdhjeve të fluidëve dhe lëngjeve (produkte hidrokarbure, kimikate etj.) në afërsi të zonave të furnizimit dhe ruajtjes së karburanteve, parkimit të makinerive të rënda dhe kamionëve dhe, shesheve të ndërtimit.</p> <p>Do të ofrohen trajnime periodike në mënyrë që kontraktorët përfshirë nënkontraktorët të kenë një ide të përgjithshme të planit të reagimit.</p>
<p>› Faza e funksionimit</p>	
<p>Situatat aksidentale</p>	<p>Zbatimi i Planit të Reagimit ndaj Emergjencave.</p> <p>Besueshmëria e funksionimit të tubacionit duhet të ruhet përmes procedurave të mirëmbajtjes dhe monitorimit në përputhje me kodet e njohura të praktikës.</p> <p>Zbatimi i një sistemi të brendshëm alarmi për rrjedhjet që raporton në kohë dhe mënyrën e duhur rrjedhjet aksidentale mund të ndihmojë në sigurimin e reagimit të shpejtë dhe eficient. Një sistem/plan alarmi duhet të përfshijë në mënyrë të qartë dhe detajuar informacionin për burimet dhe vendodhjen e rreziqeve të tillë.</p> <p>Zbatimi i Planit të Reagimit ndaj Emergjencave dhe Planit të Parandalimit dhe Veprimit ndaj Ndotjes.</p>
<p>› Faza e nxjerrjes jashtë funksionimi</p>	
<p>Përpara çdo operacioni për nxjerrjen jashtë funksionimi të tubacionit, do të hartohet një plan i braktisjes së tubacionit (PBT). Ky PBT do t'i dorëzohet autoriteteve lokale në kohën e duhur përpara përfundimit të kohëzgjatjes së funksionimit të tubacionit. PBT do të përfshijë gjithashtu një vlerësim të ndikimeve në mjedis të masave të propozuara për nxjerrjen nga përdorimi. Ndikimet padyshim do të varen nga qasja e nxjerrjes nga përdorimi dhe teknikat e disponueshme të çmontimit në kohën që do të kryhet.</p> <p>Pritet që pajisjet në instalimet sipërfaqësore të çmontohen, transportohen dhe asgjeshohen në mënyrën e duhur.</p> <p>Praktika më e mirë ndërkombëtare është ajo e lënies së tubacionit në tokë (braktisja në vend) dhe sigurimi i tij ndaj shembjeve strukturore që do të shkaktonin rrëshqitje të tokës. Në këtë rast ndikimet në mjedis, përdorimin e tokës dhe infrastrukturë do të ishin minimale.</p> <p>Varianti tjetër është heqja e tubacionit (çgroposja). Tubacioni do të inertizohet, çmontohej dhe pritej, kanali do të mbushet përsëri dhe toka kthehet në gjendjen e saj fillestare.</p> <p>Në rast se heqja plotësisht e tubacioni do të zgjidhet si variant i çmontimit, ndikimet e pritshme në mjedis do të jenë të ngjashme me ato të fazës së ndërtimit.</p>	

8.2 Ndikimet mbetëse

Ndikimet mbetëse nënkuptojnë ato efekte mjedisore që pritet të mbeten pas zbatimit të masave zbutëse të parashikuara. Efektet mbetëse të pritshme janë marrë në shqyrtim për çdo fazë të projektit (para-ndërtimore, ndërtimore, të funksionimit) në lidhje me ndikimet e identifikuar.

Nëpërmjet zbatimit të masave mbrojtëse, efektet negative të aktiviteteve të projektit zbuten dhe aspektet mjedisore dhe sociale rezultojnë me ndikime të një rëndësie më të vogël për:

- Faza para-ndërtimore – aspektet sociale dhe të shëndetit: shqetësimet e komunitetit – perceptimi negativ për IAP dhe ndikimet e tij;
- Faza ndërtimore – për ndikimet në ujëra, tokë, tokën bujqësore, biodiversitet, pyje, zona të mbrojtura, sociale dhe në shëndet (shqetësim i përkohshëm i jetës së përditshme, të mirat publike, shërbimet, infrastrukturë përfshirë trafikun);
- Fazën e funksionimit – biodiversiteti, zonat e mbrojtura, sociale dhe në shëndet (përdorimi/aksesi i tokës dhe burimeve natyrore dhe ndikimi në kushtet e jetesës që lidhet me përvetësimin e tokës dhe pastrimin e saj).

Rezultatet e vlerësimit janë treguar në tabelën e mëposhtme.

Subjekti	Ndikimet	Mundësia e zbatjes së ndikimeve	Vlerësimi i ndikimit – përpara masave						Masat zbutëse	Vlerësimi i ndikimit – pas masave								
			SHKALLA	SHH&K	NDJESHMËRIA MJEDISORE	EFEKTI	MUNDËSIA QË TË NGJASE	SHUMATORE		SHKALLA	SHH&K	NDJESHMËRIA	EFEKTI	MUNDËSIA QË TË	SHUMATORE			
Mjedisi fizik																		
> Faza ndërtimore																		
Ujërat	Ndotja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore	Ndikimi mund të parandalohet/shmanget.	3	1	2	6	2	8	Përgatitja dhe zbatimi i Planit të Menaxhimit të Ujit. Përgatitja dhe zbatimi i Planit të Parandalimit dhe Veprimit ndaj Ndotjes. Vendosja e një numri të mjaftueshëm kontenierësh sanitarë dhe tualetesh kimike (përafërsisht 2 tualete për çdo 20 punëtorë), të sigurohet shkarkimi i tyre nga kompani e licencuar. Magazinimi i materialeve dhe likuidëve të rrezikshëm për ujërat të kufizohet në zonat e caktuara të padepërtueshme të ruajtjes, me rrethim dhe tabaka për derdhjet (depozitat mbajtëse), të cilat duhet të vendosen së paku 100 m larg çdo rrjedhe ujore dhe zone të përmytjes (seksionet 0+000 – 11+600, 19+200 – 43+500, 52+000 – 56+750, 56+750 – 65+670, 67+000 – 68+000, 69+190 – 82+090, 90+000 – 130+700, 130+700 – 139+000, 140+200 – 141+670, 142+590 – 170+300 të IAP).	1	1	1	3	2	5			

Subjekti	Ndikimet	Mundësia e zbutjes së ndikimeve	Vlerësimi i ndikimit – përpara masave						Masat zbutëse	Vlerësimi i ndikimit – pas masave					
			SHKALLA	SHH&K	NDJESHMËRIA MËDISORE	EFEKTI	MUNDËSIA QË TË NGJASE	SHUMATORE		SHKALLA	SHH&K	NDJESHMËRIA	EFEKTI	MUNDËSIA QË TË	SHUMATORE
									Furnizimi me karburant i automjeteve dhe makinerive nga depozitat duhet të kryhet nën udhëzimet e ekspertit, në zona të papërshkueshme nga uji, të cilat duhet të jenë të pajisura me substanca neutralizuese për derdhjet e mundshme të karburanteve dhe lubrifikantëve. <i>Masat e listuara tek situatat aksidentale.</i>						
	Grumbujt e sedimenteve	Ndikimi do të zbutet/zvogëlohet përmes zbatimit të masave.	1	1	2	4	4	8	Përgatitja dhe zbatimi i Planit të Kontrollit të Erozionit dhe Sedimentimit. Përgatitja dhe zbatimi i Planit të Kalimit të Rrjedhave Ujore. Punimet e ndërtimit në rrjedhat ujore (metoda me prerje të hapur) të kryhen gjatë stinës së thatë/sezoni me prurje të vogël (Qershor-Shtator). Të kontrollohet parashikimi i motit për 3-4 ditët në vijim për të identifikuar ndonjë rritje të mundshme të prurjes. Kalimet të mos bëhen nëse pritet prurje të larta. Të ndalohej kalimi i automjeteve përmes rrjedhave ujore. Të zbatohen punimet e rehabilitimit në kryqëzimet e rrjedhave ujore. Shtegu i rrjedhjes së ujit nuk duhet të bllokohet ose devijohet përgjithmonë. Minimizimi i transportit të sedimenteve në rrjedhat ujore përmes ndërtimit të pritave prej balte (ose të ngjashme) në rrjedhën e poshtme, pranë kryqëzimit me tubacionin, kur përdoret prerja e hapur.	1	1	1	3	2	5
	Shpëlarja/Derdhja e lëngjeve të shpimit	Ndikimi i shkarkimit jo të rregullt të baltës së shpimit të përdorur mund të parandalohet/shmanget.	2	1	2	5	3	8	Përgatitja dhe zbatimi i Planit të Kalimit të Rrjedhave Ujore. Përdorimi i baltës së shpimit vetëm me bazë uji. Materialet që shtohen në baltën e shpimit (aditivët) duhet të jenë kimikisht inerte, të biodegradueshme, jo toksike, ndërsa detergjentët me bazë naftë ose larësit nuk duhet të përdoren. Balta e shpimit e përdorur duhet të menaxhohet në mënyrën e duhur dhe në asnjë rast nuk duhet shkarkuar në rrjedhat ujore ose ujërat nëntokësorë.	1	1	1	3	1	4
	Zvogëlimi i mundshëm i prurjes dhe nivelit të ujit, krijimi i grumbujve të	Ndikimi do të zbutet/zvogëlohet përmes zbatimit të masave.	1	1	1	3	4	7	Përgatitja dhe zbatimi i Planit të Menaxhimit të Hidrotestimit. Sasia e ujit të nxjerrë nga lumenjtë për hidrotestim nuk duhet të kapërcejë 10% të prurjes ose volumit të rrjedhës ujore. Kur është teknikisht e mundur, i njëjti ujë i hidrotestimit të përdoret për disa teste.	1	1	1	3	2	5

Subjekti	Ndikimet	Mundësia e zbutjes së ndikimeve	Vlerësimi i ndikimit – përpara masave						Masat zbutëse	Vlerësimi i ndikimit – pas masave					
			SHKALLA	SHH&K	NDJESHMËRIA MJEDISORE	EFEKTI	MUNDËSIA QË TË NGJASE	SHUMATORE		SHKALLA	SHH&K	NDJESHMËRIA	EFEKTI	MUNDËSIA QË TË	SHUMATORE
	vegjël me sedimente që mund të ndodhë gjatë shkarkimit							Uji i përdorur për hidrotestim duhet të jetë pa substanca shtesë. Nëse cilësia e ujit të përdorur për hidrotestim nuk i plotëson kriteret lokale për rrjedhat ujore, ai duhet trajtuar përpara shkarkimit në mjedis. Kur uji i përdor për hidrotestim shkarkohet në një rrjedhë ujore, për rrjedhën e shkarkimit duhet të përdoren shpërndarës të energjisë.							
	Tërheqje (pakësim) e lokalizuar e ujërave nëntokësorë (ndikim i ulët) dhe dëmtim pusi	Dëmtimi i puseve mund të parandalohet.	1	1	1	3	2	5	Për mbrojtjen e puseve/kaptazheve të burimeve të ujit në zonat direkt pranë gjurmës së IAP (afërsisht progresivat 52+480, 117+440 dhe të tjera që mund të jenë pranë gjurmës së tubacionit) duhet të kryhet një ri-pozicionim i vogël i rrugës me qëllim shmangien tërësisht të burimit ujqor, së paku në 20 m distancë.	-	-	-	-	-	-
Gjeorreziqet	Dëmtim i makinerive të ndërtimit dhe ndotje e ujërave	Ndikimi mund të zbutet për vetë tubacionin IAP dhe mund të shmanget për objektet sipërfaqësore.	2	1	1	4	2	6	Në zonat e prirura ndaj përmytjeve me ngjarje të përvitshme përmytjesh (zonat direkt pranë lumenjve: Bunë, Mat, Drin, Ishëm, Erzen, Shkumbin, Semani) punimet e ndërtimit duhet të kryhen gjatë muajve të verës, nga qershori në shtator, kur prurjet ka të ngjarë të jenë të pakta. Të kontrollohet parashikimi i motit për 3-4 ditët në vijim për të identifikuar mdonjë rritje të mundshme të prurjes. Kalimet të mos bëhen nëse pritet prurje të larta. Sigurimi i rrugës së lirë për evakuim emergjent nga zona e punimeve në shtretërit e rrjedhave ujore për kalimet e tyre në rast të ngjarjeve me rrjedha të mëdha të rrëmbyera. Për objektet sipërfaqësore të parashikuara në zona të prirura ndaj përmytjeve (CTMS Fier, BVS Rrogozhinë, PTS/BVS/PRMS Mamurras, BVS Milot, BVS Balldren dhe CTMS Bushat) duhet të kryhet studim i veçantë hidrologjik për të përcaktuar mundësinë e përmytjes së çdo zone dhe masat zbutëse si argjinaturat ose zhvendosja e objekteve sipërfaqësore në zona të sigurta ndaj përmytjeve.	1	1	1	3	1	4

Subjekti	Ndikimet	Mundësia e zbutjes së ndikimeve	Vlerësimi i ndikimit – përpara masave						Masat zbutëse	Vlerësimi i ndikimit – pas masave					
			SHKALLA	SHH&K	NDJESHMËRIA MËDISORE	EFEKTI	MUNDËSIA QË TË NGJASE	SHUMATORE		SHKALLA	SHH&K	NDJESHMËRIA	EFEKTI	MUNDËSIA QË TË	SHUMATORE
	Siguria, dëmtim i makinerive të ndërtimit	Ndikimi mund të zbutet ose shmangët.	2	1	1	4	2	6	Për seksionet e IAP ndërmjet progresivave afërsisht 52+000 deri në 66+000 dhe nga progresiva 69+000 deri në 81+500 të kryhet hartografimi gjeologjik inxhinierik dhe hulumtime gjeoteknike me qëllim që të identifikohen shpatet e rrezikshëm përgjatë gjurmës dhe parashikohen masat zbutëse/rehabilituese të shmangen shpatet e paqëndrueshëm përmes ri-pozicionimit të gjurmës.	1	1	1	3	1	4
Gjeomorfologjia	Ndryshime të vogla në format gjeomorfologjike	Masat zbutëse nuk janë të zbatueshme.	1	1	2	4	2	6	-	1	1	2	4	2	6
	Erozion i mundshëm i tokës	Ndikimi do të zbutet/zvogëlohet – rehabilitim duke mbjellë bar.	2	1	2	5	2	7	Në zonat kodrinore ndërmjet progresivave 52+000–81+000, 130+400–140+100 dhe 141+800-142+600, për shkak të rrezikut të erozionit, rehabilitimi është i nevojshëm menjëherë pas përfundimit të punimeve të ndërtimit për tubacionin dhe rrugët e aksesit. Zona e kanalit duhet të rehabilitohet përmes mbjelljes me bar. Dherat sipërfaqësorë të hequr nga zonat e prekura duhet të përdoren për rehabilitim përveç nëse miratohet ndryshe. Zonat e prekura duhet të stabilizohen.	1	1	2	4	2	6
	Ndryshime në karakteristikat gjeomorfologjike lokale.	Masat zbutëse nuk janë të zbatueshme.	1	1	2	4	2	6	-	1	1	2	4	2	6
	Erozion i mundshëm i tokës	Ndikimi do të zbutet/zvogëlohet – rehabilitim duke mbjellë bar.	2	1	2	5	2	7	Përgatitja dhe zbatimi i Planit të Kontrollit të Erozionit dhe Sedimentimit. Në zonat kodrinore ndërmjet progresivave 52+000–81+000, 130+400–140+100 dhe 141+800-142+600, për shkak të rrezikut të erozionit, rehabilitimi është i nevojshëm menjëherë pas përfundimit të punimeve të ndërtimit për tubacionin dhe rrugët e aksesit. Zona e kanalit duhet të rehabilitohet përmes mbjelljes me bar.	1	1	2	4	2	6

Subjekti	Ndikimet	Mundësia e zbutjes së ndikimeve	Vlerësimi i ndikimit – përpara masave						Masat zbutëse	Vlerësimi i ndikimit – pas masave					
			SHKALLA	SHH&K	NDJESHMËRIA MËDISORE	EFEKTI	MUNDËSIA QË TË NGJASE	SHUMATORE		SHKALLA	SHH&K	NDJESHMËRIA	EFEKTI	MUNDËSIA QË TË	SHUMATORE
Toka	Zvogëlim i prodhimitarisë së tokës dhe përkeqësim i karakteristikave dhe tipareve të saj	Ndikimi do të zbutet/zvogëlohet përmes zbatimit të masave.	2	1	1	4	4	8	<p>Përgatitja dhe zbatimi i Planit të Rehabilitimit dhe Restaurimit.</p> <p>Ruajtja e përkohshme në mënyrën e duhur të dherave vegjetalë dhe të tjerë të hequr.</p> <p>Grumbujt e dherave tipikisht nuk do të jenë më të lartë se 2 m për të parandaluar degradimin e tokës dhe për ta mbajtur të pasqetësuar nga dëmtimet e mundshme fizike si dëmtimi dhe ngjeshja.</p> <p>Do të mbahen shënime në lidhje me gjendjen ekzistuese të zonës së ndërtimit. Këto shënime do të përdoren si standartet përkundrejt të cilave do të vlerësohet cilësia e punimeve të rehabilitimit pasi të kenë përfunduar punimet e ndërtimit.</p> <p>Ruajtja dhe ripërdorimi i shtresës sipërfaqësore të tokës për punimet e rehabilitimit pas ndërtimit.</p> <p>Asnjë makineri nuk do të lejohet të dalë jashtë brezit të punimeve ose rrugëve të aksesit.</p> <p>I gjithë materiali i tepërt duhet të largohet nga zona e ndërtimit dhe të përdoret diku tjetër për punime të tjera ndërtimi ose rehabilitimi.</p> <p>Plugimi i thellë (shkrifërimi i shtresave rrënjësore) do të zbatohet si në zonat e ndërtimit ashtu edhe në ato të instalimeve të përkohshme (të tilla si kantjeret e tubave dhe kampet) pas ndërtimit dhe gjatë rehabilitimit.</p> <p>Plugimi i thellë do të kryhet përgjatë gjithë brezit të punimeve atje ku kushtet topografike e lejojnë, në një thellësi afërsisht 60 m.</p>	1	1	1	3	4	7
	Erozion i mundshëm i tokës.	Rreziku i rrëshqitjeve mund të reduktohet/zbutet.	1	1	1	3	2	5	<p>Përgatitja dhe zbatimi i Planit të Kontrollit të Erozionit dhe Sedimentimit.</p> <p>Brezi i të drejtës së kalimit (EdK) duhet të rikthehet në gjendjen fillestare në një mënyrë që minimizon erozionin e tokës dhe ri-vegjetacionin mund të vazhdojë pas punimeve të ndërtimit duke zbatuar një set masash mbrojtëse ndaj erozionit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - konturimi i sipërfaqes, - në seksionet ku pjerrësia gjatësore e tubacionit është më e madhe se 20%: përforcimi i shkëmbit, gabione etj. - gjelbërimi i shpateve dhe mbjellja e barërave dhe shkurreve të përziera në terrenet e pjerrët, - përdorimi i shtrojeve me fibra, kashtë e përzier me baltë, boudins etj. 	1	1	1	3	1	4

Subjekti	Ndikimet	Mundësia e zbutjes së ndikimeve	Vlerësimi i ndikimit – përpara masave						Masat zbutëse	Vlerësimi i ndikimit – pas masave					
			SHKALLA	SHH&K	NDJESHMËRIA MJEDISORE	EFEKTI	MUNDËSIA QË TË NGJASE	SHUMATORE		SHKALLA	SHH&K	NDJESHMËRIA	EFEKTI	MUNDËSIA QË TË	SHUMATORE
	Ndotje e tokës	Ndikimi mund të parandalohet/shmanget por mbetet mundësia që të ndodhë dhe mund të shkaktojë ndotje.	3	1	2	6	1	7	<p>Ri-mbjellja, nëse ndodh, duhet të kryhet me bimësi të vendit (përzjerje barërash dhe shkurresh).</p> <p>Pas sezonit të parë dhe të dytë të mbirjes duhet të kryhen inspektime të vazhdueshme në të gjithë zonat e prekura për të përcaktuar suksesin e rimbjelljes.</p> <p>Përgatitja dhe zbatimi i Planit të Parandalimit dhe Veprimit ndaj Ndotjes.</p> <p>Vendosja e një numri të mjaftueshëm kontenierësh sanitarë dhe tualetesh kimike (përafërsisht 2 tualete për çdo 20 punëtorë), të sigurohet shkarkimi i tyre nga kompani e licencuar.</p> <p>Magazinimi i materialeve dhe likuidëve të rrezikshëm për ujërat të kufizohet në zonat e caktuara të padepërtueshme të ruajtjes, me rrethim dhe tabaka për derdhjet (depozitat mbajtëse), të cilat duhet të vendosen së paku 100 m larg çdo rrjedhe ujore.</p> <p>Furnizimi me karburant i automjeteve dhe makinerive nga depozitat duhet të kryhet sipas udhëzimeve të ekspertit në zona të papërshtueshme nga uji, të cilat duhet të jenë të pajisura me substanca neutralizuese për derdhjet e mundshme të karburanteve dhe lubrifikantëve.</p> <p><i>Masat e listuara për situatat aksidentale.</i></p>	1	1	1	3	1	4
Toka bujqësore	Humbje e përkohshme e tokës bujqësore	Ndikimi do të zbutet/zvogëlohet përmes zbatimit të masave.	2	1	1	4	4	8	<p>Përgatitja dhe zbatimi i Planit të Rehabilitimit dhe Restaurimit.</p> <p>Shmangia e tokave të punuara gjatë përzgjedhjes së zonave për vendosjen e kampeve të punës.</p> <p>Inspektimi i gjurmës së IAP nga agronomi për të regjistruar bimët me rrënjë më të thella se 1 m që kërkojnë trajtim të tokës më thellë se 0.5 m (pemët frutore, ullinjtë, arrorët etj.) në të gjithë brezin e punimeve (20 m) përgjatë gjurmës.</p> <p>Agronomi duhet të zbulojë drurë ulliri me të vjetër se 100 vjeçarë, që gjenden brenda brezit të punimeve (20 m). Nëse gjenden të tilla, gjurma e IAP duhet të rregullohet në mënyrë që të shmangen këta drurë.</p> <p><i>Masat që listohet tek Tokat.</i></p>	1	1	1	3	4	7

Subjekti	Ndikimet	Mundësia e zbutjes së ndikimeve	Vlerësimi i ndikimit – përpara masave					SHUMATORE	Masat zbutëse	Vlerësimi i ndikimit – pas masave					SHUMATORE
			SHKALLA	SHH&K	NDJESHMËRIA MJEDISORE	EFEKTI	MUNDËSIA QË TË NGJASE			SHKALLA	SHH&K	NDJESHMËRIA	EFEKTI	MUNDËSIA QË TË	
Pejsazhi	Heqje e vegjetacionit të lartë	Ndikimi do të zbutet/zvogëlohet përmes zbatimit të masave.	1	2	2	5	2	7	<p>Përgatitja dhe zbatimi i Planit të Rehabilitimit dhe Restaurimit /Plani i Menaxhimit të Pejsazhit.</p> <p>Plani duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë zonave ndërmjet progresivave 81+000 dhe 130+500–140+200. Plani duhet të adresojë zbutjen e ndikimeve negative hapsinore dhe vizuale dhe prerjes së vegjetacionit të pyjeve dhe makieve.</p> <p>Vegjetacioni që duhet të ruhet (ngjitur me zonën e ndërtimit të IAP) do të mbrohet duke vendosur gardh mbrojtës për gjithë kohëzgjatjen e punimeve.</p> <p>Pejsazhi duhet të rivendoset pas përfundimit të punimeve të ndërtimit. Në përfundim të fazës ndërtimore shtresa e dherave vegjetalë duhet të rivendoset dhe duhet të kryhet rimbjellja e kulturave bujqësore ose kullotës.</p> <p>Ndërmjet progresivave 52+000–81+000 dhe 130+500–140+200: rehabilitimi i pejsazhit në zonat ku gjurma e gazjellësit shtrihet në mjedis shkëmbor duhet të bëhet përmes mulçirimit me copëza guri nga shkëmbinjtë lokalë të pranishëm.</p> <p><i>Masat e listuara tek Biodiversiteti dhe habitatet dhe Pyjet në lidhje me rehabilitimin biologjik.</i></p>	1	1	2	4	2	6
	Heqje e vegjetacionit të lartë	Përdorimi i rrugëve dhe shtigjeve ekzistuese.	1	2	2	5	2	7	Në zonat e pejsazhit kodrinor me mbulesë natyrore të sipërfaqes, në një zonë buferike prej 5 km nga progresivat 52+000–81+000 dhe 130+500–140+200: përdorimi sa më shumë të jetë e mundur si rrugë aksesi i rrugëve ekzistuese rurale dhe rrugëve pyjore.	1	1	2	4	2	6
	Heqje e vegjetacionit të lartë	Ndikimi do të zbutet/zvogëlohet përmes zbatimit të masave of measures.	1	1	1	3	2	5	<p>Përgatitja dhe zbatimi i Planit të Rehabilitimit dhe Restaurimit /Plani i Menaxhimit të Pejsazhit.</p> <p>Shmangia sa më shumë të jetë e mundur e prerjes së drurëve gjatë ndërtimit të kantjereve të tubave dhe kampeve të punës dhe integrimi i tyre në projektin e zonës.</p>	1	1	1	3	1	4
	Ndikim pamor	Masat zbutëse nuk janë të zbatueshme.	1	1	2	4	2	6	-	1	1	2	4	2	6
› Faza e funksionimit															

Subjekti	Ndikimet	Mundësia e zbutjes së ndikimeve	Vlerësimi i ndikimit – përpara masave						Masat zbutëse	Vlerësimi i ndikimit – pas masave					
			SHKALLA	SHH&K	NDJESHMËRIA MJEDISORE	EFEKTI	MUNDËSIA QË TË NGJASE	SHUMATORE		SHKALLA	SHH&K	NDJESHMËRIA	EFEKTI	MUNDËSIA QË TË	SHUMATORE
Toka	Zvogëlim lokal i prodhimit të tokës	Në tokat që me gjasë do të përdoren për prodhim bujqësor, cilësia e tokës do të përmirësohet përmes zbatimit të masave agroteknike. Masa të tjera zbutëse nuk janë të zbatueshme.	1	1	1	3	4	7	-	1	1	1	3	4	7
Toka bujqësore	Humbje e tokës bujqësore	Masat zbutëse nuk janë të zbatueshme.	1	2	1	4	4	8	-	1	2	1	4	4	8
	Kufizime të prodhimit për kulturat bujqësore me rrënjë që rriten më thellë se 1 m ose të cilat kërkojnë trajtim të tokës më thellë se bujqësor for 0.5 m	Masat zbutëse nuk janë të zbatueshme për shkak të kufizimeve që zbatohen në zonën e mbrojtjes së tubacionit.	1	3	1	5	4	9	-	1	3	1	5	4	9
	Kufizime të prodhimit bujqësor në zonat e ullishteve dhe pemëve frutore të ngjashme.	Përveç masës për shënjim të zonës 5 m + 5 m nga boshti i tubacionit (zona e sigurisë së tubacionit), masat e tjera nuk janë të zbatueshme për shkak të kufizimeve në zonën e mbrojtjes së tubacionit.	1	3	1	5	4	9	Me qëllim që pronarët e ullishteve dhe pemëve të tjera frutore të ngjashme, kulturave bujqësore dhe fidanishteve, të dinë saktësisht zonën prej 5+5 m në të cilën nuk lejohet mbjellja e pemëve pas shtrimit të tubacionit dhe mbushjes së kanalit, tubacioni do të shenjohej në këtë shtrirje duke vendosur shufra shënjuese çdo 50 m, progresivat: 120+300 - 120+800 dhe 124+200 – 124+600, 133+000-134+000, 134+000 - 135+000, 167+000 – 170+000 m.	1	3	1	5	4	9
Pejsazhi	Ndikime pamore dhe ndryshim i karakterit të pejsazhit	Ndikimi do të zbutet/zvogëlohet përmes zbatimit të masave.	1	2	1	4	4	8	Përreth instalimeve të mbillet dhe mirëmbahet brezi i gjelbër.	1	2	1	4	1	5

Subjekti	Ndikimet	Mundësia e zbutjes së ndikimeve	Vlerësimi i ndikimit – përpara masave						Masat zbutëse	Vlerësimi i ndikimit – pas masave					
			SHKALLA	SHH&K	NDJESHMËRIA MJEDISORE	EFEKTI	MUNDËSIA QË TË NGJASE	SHUMATORE		SHKALLA	SHH&K	NDJESHMËRIA	EFEKTI	MUNDËSIA QË TË	SHUMATORE
	Ndotja nga ndriçimi	Ndikimi do të zbutet/zvogëlohet përmes zbatimit të masave.	2	3	1	6	3	9	Përdorimi i ndriçimit miqësor me mjedisin me një llambë që ndriçon direkt në tokë ose objekt dhe shpërhapje minimale në drejtimet e tjera.	1	2	1	4	3	7
	Ndryshim i karakterit të pejsazhit dhe pengesë ndaj vazhdimësisë natyrore të terreneve jo-bujësore.	Masat zbutëse nuk janë të zbatueshme.	2	1	1	4	3	7	-	2	1	1	4	3	7
Biodiversiteti dhe habitatet															
› Faza ndërtimore															
Biodiversiteti															
	Dëmtimi ose heqja e mbulesës vegetative dhe tokës (shumë e lokalizuar)	Ndikimi do të zbutet/zvogëlohet përmes zbatimit të masave.	1	3	2	6	4	10	<p>Përgatitja dhe zbatimi i Planit të Menaxhimit të Biodiversitetit.</p> <p>Përgatitja dhe zbatimi i Planit të Rehabilitimit dhe Rigjenerimit /Plani i Menaxhimit të Pejsazhit.</p> <p>Në të gjitha zonat ku vegetacioni do të hiqet ose dëmtohet, menjëherë pas përfundimit të punimeve të ndërtimit duhet të mbillen barëra të ndryshëm dhe perime me qëllim që të parandalohet erozioni si dhe futja dhe përhapja e llojeve invazive.</p> <p>Në zonat pyjore, pas përfundimit të punimeve të ndërtimit, në korridorin e punimeve (përgjashtuar zonën prioritare të sigurisë 5+5m) duhet të mbillen drurë dhe lloje shkurresh të përshtatshme me qëllim që të zbuten efektet e fragmentimit dhe të parandalohet vendosja e llojeve të bimëve invazive.</p> <p>Përpara fillimit të punimeve makineritë e rënda dhe automjetet që do të përdoren gjatë punimeve të ndërtimit duhet të lahen me shumë kujdes (veçanërisht gomat) me qëllim që të zvogëlohet mundësia e shpërndarjes së farave të llojeve invazive të bimëve. Larja duhet të përsëritet sa herë që makineritë dhe automjetet transferohen në një vendodhje të re.</p>	1	2	2	5	2	7

Subjekti	Ndikimet	Mundësia e zbutjes së ndikimeve	Vlerësimi i ndikimit – përpara masave					SHUMATORE	Masat zbutëse	Vlerësimi i ndikimit – pas masave					SHUMATORE
			SHKALLA	SHH&K	NDJESHMËRIA MJEDISORE	EFEKTI	MUNDËSIA QË TË NGJASE			SHKALLA	SHH&K	NDJESHMËRIA	EFEKTI	MUNDËSIA QË TË	
								Me qëllim që të shmanget ndikimi negativ në vegjetacionin e brigjeve të lumit Buna, shpimi nëntokësor në këtë rrjedhë ujore duhet të fillojë jashtë brezit të vegjetacionit të pyjeve (145 m larg brigjeve të lumit Buna). Vegjetacioni i brigjeve në afërsi të lumenjve dhe habitatet e rrjedhave të përhershme (nëse janë të pranishme) pas përfundimit të punimeve të ndërtimit duhet të rikthehen në gjendjen fillestare (përjashtuar zonën prioritare të sigurisë 5+5 m). Nëse gjatë punimeve të ndërtimit brenda korridorit të punës shfaqen lloje bimësh invazive, ato duhet të hiqen dhe depozitohen në mënyrën e duhur. Pas aktiviteteve të rehabilitimit, prania e bimëve invazive duhet të monitorohet rregullisht dhe në rast të ri-shfaqjes duhen zbatuar masa shtesë. Nëse gjatë punimeve të ndërtimit në terrenet karstike, ndeshen shpella ose zgavra, të gjitha punimet duhet përkohësisht të ndalojnë. Për këto gjetje duhen njoftuar autoritetet përgjegjëse. Punimet e mëtejshme të ndërtimit duhet të vijojnë sipas udhëzimeve të autoriteteve përkatës. Me qëllim që të shmanget prerja e drurëve të arrës (Juglans regia), përpara heqjes së vegjetacionit duhet të kryhet një vrojtimit botanik për të identifikuar nëse do të ndikohet ndonjë individ. Vrojtimi botanik duhet të kryhet në progresivat: 70+800-72+100, 74+000-76+700, 84+500-96+500, 104+800-110+300, 122+200-126+500, 162+500-163+500.							
	Shqetësim i faunës nga zhurma e punimeve të ndërtimit që prodhojnë zhurmë dhe dridhje	Duke konsideruar larminë e vogël të faunës jashtë kufijve të zonave të mbrojtura, ky ndikim nuk do të jetë i rëndësishëm dhe për rrjedhojë nuk janë propozuar masa zbutëse.	1	2	2	5	2	7	-	1	2	2	5	2	7
	Erozion i tokës në shpatet e pjerrët	Ky ndikim do të zbutet me masat që lidhen me llojet invazive.	2	2	2	6	2	8	Përgatitja dhe zbatimi i Planit të Rehabilitimit dhe Rigjenerimit /Plani i Menaxhimit të Pejzazhit. Përgatitja dhe zbatimi i Planit të Kontrollit të Erozionit dhe Sedimentimit.	1	2	2	5	1	6

Subjekti	Ndikimet	Mundësia e zbutjes së ndikimeve	Vlerësimi i ndikimit – përpara masave						Masat zbutëse	Vlerësimi i ndikimit – pas masave					
			SHKALLA	SHH&K	NDJESHMËRIA MËDISORE	EFEKTI	MUNDËSIA QË TË NGJASE	SHUMATORE		SHKALLA	SHH&K	NDJESHMËRIA	EFEKTI	MUNDËSIA QË TË	SHUMATORE
									Në të gjitha zonat ku vegjetacioni do të hiqet ose dëmtohet, menjëherë pas përfundimit të punimeve të ndërtimit duhet të mbillen barëra të ndryshëm dhe perime me qëllim që të parandalohet erozioni si dhe futja dhe përhapja e llojeve invazive. Në zonat pyjore, pas përfundimit të punimeve të ndërtimit, në korridorin e punimeve (përfshirë zonën prioritare të sigurisë 5+5m) duhet të mbillen drurë dhe lloje shkurrësh të përshtatshme me qëllim që të zbuten efektet e fragmentimit dhe të parandalohet vendosja e llojeve të bimëve invazive.						
	Dëmtimi ose heqja e mbulesës vegetative	Këto ndikime nuk reflektojnë transformimin e përhershëm të sipërfaqes (ky efekt është vlerësuar për fazën e funksionimit). Ndikimet kryesore negative reflektojnë mundësinë e shfaqjes së llojeve invazive.	1	2	1	4	2	6	Në të gjitha zonat ku vegjetacioni do të hiqet ose dëmtohet, menjëherë pas përfundimit të punimeve të ndërtimit duhet të mbillen barëra të ndryshëm dhe perime me qëllim që të parandalohet erozioni si dhe futja dhe përhapja e llojeve invazive. Përpara fillimit të punimeve makineritë e rënda dhe automjetet që do të përdoren gjatë punimeve të ndërtimit duhet të lahen me shumë kujdes (veçanërisht gomat) me qëllim që të zvogëlohet mundësia e shpërndarjes së farave të llojeve invazive të bimëve. Larja duhet të përsëritet sa herë që makineritë dhe automjetet transferohen në një vendodhje të re. Nëse gjatë punimeve të ndërtimit brenda korridorit të punës shfaqen lloje bimësh invazive, ato duhet të hiqen dhe depozitohen në mënyrën e duhur. Pas aktiviteteve të rehabilitimit, prania e bimëve invazive duhet të monitorohet rregullisht dhe në rast të ri-shfaqjes duhen zbatuar masa shtesë. Në zonat pyjore do të shmanget hapja e rrugëve të përhershme të aksesit. Në rast se ato do duhet të ndërtohen, pas përfundimit të fazës ndërtimore, mbulesa e vegjetacionit pyjor duhet të rehabilitohet.	1	2	1	4	1	5
	Shqetësim i faunës nga zhurma e punimeve të ndërtimit që prodhojnë zhurmë dhe dridhje	Duke konsideruar larminë e vogël të faunës jashtë kufijve të zonave të mbrojtura, ky ndikim nuk do të jetë i rëndësishëm dhe për rrjedhojë nuk janë propozuar masa zbutëse.	1	2	2	5	2	7	-	1	2	2	5	2	7

Subjekti	Ndikimet	Mundësia e zbutjes së ndikimeve	Vlerësimi i ndikimit – përpara masave						Masat zbutëse	Vlerësimi i ndikimit – pas masave					
			SHKALLA	SHH&K	NDJESHMËRIA MËDISORE	EFEKTI	MUNDËSIA QË TË NGJASE	SHUMATORE		SHKALLA	SHH&K	NDJESHMËRIA	EFEKTI	MUNDËSIA QË TË	SHUMATORE
	Dëmtimi ose heqja e mbulesës vegetative	Këto ndikime nuk reflektojnë transformimin e përhershëm të sipërfaqes (ky efekt është vlerësuar për fazën e funksionimit). Ndikimet kryesore negative reflektojnë mundësinë e shfaqjes së llojeve invazive.	1	2	1	4	2	6	Përgatitja dhe zbatimi i Planit të Menaxhimit të Biodiversitetit. Përgatitja dhe zbatimi i Planit të Rehabilitimit dhe Rigjenerimit /Plani i Menaxhimit të Pejshazit. Në të gjitha zonat ku vegjetacioni do të hiqet ose dëmtohet, menjëherë pas përfundimit të punimeve të ndërtimit duhet të mbillen barëra të ndryshëm dhe perime me qëllim që të parandalohet erozioni si dhe futja dhe përhapja e llojeve invazive. Përpara fillimit të punimeve makineritë e rënda dhe automjetet që do të përdoren gjatë punimeve të ndërtimit duhet të lahen me shumë kujdes (veçanërisht gomat) me qëllim që të zvogëlohet mundësia e shpërndarjes së farave të llojeve invazive të bimëve. Larja duhet të përsëritet sa herë që makineritë dhe automjetet transferohen në një vendodhje të re. Nëse gjatë punimeve të ndërtimit brenda korridorit të punës shfaqen lloje bimësh invazive, ato duhet të hiqen dhe depozitohen në mënyrën e duhur. Pas aktiviteteve të rehabilitimit, prania e bimëve invazive duhet të monitorohet rregullisht dhe në rast të ri-shfaqjes duhen zbatuar masa shtesë.	1	2	1	4	1	5
	Shqetësim i faunës nga zhurma e punimeve të ndërtimit që prodhojnë zhurmë dhe dridhje	Duke konsideruar larminë e vogël të faunës jashtë kufijve të zonave të mbrojtura, ky ndikim nuk do të jetë i rëndësishëm dhe për rrjedhojë nuk janë propozuar masa zbutëse.	1	2	2	5	2	7	-	1	2	2	5	2	7
	Dëmtimi ose heqja e mbulesës vegetative	Ndikimet kryesore negative reflektojnë mundësinë e shfaqjes së llojeve invazive, por gjithashtu dëmtimin e habitateve natyrore.	1	2	1	4	2	6	Përgatitja dhe zbatimi i Planit të Menaxhimit të Biodiversitetit. Përgatitja dhe zbatimi i Planit të Rehabilitimit dhe Rigjenerimit /Plani i Menaxhimit të Pejshazit. Në të gjitha zonat ku vegjetacioni do të hiqet ose dëmtohet, menjëherë pas përfundimit të punimeve të ndërtimit duhet të mbillen barëra të ndryshëm dhe perime me qëllim që të parandalohet erozioni si dhe futja dhe përhapja e llojeve invazive.	1	2	1	4	1	5

Subjekti	Ndikimet	Mundësia e zbutjes së ndikimeve	Vlerësimi i ndikimit – përpara masave						Masat zbutëse	Vlerësimi i ndikimit – pas masave					
			SHKALLA	SHH&K	NDJESHMËRIA MËDISORE	EFEKTI	MUNDËSIA QË TË NGJASE	SHUMATORE		SHKALLA	SHH&K	NDJESHMËRIA	EFEKTI	MUNDËSIA QË TË	SHUMATORE
									<p>Përpara fillimit të punimeve makineritë e rënda dhe automjetet që do të përdoren gjatë punimeve të ndërtimit duhet të lahen me shumë kujdes (veçanërisht gomat) me qëllim që të zvogëlohet mundësia e shpërndarjes së farave të llojeve invazive të bimëve. Larja duhet të përsëritet sa herë që makineritë dhe automjetet transferohen në një vendodhje të re.</p> <p>Nëse gjatë punimeve të ndërtimit brenda korridorit të punës shfaqen lloje bimësh invazive, ato duhet të hiqen dhe depozitohen në mënyrën e duhur. Pas aktiviteteve të rehabilitimit, prania e bimëve invazive duhet të monitorohet rregullisht dhe në rast të ri-shfaqjes duhen zbatuar masa shtesë.</p> <p>Vendosja e kampeve të punës dhe kantjereve të tubave sa më larg të jetë e mundur nga zonat e pabanuara, rrjedhat ujore, dhe zonave me mbulim të lartë vegjetacioni natyror.</p> <p>Pas përfundimit të punimeve të ndërtimit, zonat në të cilat kanë qenë vendosur kantjeret e tubave dhe instalimet e përkohshme duhet të rehabilitohen që të kthehen në kushtet e mëparshme të përdorimit të tokës.</p>						
	Shqetësim i faunës nga zhurma e punimeve të ndërtimit që prodhojnë zhurmë dhe dridhje	Ndikimi do të zbutet/zvogëlohet përmes zbatimit të masave.	1	2	2	5	2	7	Vendosja e kampeve të punës dhe kantjereve të tubave sa më larg të jetë e mundur nga zonat e pabanuara, rrjedhat ujore, dhe zonave me mbulim të lartë vegjetacioni natyror.	1	2	1	4	2	6
	Dëmtim i habitateve bentike dhe të brigjeve (shumë i lokalizuar)	Zbutja përqendrohet në parandalimin e shfaqjes së llojeve invazive.	1	1	2	4	4	8	<p>Përgatitja dhe zbatimi i Planit të Menaxhimit të Biodiversitetit.</p> <p>Përgatitja dhe zbatimi i Planit të Rehabilitimit dhe Rigjenerimit /Plani i Menaxhimit të Pejzazhit.</p> <p>Vegjetacioni i brigjeve në afërsi të lumenjve dhe habitatet e rrjedhave të përhershme (nëse janë të pranishme) pas përfundimit të punimeve të ndërtimit duhet të rikthehen në gjendjen fillestare (përfunduar zonën prioritare të sigurisë 5+5 m)</p> <p>Përpara fillimit të punimeve makineritë e rënda dhe automjetet që do të përdoren gjatë punimeve të ndërtimit për kalimet me prerje të hapur të lumenjve/përrenjve/kanaeve duhet të lahen me shumë kujdes</p>	1	1	2	4	3	7

Subjekti	Ndikimet	Mundësia e zbutjes së ndikimeve	Vlerësimi i ndikimit – përpara masave						Masat zbutëse	Vlerësimi i ndikimit – pas masave						
			SHKALLA	SHH&K	NDJESHMËRIA MËDISORE	EFEKTI	MUNDËSIA QË TË NGJASE	SHUMATORE		SHKALLA	SHH&K	NDJESHMËRIA	EFEKTI	MUNDËSIA QË TË	SHUMATORE	
									(veçanërisht gomat) me qëllim që të zvogëlohet mundësia e shpërndarjes së farave të llojeve invazive të bimëve. Larja duhet të përsëritet sa herë që makineritë dhe automjetet transferohen në një vendodhje të re. Të gjitha automjetet e punës (përfshirë ato në habitatet ujore) dhe tubat për hidrotestim duhet të lahen me kujdes me ujë të nxehtë përpara se të lëvizin për në një vendodhje të re me qëllim që të parandalohet hyrja e llojeve invazive.							
	Ndryshime të cilësive fiziko-kimike të ujërave për shkak të përhapjes së sedimenteve	Masat zbutëse nuk janë të zbatueshme.	1	2	2	5	2	7	-		1	2	2	5	2	7
	Futja e llojeve ujore invazive	Zbutja përqendrohet në parandalimin e shfaqjes së llojeve invazive.	2	2	2	6	2	8	Përgatitja dhe zbatimi i Planit të Menaxhimit të Biodiversitetit. Të gjitha automjetet e punës (përfshirë ato në habitatet ujore) dhe tubat për hidrotestim duhet të lahen me kujdes me ujë të nxehtë përpara se të lëvizin për në një vendodhje të re me qëllim që të parandalohet hyrja e llojeve invazive. Hidrotestimi në të gjitha vendodhjet duhet të kryhet nën mbikqyrjen e biologëve të cilët duhet të konfirmojnë zbatimin e të gjitha masave për llojet tokësore dhe ujore invazive.		1	1	1	3	1	4
	Shqetësim i faunës nga zhurma e punimeve të ndërtimit që prodhojnë zhurmë dhe dridhje	Masat zbutëse nuk janë të zbatueshme.	1	2	1	4	1	5	-		1	2	1	4	1	5

Subjekti	Ndikimet	Mundësia e zbutjes së ndikimeve	Vlerësimi i ndikimit – përpara masave						Masat zbutëse	Vlerësimi i ndikimit – pas masave					
			SHKALLA	SHH&K	NDJESHMËRIA MJEJISORE	EFEKTI	MUNDËSIA QË TË NGJASE	SHUMATORE		SHKALLA	SHH&K	NDJESHMËRIA	EFEKTI	MUNDËSIA QË TË	SHUMATORE
Pyjet	Prerja dhe pastrimi i parcelave të vogla pyjore brenda brezit të punimeve (18 m) në të gjithë gjatësinë e gjurmës së tubacionit me qëllim aksesin e automjeteve dhe makinerive, rrit mundësinë e zjarreve në pyje	Ndikimi do të zbutet/zvogëlohet përmes zbatimit të masave.	2	1	2	5	4	9	Përgatitja dhe zbatimi i Planit të Menaxhimit të Biodiversitetit. Përgatitja dhe zbatimi i Planit të Rehabilitimit dhe Rigjenerimit /Plani i Menaxhimit të Pejshazhit. Breza me vegjetacion mbrojtës duhet të krijohen përgjatë skajeve të rinj të formuar të pyjeve. Këta breza do të krijohen duke mbjellë lloje autoktonë (drurë dhe shkurre) përgjatë skajeve të formuar rishtas të pyjeve halorë dhe gjethegjërë me përqendrim të lartë të individëve me kurorë të dendur. Këta pyje gjenden ndërmjet progresivave: 59+918 - 59+783, 62+481 - 62+863, 72+973 - 73+205, 89+175 - 89+247, 132+927 - 133+048, 170+092 - 170+235. Pas prerjes duhet të kryhet sistemimi i pyjeve (drurët e prerë duhet të mblihen dhe largohen, degët të hiqen ose stivosen, dhe trungjet të shkullen).	1	1	1	3	2	5
